
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

R A P O R T

**PËR VEPRIMTARINË E AVOKATIT TË
POPULLIT**

16 SHKURT – 31 DHJETOR

VITI 2000

Tiranë, 16 Shkurt 2001

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

Të nderuar zyrtarë të Shtetit Shqiptar, që ashtu si edhe unë burimin ligjor të fuqisë e kemi nga ky Kuvend,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Shqipërisë, që do viheni në dijeni të këtij Raporti, sepse së shpejti ky do të bëhet publik.

Parimet bazë të zhvillimit të një shoqërie demokratike janë respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe forcimi i shtetit të së drejtës.

Avokati i Popullit ndihmon drejtpërsëdrejti në forcimin e demokracisë dhe të mirëqeverisjes së një vendi.

Ndoshta, shumë nga Ju do të argumentonin se të Drejtat e Njeriut do të siguroheshin më së miri vetëm përmes zgjidhjeve të dhëna nga gjykatat, por Unë do të thoja se edhe Institucioni i Avokatit të Popullit u ka krijuar mundësi njerëzve, jo vetëm për të rivendosur të drejtën e shkelur, por edhe afirmuar dinjitetin e tyre.

Avokati i Popullit i bën thirrje Administratës Publike Shqiptare në të gjitha nivelet për të qenë më të përgjegjshëm ndaj qytetarëve që trokasin në zyrrat tona, sepse çdo trokitje në derën e zyrtarit duhet të jetë një zile kujtese, që secili nga ne nuk duhet të harrojë se, të Drejtat e Njeriut, janë të drejta që i takojnë çdo qenie humane, pavarësisht nga mosha, seksi, raca, feja, gjendja pasurore apo pozita zyrtare.

Po kështu, ne duhet të pranojmë se disa parimeve si: drejtësia e vendimit, respektimi i dinjitetit dhe barazia përballë ligjit, nuk ju humbasin asnjëherë vlerat dhe duhen zbatuar në çdo rast, duke siguruar trajtimin njerëzor të tjetrit.

Në këtë kohë, kur paqja sociale ndihet here-herë e braktisur, mua si Avokat i Popullit nuk më takon vetëm të

bëj thirrje moraliste, por të ndërhyj kudo ku ndesh një padrejtësi, gjithmonë në respektim të të drejtave e lirive të njeriut. Kjo, sepse siç ka thënë tribuni i popullit amerikan, Martin Luter King: “Paqja nuk është thjesht mungesa e tensionit, por mbi të gjitha – prezenca e drejtësisë”.

AVOKATI I POPULLIT SHQIPTAR

Tiranë, më 16.2.2001

P Ë R M B A J T J A

HYRJE

KREU I PARË

| | |
|--|----|
| 1. Institucioni i Avokatit të Popullit dhe kërkesat e Këshillit të Evropës..... | 9 |
| 2. Kushtetuta dhe ligji shqiptar "Për Avokatin e Popullit" reflektojnë dhe pasqyrojnë përvojën ndërkombëtare dhe këshillat e Komunitetit Ndërkombëtar..... | 13 |
| 3. Veprimtaria e zhvilluar nga Avokati i Popullit për krijimin dhe vënien në funksion të Institucionit..... | 19 |
| 4. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të Avokatit të Popullit..... | 23 |

KREU I DYTË

Veprimtaria konkrete e Institucionit të Avokatit të Popullit për pritje dhe zgjidhjen e ankesave, kërkesave dhe njoftimeve

| | |
|--|----|
| 1. Treguesit kryesorë sasiore..... | 25 |
| 2. Treguesit e ankesave sipas fushave të tyre..... | 26 |
| 3. Ankesat ndaj Pushtetit Gjyqësor..... | 27 |
| 4. Ankesat për Zyrat e Përmbarimit..... | 31 |
| 5. Ankesat dhe kërkesat kundër organeve të Policisë së Shtetit..... | 35 |
| 6. Ankesat, kërkesat dhe njoftimet e ardhura nga Burgjet..... | 46 |
| 7. Ankesat dhe kërkesat ndaj organit të Prokurorisë..... | 51 |
| 8. Ankesat e subjekteve të Forcave të Armatosura..... | 53 |
| 9. Ankesat në sistemin e Financave dhe Privatizimit..... | 57 |
| 10. Ankesat në lidhje me Marrëdhëniet e Punës..... | 62 |
| 11. Ankesat për ndërtimet pa leje apo mosveprime të Policisë së Ndërtimit..... | 65 |
| 12. Ankesat për Pushtetin Lokal..... | 67 |
| 13. Ankesat në fushën e Sigurimeve Shoqërore..... | 71 |
| 14. Ankesat në fushën e Arsimit dhe Kulturës..... | 73 |
| 15. Ankesat në fushën e Shëndetësisë..... | 76 |
| 16. Ankesat për Asistencën Sociale..... | 78 |
| 17. Mbi disa probleme të Mjedisit..... | 82 |
| 18. Ankesat nga Fusha të Tjera..... | 83 |
| 19. Çështje të ngritura në Gjykatën Kushtetuese..... | 87 |

KREU I TRETË

Veprimtari të tjera të Institucionit

| | |
|--|-----|
| 1. Marrëdhëniet publike përmes Medias..... | 99 |
| 2. Marrëdhëniet me Jashtë të Institucionit të Avokatit të Popullit..... | 101 |
| 3. Përdorimi i Buxhetit për vitin 2000..... | 106 |
| 4. Vlerësime nga qytetarët në adresë të Institucionit të Avokatit të Populli | 107 |

KREU I KATËRT

Përfundime

| | |
|---|-----|
| A. Vështirësitë e Institucionit dhe shkaqet e tyre..... | 111 |
| B. Epërsitë..... | 113 |
| C. Objektivat..... | 114 |
| D. Strategjitë..... | 115 |

Shtojcë

Pasqyrat

HYRJE

Hartimi dhe miratimi më 28 Nëntor 1998 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pas 8 viteve të ndryshimeve demokratike, si rrjedhojë e vendosjes së pluralizmit partiak dhe ekonomisë së tregut, është sukses i madh dhe fitore e rëndësishme për popullin shqiptar. Në këtë Kushtetutë, për herë të parë në historinë e Shqipërisë parashikohet edhe Institucioni i Avokatit të Popullit, si garant i zbatimit në realitet të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri.

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila në 5 nene të saj përcakton detyrat, statusin e kompetencat e Avokatit të Popullit, në shkurt të vitit 1999, Kuvendi miratoi Ligjin Nr.8454, dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

Është provuar deri tani në më shumë se 100 vende të botës që ky Institucion është frytdhënës, prandaj Kuvendi i Shqipërisë e miratoi Avokatin e Popullit duke patur parasysh vlerat dhe parimet mbi të cilat vepron ky Institucion, që janë paanshmëria, pavarësia, profesionalizmi dhe konfidencialiteti. Synimi ynë është që shpejt të arrihen treguesit dhe standartet që Komuniteti Ndërkombëtar ka përcaktuar për këtë Institucion.

Avokati i Popullit, ose Ombudsmani, të dyja këto emërtime nënkuptojnë të njëjtën gjë, mbi të gjitha është një Institucion demokratik. Përveç mbrojtjes së të drejtave të njeriut, një nga objektivat e tij kryesore është të zhvillojë atë që quhet *kultura e qeverisjes së mirë*. Kjo do të thotë administrim i mirë, çiltërsi, transparencë dhe llogaridhënie e administratës publike para njerëzve që paguajnë taksa për ta mbajtur atë.

Për Këshillin e Europës, Ombudsmani dhe institucione të tjera të të drejtave të njeriut përbëjnë elementin themelor të infrastrukturës së të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike. Ato japin mundësi që

individëve t'u korrigojen padrejtësitë në lidhje me administratën në bazë të bisedimeve, të paanësisë dhe të standarteve më të gjëra të drejtësisë. Tiparet themelore të institucionit të Avokatit të Popullit janë pavarësia nga qeveria dhe nga çdo ndikim politik, lehtësia e kontaktimit, shpejtësia, fleksibiliteti, efektiviteti dhe forca e Rekomandimeve të tij.

Ombudsmani duhet të jetë një lidhje njerëzore midis administratës publike pa shfaqje konkrete, nga njëra anë, dhe individit, nga ana tjetër. Ndonëse ombudsmanët nuk kanë fuqi detyruese, ata duhet të ushtrojnë një shkallë të lartë autoriteti bindës për të ndryshuar mënyrën e sjelljes së administratës dhe autoriteteve publike me Rekomandimet e tyre.

Duhet të theksohet që në fillim që Avokati i Popullit nuk është vendosur që t'i drejtojë gishtin administratës në Shqipëri ose për të vetmin qëllim që të kritikojë punën e administratës. Sigurisht ne do të kritikojmë veprimet ose mosveprimet e administratës në Rekomandimet dhe raportet tona, sikurse veprojnë ombudsmenët në të gjitha vendet, por qëllimi parësor nuk është për të punuar kundër institucioneve publike këtu, por për të punuar për një administratë publike sa më të mirë.

Avokati i Popullit nuk është dhe nuk do të jetë asnjëherë në Opozitë me Qeverinë, pavarësisht se cilat forca politike do ta kenë atë, por do të jetë gjithmonë një Oponencë për mirëqeverisje.

Në të vërtetë, shpesh edhe pse Avokati i Popullit nuk është gjithmonë në favor të administratës, fakti që ai ekziston, ka një ndikim pozitiv në administratë. Njerëzit e dinë që mund të ankohen me një procedurë të lehtë dhe pa shpenzime për vendimet e administratës. Në vendet e tjera është vënë re se si kjo mund të ndryshojë pozitivisht imazhin e administratës në publik. Dhe, natyrisht, kjo mund të ndihmojë për ta bërë edhe administratën shqiptare më të përgjegjshme për cilësitë e vendimeve të saj dhe për përgjegjësitë ndaj publikut.

KREU I PARË

I. Institucioni i Avokatit të Popullit dhe kërkesat e Këshillit të Europës

Këshilli i Europës ka një përvojë afro 20-vjeçare pune me institucionet e ombudsmanit. Komiteti i Ministrave ka nxjerrë Rekomandimet në vitet 1985 dhe 1997, që përmbanin direktiva: së pari, për ngritjen e ombudsmanit dhe të institucioneve të ngjashme me të; së dyti, për ngritjen e institucioneve të pavarura kombëtare për zhvillimin dhe ruajtjen e të drejtave të njeriut. Rekomandimet e Këshillit të Europës për Ombudsmanin tregojnë rëndësinë e këtyre organeve, të cilave u kanë dhënë kompetenca për çështjet e të drejtave të njeriut si dhe për të shqyrtuar ankesat individuale për shkelje të këtyre të drejtave dhe lirive themelore.

Gjatë këtyre 10 vjetëve të fundit, Këshilli i Europës i është përkushtuar tërësisht mbështetjes së institucioneve të reja të Ombudsmanit në shtetet e reja anëtare. Kjo mbështetje ka të bëjë si me hartimin e legjislacionit përkatës për institucionet, ashtu edhe me dhënien e ekspertizës dhe të ndihmesës në zyrat e porsahapura. Ndër vendet ku ka dhënë ndihmë konkrete dhe projekte bashkëpunimi përfshihet edhe Shqipëria. Këshilli i Europës sot drejton bashkërendimin e Projekteve të Paktit të Stabilitetit në Europën Juglindore për institucionet kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe institucionin e Avokatit të Popullit në Shqipëri.

Gjithashtu, përmendim krijimin në fillim të vitit 2000 të institucionit të Ombudsmanit të vetë Këshillit të Europës

– Komisionerit të të Drejtave të Njeriut. Komisioneri, zoti Gil-Robles, Ombudsmani i mëparshëm i Spanjës, nuk mund të shqyrtojë ankesa individuale, por ka një mandat të përgjithshëm që e mundëson të identifikojë gabimet e mundshme në ligjin dhe në praktikën e shteteve anëtare në lidhje me përputhjen me standartet e të drejtave të njeriut të Këshillit të Europës dhe të nxitë zhvillimin efektiv dhe gëzimin e të drejtave të njeriut në shtetet anëtare.

Ndër të tjera, Këshilli i Europës ka përcaktuar edhe kushtet e domosdoshme për të përvijuar tiparet kryesore të Institucionit të Avokatit të Popullit (Ombudsmanit).

Ato përbëhen, së pari, nga një bazë ligjore dhe konstitucionale që të ndihmojë për krijimin e institucionit dhe për caktimin e kandidatit të përshtatshëm në një mjedis me pikëpamje politike të ndryshme.

Së dyti, nevoja për ta pajisur Ombudsmenin me burime të mjaftueshme për të kryer mandatin e vet theksohet me të madhe.

Së treti, institucioni i Ombudsmanit nuk zëvendëson gjykatat, pra nuk është zëvendësues i një gjyqësori efektiv e të pavarur. Ai përbën një pjesë të makinerisë së të drejtave të njeriut, me të cilën duhet të pajisen të gjitha shtetet demokratike, duke mos mbajtur as anën e administratës e as atë të individit, por duke punuar për kulturën e mirëqeverisjes dhe për mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut.

Së fundi, kur ngrihet institucioni i Avokatit të Popullit, duhet të ketë një administratë me ndjenjë përgjegjësie. Kjo do të thotë një administratë që të jetë e hapur ndaj ndryshimit dhe që e di se Avokati i Popullit ka detyrë të futet në dialog me administratën, të bëjë kritikë konstruktive dhe të japë këshilla. Po ashtu, kërkohet që legjislativi të pranojë rekomandimet e Avokatit të Popullit për ndryshime ligjore ose nisma të reja legjislative. Kjo kërkon një kuptim dhe pranim të rolit të Avokatit të Popullit, si nga ana e administratës publike, ashtu edhe e Kuvendit

(legjislativit) gjë që s'mund të arrihet menjëherë, por që ka rëndësi të madhe të kuptohet nga të gjitha palët.

Objekti i punës së Avokatit të Popullit pasqyron qartë që një nga funksionet e tij parësore është verifikimi dhe zgjidhja e ankesave vetjake dhe kjo, normalisht, është veprimtaria më e dukshme e institucionit për sa i takon publikut. Megjithatë, përveç funksionit themelor të trajtimit të ankesave, institucionet kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut duhet, në përgjithësi, të punojnë në partneritet me të gjitha forcat e shoqërisë dhe të ndihmojnë në arritjen e një bashkëpunimi midis grupeve të ndryshme, për shembull, administratës dhe individit, Medias, OJQ-ve dhe ligjvënësve etj.

Veprimtaritë e tjera të përgjithshme, që synojnë rritjen e vetëdijes për rolin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit, kanë rëndësi në të gjitha vendet, por më shumë aty ku institucioni dhe parimi i tij themelor nuk janë të njohur. Për të bërë të mundur që njerëzit të ankohen se u janë shkelur të drejtat e tyre, ata duhet të dinë se cilat janë këto të drejta. Duke qenë se njerëzit shpesh herë nuk kanë dëshirë, ose kanë frikë të ankohen, merr rëndësi informimi i tyre për punën e institucionit të Avokatit të Popullit. Këshilli i Europës mbështet veprimtaritë që rrisin ndërgjegjësimin e publikut në Shqipëri, duke punuar me Avokatin e Popullit dhe nëpërmjet grupit të Miqve të Avokatit të Popullit, për të informuar individët se si mund të përdoret ky institucion.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë dhe do bëjë më shumë për të rritur ndërgjegjësimin e publikut, sidomos duke punuar me Median e nëpërmjet saj. Komuniteti ndërkombëtar ka dhënë ndihmesën e vet në këtë proces. Kjo po ndodh edhe në Shqipëri, me anë të bashkëpunimit brenda grupit të quajtur Miqtë e Avokatit të Popullit.

Grupi i Miqve të Avokatit të Popullit është krijuar menjëherë pas zgjedhjes së Avokatit të Popullit, më 25 shkurt 2000 dhe në të bëjnë pjesë Përfaqësitë e Këshillit të Europës dhe të OSBE në Tiranë, Ambasadat e Mbretërisë

së Danimarkës dhe të SHBA, organizata si USAID, Banka Botërore, ABA-CEELI, CAFOD, QSHDNj etj.

Miqtë janë mbledhur pothuajse çdo muaj dhe bashkë me Avokatin e Popullit kanë përcaktuar, ndjekur, ndihmuar dhe monitoruar të gjithë procesin e ngritjes dhe konsolidimit të këtij Institucioni deri sot.

Me këtë rast përmend në mënyrë të veçantë ndihmën e Ambasadës së Mbretërisë së Danimarkës në vendin tonë, e cila nëpërmjet projektit Danida, në kuadër të marrëveshjes së dy qeverive tona, të nënshkruar në Kopenhagen në korrik 1999, ka përballuar pjesën më të madhe të kostos financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri. Në këtë kuadër më 29 dhjetor 2000 kemi nënshkruar edhe Projekt Dokumentin me titull “Ngritja, forcimi dhe konsolidimi i kapaciteteve administrative, menaxhuese dhe profesionale të Institucionit të Avokatit të Popullit”, me afat deri në Qershor 2002. Këshilli i Europës ka përshëndetur hapat e bëra nga Shqipëria për të ndërtuar Avokatin e Popullit dhe shpreson që sa më shpejt ai të zërë vendin e vet brenda administratës shqiptare, duke qenë i gatshëm të japë mbështetjen e tij për ne dhe të bashkëpunojë vazhdimisht me Institucionin tonë.

2. Kushtetuta dhe ligji shqiptar “Për Avokatin e Popullit” reflektojnë dhe pasqyrojnë përvojën ndërkombëtare dhe Këshillat e Komunitetit Ndërkombëtar për këtë Institucion

Sipas nenit 60 të Kushtetutës dhe nenit 2 të ligjit përkatës, Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike ose të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Pra përfshin Qeverinë, ministritë, Institucionet e tjera qendrore siç janë Komitetet shtetërore të Turizmit,

Ambientit etj; Shërbimi Informativ, Banka Kombëtare dhe Bankat me pjesëmarrje kapitali shtetëror etj; organet e pushtetit lokal ku përfshihen Prefekturat, Qarqet, Bashkitë dhe Komunat si dhe ato Institucione apo autoritete publike që veprojnë për llogari të këtyre organeve të administratës publike dhe institucionet në varësi të tyre në qëndër dhe rrethe. Ashtu si ligjet e mjaft shteteve të tjera që e kanë këtë institucion, edhe ligji shqiptar nuk i ka dhënë Avokatit të Popullit fuqi vendimmarrëse në raport me organet e administratës, por vetëm të drejtën e rekomandimeve përkatëse. Kjo nuk do të thotë se Avokati i Popullit nuk ka mjete për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njerëzve. E drejta e tij për t'i ndjekur çështjet shkallë-shkallë sipas hierarkisë së administratës deri në dërgimin e çështjes në Kuvend, si dhe transparenca, në punën e tij, bashkëpunimi i ngushtë me OJQ-të dhe Median garantojnë suksesin në detyrën që i është caktuar atij.

Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij. Kjo pavarësi shprehet në disa elemente si: Mospasja e lidhjeve të varësisë me Institucionet e tjera Kushtetuese të vendit si Presidenti, Qeveria, Gjykatat etj; qënia jashtë politikës, jashtë partive dhe veprimtarive të tyre politike, disponimi i një buxheti të veçantë, përzgjedhja prej Avokatit të Popullit e Komisionerëve dhe ndihmësve të tyre brenda një strukture dhe organike të përcaktuar prej atij vetë, përcaktimi i Rregullores së Brendëshme, Kodit Etik etj. Është e rëndësishme dhe vlen të raportohet se kjo pavarësi ka qenë dhe është reale, tipike, për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri dhe pavarësisht nga kritikrat e shprehura apo të pashprehura publike, kjo pavarësi nuk do të lejohet të çenohet nga ndikimi i asnjë force politike apo Institucioni tjetër shtetëror.

Janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit ligjet dhe aktet e tjera normative, urdhërat me karakter ushtarak të forcave të armatosura, vendimet e Gjykatave. Por pa çenuar pavarësinë e Gjykatës, Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa apo njoftime për shkelje të të drejtave të

njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe procedurat gjyqësore. Hetimi i Avokatit të Popullit nuk prek pavarësinë e Gjykatës në marrjen e vendimit.

Lidhur me kompetencat, çdo individ, grup individësh ose organizata joqeveritare që pretendojnë se të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme, u janë shkelur nga një akt, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës qendrore e vendore apo të ndonjë organi tjetër të veshur me autoritet publik, mund të paraqesin ankesa, kërkesa apo njoftime tek Avokati i Popullit për shqyrtimin e çështjes. Ai mundet gjithashtu që, për raste të veçanta të bëra publike, të fillojë procedurën e shqyrtimit me nismën e vet, por gjithmonë duhet të marrë më pas pëlqimin e të interesuarit apo të dëmtuarit.

Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga organet e Administratës çdo informacion apo dokument që lidhet me çështjen që ndjek, ose të kryejë hetime të pavarura në vend, të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin e tij, të marrë në pyetje çdo person, që sipas tij, është i lidhur me çështjen në hetim ose të kryejë ose të kërkojë ekspertiza.

Ai ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror. Avokati i Popullit mund të hyjë në çdo zyrë të organeve të administratës së përmendur më sipër; mund të inspektojë burgjet dhe vendet e tjera të paraburgimit ose institute të tjera ku të drejtat e individëve janë të kufizuara. Ai gjithashtu mund të bisedojë privatisht me personat që mbahen në këto institute. Këto të drejta dalin nga interpretimi i Kushtetutës dhe ligjit "Për Avokatin e Popullit" si dhe nga praktikat ndërkombëtare të punës së Ombudsmanit, por do të ishte mirë që në rast të plotësimit të ligjit "Për Avokatin e Popullit" të vendosen shprehimisht në këtë ligj, për të mos ngjallur dëshirën e keqinterpretimeve dhe vendosjes së kufizimeve të padrejta për këtë Institucion.

Sipas nenit 22 të ligjit, organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ.

Në rast se Avokati i Popullit nuk i quan të mjaftueshme përgjigjet ose masat e ndërmarra nga organi, ai ka të drejtë ta ndjekë çështjen tek organi më i lartë në hierarki. Në rastet e përsëritura, si dhe kur organi përkatës nuk reagon ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ky i fundit mund t'i drejtohet edhe Kuvendit me një raport, duke propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.

E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legjislative, është një mjet shumë i rëndësishëm dhe efektiv për të ndaluar shkeljen e të drejtave të njeriut.

Kur Avokati i Popullit vëren, se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ai ka të drejtë:

- a. t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;
- b. t'u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore;
- c. t'i rekomandojë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e akteve të tilla.

Institucioni i Avokatit të Popullit i jep rëndësi të veçantë kontakteve me ankuesit, pasi ai është krijuar për të ndihmuar në zgjidhjen e nevojave të individëve. Detyra e tij është të parandalojë apo të zbulojë shkeljet e të drejtave dhe lirive të individit me qëllim ndreqjen e

pasojave që rrjedhin nga e drejta e shkelur. Megjithatë është shumë e rëndësishme që ky Institucion të jetë i hapur dhe i gatshëm për këdo që kërkon ndihmë nga ai. Çdo qytetar shqiptar ose i huaj mund të vijë çdo kohë gjatë orarit zyrtar nga ora 8⁰⁰ deri 16⁰⁰ dhe të kontaktojë me një punonjës të Zyrës, i cili merr dhe jep informacion. Avokati i Popullit dhe Komisionerët organizojnë takime me të interesuarit, sipas rastit. Për ankesa, kërkesa, shpjegime, këshilla dhe informacion në fushën që paraqitet ankimi mendohet që të vendoset një linjë telefonike pa pagesë, duke ua mundësuar këtë sidomos të burgosurve, të ndaluarve apo të arrestuarve.

Qytetarët mund t'i drejtohen Avokatit të Popullit në mënyra të ndryshme. Sipas procedurës që kemi caktuar, ankesa i paraqitet Avokatit të Popullit me shkrim. Në raste urgjente, ankesa mund të bëhet dhe me telefon por, shumë shpejt ajo duhet të paraqitet edhe me shkrim, pasi në të kundërt procedura për shqyrtimin e çështjes ndërpritet. Nuk pranohen ankesa ose kërkesa anonime.

Në rastet, kur ankesa e paraqitur nuk është e plotë, pasi i mungojnë dokumentet e nevojshme, Avokati i Popullit kërkon që ajo të plotësohet ose bën kërkitime të drejtpërdrejta tek organi, ndaj të cilit është bërë ankesa, kur një gjë e tillë është e dukshme në ankesë. Në shumë raste, biseda me ankuesin është e nevojshme për t'a paraqitur siç duhet rastin që shqyrtohet, veçanërisht kur ai është i komplikuar dhe kërkon shumë shpjegime.

Avokati i Popullit dhe stafi i tij zhvillojnë takime edhe jashtë zyrës së tij, në rrethe të ndryshme të vendit. Kurse hapja e zyrave dhe emërimi i përfaqësuesve të Avokatit të Popullit nëpër rrethe është një mundësi që nuk ka filluar të zbatohet akoma, për shkak se duhet më parë të përfundojë konsolidimi i Institucionit në qendër.

Disa nga ankesat e paraqitura mund të mos jenë në juridiksionin e Avokatit të Popullit, ose mund të mos përmbushin kushtet për t'u trajtuar nga zyra e Avokatit të Popullit. Në raste të tilla, ankuesi do të marrë përgjigjen e

Avokatit të Popullit sa më shpejt që të jetë e mundur, brenda afatit 1 muhor, duke e këshilluar atë se çfarë lipset të bëjë, cilat janë mundësitë që i kanë mbetur akoma, ose cilat janë mjetet ligjore që duhet të përdoren përpara se ankesa të trajtohet nga Avokati i Popullit.

Si rregull, Avokati i Popullit u dërgon organeve përkatëse një përshkrim të shkurtër të problemit të ngritur, dhe kërkon shpjegime të hollësishme rreth tij. Në të njëjtën kohë, Avokati i Popullit fikson dhe afatin, brenda të cilit pret përgjigje nga organi të cilit i është drejtuar kërkesa. Ky afat varet nga urgjenca e problemit dhe nga shkalla e vështirësisë së tij. Megjithatë, afati nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë. Nganjëherë, kur natyra e problemit të paraqitur është e tillë, sa afati kohor nuk mund të zgjasë shumë, Avokati i Popullit mund të bëjë verifikimet e tij nëpërmjet telefonit ose faxit.

Pas kryerjes së hetimit për një çështje të caktuar, Avokati i Popullit përpilon një raport për çështjet dhe konkluzionet e arritura, dhe mund tua paraqesë atë palëve që kanë të bëjnë me çështjen. Ky raport përmban gjykimin e Avokatit të Popullit mbi faktet dhe rrethanat e çdo rasti, duke treguar se cilat nga të drejtat dhe liritë e individit janë shkelur, si janë shkelur ato dhe cilat janë personat përgjegjës që kanë kryer shkeljet. Në të njëjtën kohë, Avokati i Popullit mund të propozojë rrugën për të rivendosur të drejtën e shkelur. Ai, gjithashtu, mund të propozojë kompensime përkatëse për dëmin e shkaktuar individit nga shkelja e së drejtës që i është bërë. Avokati i Popullit mund të kërkojë që, organi që ka kryer shkeljen e së drejtës së individit, t'i kërkojë këtij të fundit falje për veprimin e kryer.

Avokati i Popullit i paraqet çdo vit Kuvendit një raport vjetor për punën e tij. Një kopje e këtij raporti i është dërguar Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave. Ky raport përmban veprimtarinë e Institucionit tonë që nga fillimi, me 16 shkurt 2000, duke përfshirë jo vetëm rastet e shkeljeve të të drejtave dhe

lirive të njeriut dhe realizimin e mbrojtjes së këtyre të drejtave, por, për shkak se është Raporti i parë, ai përfshin të gjitha veprimtaritë dhe punën e zhvilluar për ngritjen si strukturë dhe vënien e tij në lëvizje si Institucion.

Për shkak të krijimit të lehtësive statistikore për raportet në vitet e ardhme, në këtë raport janë përfshirë ankesat dhe kërkesat e regjistruara deri më datën 31.12.2000.

Raporti vjetor dhe raportet e veçanta bëhen publike dhe duhet të botohen jo më vonë se një muaj nga data e diskutimit në Kuvend. Një kopje e tij në Anglisht do të publikohet dhe shpërndahet nga zyra e Avokatit të Popullit në institucionet homologe të vendeve të huaja si dhe në institucionet ndërkombëtare që kanë lidhje me këtë Institucion.

3. Veprimtaria e zhvilluar nga Avokati i Popullit për krijimin dhe vënien në funksion të Institucionit

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i kësaj legjislature si dhe deputetët e të gjitha forcave politike kanë meritën që, në zbatim të Kushtetutës, ka miratuar ligjin nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”. Gjithashtu, po ky Kuvend, me një procedurë tepër transparente u garantoj shanse të barabarta të gjithë shtetasve shqiptarë që dëshironin të kandidonin për postin e Avokatit të parë të Popullit Shqiptar.

Si rrjedhojë, të 15 kandidatët e paraqitur iu nënshtruan procedurës demokratike të votimit të fshehtë, që përfshiu dy raunde, më datën 15 shkurt 2000, dhe raundin e tretë final më datën 16 shkurt 2001.

Si rrjedhojë, zoti Ermir Dobjani, jurist, i vetëkandiduar, i pa organizuar në ndonjë parti pas pluralizmit të vitit 1990, fitoi me 104 vota, nga 93 vota që kërkon Kushtetuta për këtë post.

Duke qënë tepër i ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e madhe që mori përsipër, por edhe duke parashikuar ndihmesën e madhe që do të jepte faktori ndërkombëtar dhe Kuvendi që e zgjodhi, Avokati i Popullit përcaktoi që në fillim objektivat që do të arrinte dhe strategjinë që do të përdorte për krijimin dhe vënien në funksionim të këtij Institucioni.

Kështu, që në takimin e parë me përfaqësuesin e Ambasadës Daneze në Tiranë, më 24 shkurt 2000, dhe me Grupin e Miqve, më datën 25 shkurt 2000, u përpunuan objektivat afatshkurtër. Këto objektiva përfshinin zgjedhjen e 3 komisionerëve (zëvendësve) të Avokatit të Popullit nga Kuvendi, hartimin e një projektligji për t'i dhënë më tepër pavarësi Avokatit të Popullit në hartimin e Strukturës së Zyrës dhe numrit të personelit të saj, hartimin dhe dorëzimin në Komisionin e Financës të Kuvendit të Projekt buxhetit të vitit 2000. (Kjo, sepse në buxhetin e shtetit të vitit 2000 nuk ishte parashikuar buxheti për këtë Institucion).

Njëkohësisht do bashkëpunohet me Qeverinë Shqiptare për të paraqitur disa variante për sistemimin me zyra të Institucionit. Këto objektiva, me përjashtim të Selisë, u realizuan relativisht shpejt që në datën 15 prill 2000.

Kështu, më datën 30 mars 2000 u zgjodhën si komisionerë Agron Çausi, Florina Nuni dhe Jorgo Dhrami, juristë të përgatitur profesionalisht dhe të painkuadruar në jetën politike. Me datën 10 prill 2000 Kuvendi miratoi një shtesë në ligjin "Për Avokatin e Popullit", kurse Këshilli i Ministrave me vendimin nr.178 datë 13.04.2000 miratoi buxhetin e Institucionit për vitin 2000. Natyrisht, të gjitha sa më sipër janë rrjedhojë e kontributit dhe veprimtarisë së të gjithë deputetëve, Kryesisë së Kuvendit dhe sidomos të Komisionit parlamentar të Ligjeve dhe atij të Financave.

Realizimi i këtyre objektivave i dha mundësi Avokatit të Popullit dhe 3 komisionerëve që të përgatitnin strukturën

dhe organikën e Institucionit, projekt Rregulloren e Brendëshme të punës, Projekt Kodin Etik si dhe kërkesat për konkursin e hapur të punësimit të stafit tonë, në përputhje me ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”.

Në përgatitjen e këtyre akteve, të cilët përbënin parakushtet për krijimin dhe fillimin e veprimtarisë së Institucionit, u patën parasysh ligji “Për Avokatin e Popullit”, literatura dhe përvojat e zyrave të Ombudsmenëve të Sllovenisë, Suedisë, Hungarisë, Danimarkës dhe Rumanisë, si dhe vërejtjet dhe këshillat konkrete të Grupit të Miqve.

Duke qenë se nuk ka traditë apo një Institucion të mëparshëm për të drejtat e njeriut në Shqipëri, Këshilli i Europës ftoi Avokatin e Popullit në Konferencën e Dublinit më 2-4 mars 2000, ku u diskutua rreth vizionit të të drejtave të njeriut në vitin 2000.

Më 13 mars 2000, në Selinë e Këshillit të Europës në Strasburg, Avokati i Popullit prezantoi objektivat dhe strategjinë e tij, dhe me këtë rast, atij iu ofruan ndihmat konkrete nga drejtues kryesorë të Këshillit të Europës. Më 3-7 prill 2000, nëpërmjet ODIHR-it, u ftuam bashkë me 3 komisionerët nga Ombudsmani i Sllovenisë, ku u njohëm konkretisht dhe morëm mjaft përvojë të vlefshme për organizimin e zyrës dhe metodën e punës sonë.

Gjithashtu, Këshilli i Europës, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Suedisë (Suedia është vendi i origjinës së Ombudsmanit) mblodhi në Stokholm nga data 8-13 maj 2000 Ombudsmenët e Shqipërisë, Maqedonisë, Kroacisë dhe Bosnje Hercegovinës, me qëllim që të merrnim përvojë nga Zyra e Ombudsmanit Suedez, të krijojmë lidhje dhe të shkëmbejmë përvojë si fqinj të Rajonit. Të njëjtin qëllim kishte edhe pjesëmarrja e Avokatit të Popullit dhe dy deputetëve të këtij Kuvendi në një konferencë të organizuar në Pragë nga Këshilli i Europës dhe Parlamenti Çek, në prill 2000.

Sigurimi i një Selie të përshtatshme ka qenë një nga problemet më të vështira për t’u zgjidhur. Në prill 2000,

Komiteti i Turizmit pati dashmirësinë të na linte përkohësisht në dispozicion 4 zyra. Aty, më 15 qershor 2000 filluam veprimtarinë tonë konkrete për pritjen dhe zgjidhjen e kërkesave të para të qytetarëve. Deri në maj 2000 ishim pa asnjë mjet pune, por në atë kohë filloi lëvrimi i parë i ndihmës daneze me 4 automjete, 4 kompjutera, 2 fotokopje, 10 tavolina, karrige dhe kancelari. Qysh nga 16 shkurti 2000 deri më 15 qershor ishin depozituar rreth 60 ankesa, të cilat filluan të shqyrtohen dhe t'u jepej zgjidhje në përputhje me ligjin.

Njëkohësisht me përpilimin e Projekt Rregullores së Brendshme të punës dhe të Kodit Etik, në korrik 2000 përfundoi edhe procesi i punësimit me konkurs të 15 ndihmëskomisionerëve. Është jo vetëm mendimi ynë, por edhe i miqve tanë nga zyrat e Ombudsmanëve Danez, Suedez, Slloven etj, se personeli i Zyrës sonë është mjaft i përgatitur nga pikëpamja juridike dhe përbën një bazë të mirë për konsolidimin e Institucionit.

Caktimi në korrik 2000 i Selisë së zyrave tona në ndërtesën në qendër të Tiranës ishte shfaqje e vullnetit të mirë politik të Qeverisë Shqiptare për krijimin e kushteve të përshtatshme të punës, dhe krijoi mundësitë që puna e nisur të futej në një fazë të re. Në këtë Seli ne kemi 9 zyra me gjithsej 220 m². Ndonëse kjo sipërfaqe nuk i plotëson të gjitha nevojat tona, me largimin nga këto zyra në nëntor 2000 të Projektit të Ujitjes të Ministrisë së Bujqësisë, u krijuan kushte që këto zyra të rikonstruktohen e të pajisen me mjete pune bashkëkohore, kryesisht me fondet e projektit Danida të Qeverisë Daneze.

Vizita e Ombudsmanit Danez, zotit Hansen, të shoqëruar nga Ombudsmani Slloven, zoti Ivan Bizjak, më 8-9 shtator 2000, shërbeu si katalizator në përshtetimin e punës për ngritjen e Institucionit tonë.

Duke shfrytëzuar përvojën e tij 14-vjeçare si Ombudsman në Danimarkë, zoti Hansen monitoroi hapat që kishim hedhur, objektivat që kishim caktuar dhe nivelin e specialistëve tanë.

Përmbledhja e konkluzioneve të tyre është: “Jemi shumë të impresionuar nga puna e kryer dhe cilësia e saj brenda një kohe të shkurtër. Niveli juridik i specialistëve është shumë i mirë. Hapat e hedhura janë në drejtimin e duhur”.

Si rrjedhojë, pas kësaj vizite, bashkë me Ambasadën Daneze në Tiranë miratuar në parim objektivat e Projekt dokumentit që nënshkruam më 29 dhjetor 2000. Sipas këtij dokumenti, pas përfundimit të ristrukturimit, pajisjes së zyrave dhe përrurimit zyrtar të selisë sonë më 20 mars 2001, me praninë edhe të Ombudsmanit të Danimarkës, Institucioni ynë do të hyjë në fazën e konsolidimit të veprimtarisë së tij.

4. Struktura, Organika dhe Cilësitë e Personelit të Institucionit të Avokatit të Popullit

Një nga parimet bazë të Institucionit të Avokatit të Popullit, siç është theksuar edhe më sipër është Pavarësia e tij.

Sipas praktikave të Institucioneve të këtij lloji në të gjithë botën, një nga shprehjet e parimit të pavarësisë është edhe lënia në dorën e Ombudsmanit të së drejtës së përcaktimit të strukturës, të numrit të personelit, cilësive specifike si dhe të shpërblimit të tyre, brenda buxhetit të miratuar nga Parlamenti.

Në Shqipëri është gjetur një rrugë e mesme, e cila nuk e prek pavarësinë e këtij Institucioni. Kështu, duke qenë se ligji “Për Avokatin e Popullit”, në nenin 31, ka caktuar tre seksionet e specializuara, Avokati i Popullit, mbi bazën e ligjit nr.8600, dt.10.04.2000, ka përcaktuar pjesët e tjera të strukturës organizative dhe numrin e personelit të zyrës. (Pasqyra nr.1 dhe 1/1).

Sipas strukturës organizative të miratuar, Zyra e Avokatit të Popullit përbëhet nga tre seksione të specializuara, që ndjekin çështjet e ankesave dhe kërkesave, përkatësisht:

Seksioni i Parë, për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, që drejtohet nga zoti Agron Çausi; **Seksioni i Dytë**, ankesat për policinë, shërbimin sekret, burgjet, forcat e armatosura dhe pushtetin gjyqësor, që drejtohet nga zoti Jorgo Dhrami; **Seksioni i Tretë** trajton çështjet që nuk përfshihen në dy seksionet e para si dhe bashkëpunon me organizatat joqeveritare. Ky seksion ka detyrë të kryejë edhe studime për veprimtarinë në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe drejtohet nga zonja Florina Nuni.

Për Organikën dhe numrin e Personelit të Institucionit tonë janë patur parasysh institucionet homologe në Slloveni, Danimarkë, Hungari dhe Rumani, si dhe përvoja e Institucioneve analoge shqiptare. Veç 3 seksioneve të specializuara, Kabineti, në përbërje të të cilit janë Këshilltarët e Avokatit të Popullit, sektori i regjistrimit të ankesave, financa, personeli, marrëdhëniet me jashtë dhe administrata, janë sektorë ndihmës për realizimin e detyrave kryesore që ka Institucioni. Duke përjashtuar Kabinetin, të gjithë këto organizma ndihmës, gjithsej 23 persona, janë nën drejtimin dhe varësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Institucionit, zotit Gëzim Lleshi.

Përsa i përket cilësive profesionale të personelit të Zyrës sonë, vëmë në dukje se Avokati i Popullit dhe Komisioneri, zoti Jorgo Dhrami, mbajnë gradën “Doktor i Shkencave juridike”. Veç këtyre, 4 të tjerë aktivizohen për mësimdhënie si pedagogë të jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë ose në Shkollën e Magjistraturës. Nga 27 specialistë me arsim të lartë që ka Institucioni, disa kanë kryer studime pasuniversitare në Perëndim, kurse 17 prej tyre zotërojnë dhe përdorin lirisht një ose më shumë gjuhë të huaja. Kjo gjendje ka krijuar mundësinë që në kuadrin e trajnimeve që ka ofruar Danida dhe Këshilli i Europës, Institucioni ynë të ketë mundësi të përfitojë përvojë sa më tepër, direkt pa qenë nevoja e përkthyesve.

KREU I DYTË

Veprimtaria konkrete e Institucionit të Avokatit të Popullit për pritjen dhe zgjidhjen e ankesave, kërkesave dhe njoftimeve

1. Treguesit kryesorë sasiore

Për ne është e qartë se efektiviteti i ngritjes dhe funksionimit të një Institucioni të ri, në radhë të parë matet me volumin e punës për kryerjen e detyrës së tij kryesore dhe që është: Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut nëpërmjet zgjidhjes së ankesave apo kërkesave të individëve, grupeve të individëve apo organizatave joqeveritare kundër veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme apo të parregullta të organeve të Administratës Publike Shqiptare.

Kështu siç del nga pasqyra nr.3, deri më datën 31.12.2000 në Institucionin tonë janë rregjistruar gjithësej 833 ankesa, kërkesa ose njoftime. Nga këto 23 kanë qenë të përsëritura nga i njëjti subjekt. Nga 810 ankesa, janë përfunduar 601 ose 74% dhe janë mbartur për shqyrtim në vitin 2001, 209 ose 26%. Me qëllim që në vitet e ardhme Raporti Vjetor të jetë i plotë 1 janar – 31 dhjetor, raportimi i punës së kryer për ankesat gjatë vitit 2000 do të jetë deri më datën 31.12.2000.

Megjithatë, për të patur një ide më të saktë, kemi evidentuar se për periudhën 1.01.2001 deri më datën 12.02.2001 kanë ardhur edhe 257 ankesa të tjera, kështu që numri i ankesave për shqyrtim (në dorë) pas datës 01.01.2001 është 466 – shih pasqyrën nr.3.

Sipas ritmit të ardhjes së ankesave gjatë vitit 2001 deri më 12.02.2001 pra 6 javë, në fund të vitit 2001 rezulton se do të kemi më tepër se 2300 ankesa dhe kërkesa. Mesatarisht çdo ndihmëskomisioner (janë 15 të tillë) do të ketë rreth 150 ankesa secili për të zgjidhur për gjithë vitin 2001, në një kohë që në zyrën e Ombudsmanit Danez ky numër është 120 ankesa në vit për një ekspert.

Duke shqyrtuar numrin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve, 810 vlen të vihet në dukje se pas këtij numri ne kemi evidentuar se qëndrojnë 1512 individë; 948 familje, 7 Shoqata dhe 3 Sindikata. (Shih pasqyrën nr.5).

Duke shqyrtuar mënyrën e përfundimit të 601 ankesave deri më datën 31.12.2000, vëmë në dukje se nga këto, jashtë juridiksionit ose kompetencës së Avokatit të Popullit kanë qenë 345 ose 57% e tyre; janë refuzuar si të padrejta 106 ose 18% dhe janë zgjidhur në favor të ankuesve 150 ose 25% e tyre. (Shih pasqyrën nr.9)

Kjo shifër (25%) është relativisht e lartë, në raport me 10-15% që e kanë zyra të tjera si Sllovenia, Hungaria etj. Kjo vjen në radhë ta parë për shkak të dobësive të punës të organeve të administratës tonë publike. Shkaqet e kësaj dobësie, sipas mendimit tonë do të trajtohen më poshtë.

2. Treguesit e ankesave sipas fushave të tyre

Gjatë paraqitjes së një raporti pune treguesit e tij mund të shihen e të paraqiten nga kënde vështrimi të ndryshëm si p.sh. nga natyra (fusha) e të drejtës së shkelur, sipas organit ndaj të cilit pretendohet shkelja, nga subjekti që bën ankesën etj.

Është e kuptueshme që Institucioni ynë nuk ka patur një raport dhe statistikë të mëparshme që të mund t'i referohej e të bënte krahasime dhe aq më tepër që na kanë munguar deri tani jo vetëm sistemi i kompjuterizimit të të dhënave, por edhe kompjuterat e mjaftueshëm si mjete pune.

Në këtë situatë, ankesat e trajtuara dhe veprimtarinë tonë konkrete po e paraqesim duke i radhitur sipas fushave të mëposhtme: (shih pasqyrën nr.6, 7 dhe 8).

3. ANKESA NDAJ PUSHTETIT GJYQËSOR

a. Ankesa kundër gjykimeve të përfunduara

Gjatë periudhës raportuese 16 qershor – 31 dhjetor 2000 janë paraqitur 133 ankesa me 140 persona ndaj gjykimeve të përfunduara.

Këto ankesa u përkasin: qytetit të Tiranës 34 ose 25% dhe rretheve të tjera 99 ose 74.4%.

Nga numri i përgjithshëm i këtyre ankesave, në 14 raste ato janë zgjidhur në favor të ankuesve apo të kërkuesve, në 62 raste kanë qenë jashtë kompetencës sonë; në 48 raste janë refuzuar si të padrejta, ndërsa 9 raste janë në shqyrtim.

Duke analizuar përmbajtjen e ankesave, kërkesave apo njoftimeve të mësipërme, pretendimi i tyre ka qenë për: gjykime dhe dënime të padrejta; zvarritje në gjykimin e çështjeve; ndreqje gabimi material apo plotësim vendimi etj.

Në të gjitha këto raste ankesave ju është dhënë përgjigja se vendimet e gjykatave janë jashtë juridiksionit tonë dhe u është shpjeguar se rruga e vetme për plotësimin e kërkesave të tyre është t'i drejtohen gjykatave sipas shkallëve apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në ato raste që kanë qenë brenda afatit 3-vjeçar.

Ndërsa, kur ato kanë kërkuar ndihmë juridike për mungesë të të ardhurave të tyre për përballimin e shpenzimeve gjyqësore, në 14 raste ia kemi referuar ankesën Klinikave Ligjore të Ndhmës Juridike falas.

b. Ankesa për çështjet në gjykim

Gjatë periudhës raportuese janë paraqitur nga shtetas të ndryshëm 43 ankesa apo kërkesa me 46 persona ndaj çështjeve në gjykim e sipër nga Gjykatat e Rrethit, Gjykatat e Apelit dhe Gjykata e Lartë.

Sipas rretheve, rezulton se, nga qyteti Tiranë janë 11 ose 25,6%, kurse nga rrethet e tjera 32 ose 74.4%.

1. Ankesat në gjykim për Gjykatat e Rretheve

Nga numri i përgjithshëm i ankesave në gjykim, Gjykatave të Rretheve u përkasin 28 ose 65% e tyre. Si objekt i përmbajtjes së ankesave të shtetasve të ndryshëm kanë qenë zvarritjet në gjykimin e çështjeve penale ose civile pa shkaqe ligjore apo justifikuese, mosvënie në dijeni të palëve për seancat gjyqësore, mosnjoftimi i vendimeve gjyqësore të padrejta etj.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave apo kërkesave të zgjidhura në favor të shtetasve, po përmendim dy si më tipike:

A. dhe M. Q. ankohen në Institucionin tonë se Gjykata e rrethit Gjirokastrë pa asnjë shkak ligjor apo justifikues nuk përfundon gjykimin e çështjes penale në ngarkim të Harri Lenës. Nga verifikimi në vend i kësaj ankesë, doli se Gjykata, pa ndonjë shkak ligjor, nuk përfundonte gjykimin e çështjes. Pas ndërhyrjes tonë ajo e përfundoi gjykimin e çështjes.

Si shembull në këtë drejtim mund të përmendim edhe rastin e F. B. me 14 persona të tjerë, të cilët në ankesën e tyre pretendonin se Gjykata e Rrethit Vlorë, pa shkaqe ligjore, zvarriste gjykimin e çështjes nga njëra seancë në tjetrën. Nga verifikimi i bërë nga ana jonë, rezultoi se ankesa e këtyre shtetasve ishte e drejtë, mbasi gjykimi i çështjes nuk bëhej për shkak se gjyqtari ishte larguar jashtë shtetit dhe megjithatë çështja qëndronte pa u gjykuar. Mbi bazën e kërkesës tonë, kryetari i Gjykatës së Rrethit Vlorë bëri zëvendësimin e këtij gjyqtari me një gjyqtar tjetër dhe çështja përfundoi së gjykuari.

2. Ankesa ndaj Gjykatave të Apelit

Janë evidentuar si të tilla 19 raste, ku objekti i përmbajtjes së tyre bënte fjalë për zvarritje në gjykimin e çështjeve gjyqësore, mosarsyetim vendimesh, vonesa në

dërgimin e dosjeve të përfunduara gjykatave të rretheve përkatëse, etj. Nga verifikimi i bërë ndaj këtyre ankesave, ka rezultuar se në dy raste ato kanë qënë të drejta dhe për pasojë zgjidhja është bërë në favor të ankuesve. Kështu, mund të përmendim si shembull rastet e I. K. dhe atë të Sindikatës së Transporteve Tiranë, të cilët në ankimin e tyre pretendonin zvarritje të theksuara në gjykimin e çështjeve civile të tyre. Ndërhyrja jonë bëri të mundur gjykimin e shpejtë të këtyre dy çështjeve civile.

3. Ankesa ndaj Gjykatës së Lartë

Gjatë periudhës raportuese, na janë paraqitur 10 ankesa ndaj Gjykatës së Lartë. Ankimi ka qënë për zvarritje në gjykimin e tyre, për mospjesëmarrje të avokatit të tyre në rastet kur Gjykata ka marrë vendim për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, ose për të qënë vetë të pranishëm bashkë me avokatin në gjykimin e çështjes etj. Nga ana e Institucionit tonë, sipas rastit është ndërhyrë për të përshpejtuar gjykimin në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit ka bërë të mundur pranishmërinë e palëve krahas avokatëve gjatë gjykimit të çështjes. Kjo është një zgjidhje në përputhje me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, sepse dihet se deri në fillim të vitit 2000 Gjykata e Lartë nuk i lejonte palët të asistonin në gjykimin e çështjeve të tyre.

Nga ana tjetër ka patur edhe mjaft kërkesa që Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij të marrin pjesë në shqyrtimin e kërkesave të tyre, në mënyrë që, sipas tyre, të kishin siguri për drejtësinë e vendimeve të gjykatave.

Në të gjitha rastet këta kërkues janë sqaruar se kjo kërkesë e tyre është në kundërshtim me ligjet dhe me parimet e punës së Avokatit të Popullit dhe, kur ka qënë rasti, u janë referuar për ndihmë juridike falas klinikave ligjore.

Duke studjuar këto ankesa kundër organeve të pushtetit gjyqësor kemi krijuar bindje se ka vend për të

propozuar ndryshime apo plotësime në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale.

a. Shtetasve të ndryshëm dhe avokatëve të tyre t'u jepet mundësia e pjesëmarrjes drejtëpërdrejt në gjykimin e çështjeve të tyre që lidhen me kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit, parashikuar nga neni 449 i K.Pr.Civile. Prania e tyre si palë në gjykim jo vetëm se do të realizojë një të drejtë të tyre për të parë në mënyrë direkte mënyrën e trajtimit të çështjes nga gjykata, por do t'u sigurojë edhe mundësinë për të paraqitur pretendimet e tyre nëse kanë të tilla, duke i dhënë kështu mundësinë Gjykatës të vendosë për marrjen e një vendimi të drejtë e të bazuar në ligj.

b. Kodi i Procedurës Penale duhet të lejojë personat e familjes së viktimave nga kryerja e një vepre penale, për t'u përfaqësuar në mënyrë direkte në gjyq ose me një avokat mbrojtës të tyre. Kjo do të bënte të mundur ballancimin e mbrojtjes së të pandehurit dhe të viktimës nga ana tjetër. Nga ankesat e paraqitura para nesh, në mjaft raste është pretenduar që çështjet penale janë zgjidhur nga ana e gjykatës në dëm të viktimës, thjesht për shkaqe korrupsioni.

Këto mendime janë akoma në studim, por besojmë që ato do t'i paraqesim në mënyrën e duhur pranë organeve që kanë të drejtën e iniciativës ligjvënëse.

4 ANKESAT PËR ZYRAT E PËRMBARIMIT (Pasqyra nr.11)

Për periudhën raportuese janë paraqitur 67 ankesa apo kërkesa me 77 persona.

Sipas rretheve rezulton se: rrethit të Tiranës i përkasin 18 ose 26,9%, kurse, rretheve të tjera 49 ose 73,1%.

Duke parë mënyrën e zgjidhjes së këtyre ankesave, rezulton se 13 ose 19% e tyre janë zgjidhur në favor, 18 ose 26% janë dërguar për kompetencë, 15 ose 22% janë refuzuar dhe 16 ose 23% janë në shqyrtim.

Meqenëse zgjidhja e një pjese të këtyre ankesave lidhej me Ministrinë e Drejtësisë dhe të Financave, nga ana jonë është ndërhyrë pranë këtyre institucioneve. Kështu, në Ministrinë e Drejtësisë është ndërhyrë në 4 raste, ndërsa në Ministrinë e Financave në 12 raste.

Si raste të ndërhyrjes tonë në Ministrinë e Drejtësisë dhe të zgjidhura në favor të ankuesve, mund të përmendim ankesën e Ll. Ç. që ankohej ndaj përmbarimit të rrethit Korçë, sepse pa shkaqe ligjore nuk ekzekutohej plotësisht një vendim gjyqësor i formës së prerë që nga viti 1994. Pasi problemi u verifikua në vend 3 herë, pas ndërhyrjes sonë, ky vendim gjyqësor u vu në ekzekutim. Në këtë mënyrë ka ndodhur dhe në rastet me T. M. e rrethit Sarandë, H. S. në rrethin Tepelenë, N. K. në rrethin Mat etj.

Ndërsa për ankesat që lidhen me Ministrinë e Financave dhe të zgjidhura në favor, përmendim rastin e Rr. O. nga Lezha, të cilit me ndërhyrjen tonë iu kthyen të hollat për dëmin që i ishte shkaktuar. Në këtë mënyrë është bërë zgjidhja ndaj K. P. në Pogradec, ku veç ekzekutimit të vendimit, u morën dhe masa disiplinore ndaj Drejtuesit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Kryetarit të degës së Financës të cilët bëheshin pengesë për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Problemi i mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ku institucionet buxhetore janë detyruar të shlyejnë shuma të caktuara ndaj personave fizikë ose juridikë, është i rëndësishëm dhe Institucioni ynë është përqëndruar për të ndihmuar zgjidhjen e tij qysh në fillim. Deri në korrik 2000 zyrat e përmbarimit kanë raportuar në Ministrinë e Drejtësisë 453 vendime të tilla, me një debit rreth 6 milion dollarë.

Për zgjidhjen e kësaj situate nga ana jonë i është drejtuar me datën 12.10.2000 Kryeministrit, zotit Ilir Meta, Rekomandimi me këtë përmbajtje:

K R Y E M I N I S T R I T

ZOTIT ILIR META

T i r a n ë

I nderuar zoti Kryeministër!

Në Institucionin tonë kanë ardhur shumë ankesa nga persona fizikë dhe juridikë në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, kur debitorë janë institucionet buxhetore.

Ndër pengesat për këtë çështje mund të përmendim:

1. Mungesën e parashikimit në Buxhetin e Shtetit të parave, prandaj duhet menduar për burimin e këtyre të ardhurave, goftë edhe nëpërmjet kërkesës për akordimin e ndonjë kredie specifike, në kuadrin e realizimit të projekteve të Paktit të Stabilitetit.

2. Mendimet e shprehura nga Institucionet buxhetore të interesuara për “padrejtësitë” e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, por që shpesh herë këto institucione i lënë vetëm në kuadrin e opinionëve, pa i avancuar këto mendime në kërkesa ankimore, sipas afateve dhe normave që ka caktuar Kodi i Proçedurës Civile.

Ky është një problem serioz për gjithë shoqërinë dhe Institucionet shqiptare, por në veçanti për Institucionin që Unë drejtoj. Kjo sepse, pavarësisht nga “mendimet” për drejtësinë apo padrejtësinë e vendimeve gjyqësore, kur para nesh qytetarët paraqiten me vendime gjyqësore të formës së prerë dhe kërkojnë zbatimin e Kushtetutës dhe ligjeve nga Administrata Shqiptare, por edhe nga Institucioni ynë, nuk mund të qëndrojmë pasivë sepse cënohen hapur të Drejtat e Njeriut dhe funksionimi normal i Shtetit të së Drejtës.

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore është një shkelje flagrante e nenit 142, pika 3 të Kushtetutës, ku

thuhet se: "Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore".

Për këto arsye nga ana jonë është kërkuar bashkëveprimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Financave për t'i dhënë zgjidhje e për ta mbyllur njëherë e mirë këtë "plagë" të shoqërisë shqiptare në tranzicion.

Të dy këto Institucione janë shprehur pozitivisht për nevojën e zgjidhjes së këtij problemi dhe Ministria e Drejtësisë ka dërguar një pasqyrë përmbledhëse të të dhënave të zyrave të përmbarimit. Rezulton se deri me datën 12.07.2000 shuma e llogaritur është afërsisht 6 milion USD. Kjo shumë mund të jetë edhe më e madhe, sepse mjaft kreditorë nuk i kanë depozituar vendimet e tyre në zyrat e përmbarimit për shkak se, duke mos patur besim në ekzekutimin e vendimeve të tyre, nuk duan të shpenzojnë edhe tarifën e pagesës së përmbarimit, që është rreth 3-7% të vlerës që ato kërkojnë.

Megjithë këtë, detyrimi i Administratës Shqiptare është t'u përgjigjet qytetarëve që kanë depozituar vendimet sipas ligjit, prandaj meqë është faza e parashikimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2001, në bazë të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës dhe pikës "c" të nenit 21 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", këtë problem ja kemi ngritur Ministrisë së Financave, por Autoriteti i vetëm kompetent për të marrë vendime në raste të tilla jeni Ju.

Për këto arsye:

REKOMANDOJMË

Në projekt Buxhetin e Shtetit për vitin 2001 të planifikohet edhe një shumë, të paktën 6 milion USD, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ku janë debitorë institucionet buxhetore.

Siç dihet, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Buxhetin e shtetit për vitin 2001 dhe për qëllimin e mësipërm janë parashikuar 100 milion lekë të reja, ose rreth 12% e

shumës së nevojshme, të cilat janë lënë në buxhetin e Ministrisë së Financave, me qëllim që kjo Ministri të menazhojë këtë problem.

Ekziston Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.355, dt.02.06.1998 “Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit”, i cili në pikën 1 të tij ka caktuar Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Financave që të nxjerrin një udhëzim të përbashkët për të përcaktuar kriteret dhe procedurat për zbatimin e këtyre vendimeve gjyqësore, por deri tani ky udhëzim nuk ka dalë. Ministria e Financave pretendon se projektin e ka pezulluar Ministria e Drejtësisë që në vitin 1999.

Duke qenë e tillë gjendja, Ministria e Financave është kthyer pa vend në organ mbi gjykatat, sepse ajo bën seleksionimin se cili vendim duhet të zbatohet ose jo. Aq më keq se për vitin 2000 fondi i planifikuar për këtë qëllim ka qenë përsëri 100 milion lekë, por është shpenzuar vetëm 63%, në një kohë që me 37 milionat e “kursyer” mund të ishin ekzekutuar edhe një numër jo i vogël vendimesh gjyqësore, sidomos të tilla si mosdhënie pagash, shpërblime dëmi etj.

5. ANKESAT DHE KËRKESAT KUNDËR ORGANEVE TË POLICISË SË RENDIT (Pasqyra nr.12)

Pranimi, verifikimi dhe zgjidhja e ankesave dhe kërkesave ndaj policisë së rendit ka qenë një nga prioritetet e Institucionit tonë për shkak se organet e policisë kanë detyra specifike, moskryerja me korrektesë e të cilave shpesh çon në dhunime dhe shkelje të rënda të të drejtave dhe lirive themelore të individëve, siç janë jeta, liria personale, liria dhe fshehtësia e korrespondencës, paprekshmëria e banesës, e drejta e azilit politik etj.

Kështu, për organet e policisë në periudhën raportuese janë evidentuar gjithsej 76 ankesa ose rreth 9% e gjithë ankesave të ardhura gjatë vitit 2000. Nga këto,

subjektet nga Tirana kanë qenë 26 ankesa, kurse nga rrethet e tjera 50 ankesa. Për komisaritet e policisë kanë qenë 59 ankesa, kurse për Ministrinë e Rendit Publik 17 ankesa.

Nga 76 ankesa, 7 kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencave tona, 21 ankesa janë refuzuar si të padrejta, kurse 34 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve dhe 14 janë në shqyrtim.

Nga 76 ankesa, 28 kanë qenë për keqtrajtime të individëve, kurse veprime arbitrare dhe kapërcim të kompetencave të organeve të policisë si kontrole të paligjshme të banesave, nxjerrje forcërisht nga banesa, ndalime të paligjshme, bllokim sendesh pa të drejtë janë 13 raste.

Ndër ankesat e zgjidhura në favor të individëve mund të përmendim rastet e mëposhtme:

a. Duke marrë shkas nga një shkrim në gazetë se fëmija 11 vjeçar E. Sh., jetim në shtëpinë e Fëmijës Sarandë, ishte keqtrajtuar nga ana e policisë Sarandë, bëmë verifikimin e çështjes në vënd. Nga verifikimi rezultoi se punonjësi i policisë kriminale të rrethit Sarandë, Rrapo Xhavara, në datën 26.06.2000 kishte kryer veprime haptazi të paligjshme duke dhunuar në mënyrë brutale të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, aq më tepër të një fëmije, të cilat janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik” (neni 15 i Kushtetutës).

1. Marrja dhe shoqërimi në Komisariatin e Policisë Sarandë, i fëmijës E. Sh., në datën 26.06.2000 ora 16³⁰ si dhe mbajtja e tij deri në datën 27.06.2000 ora 12³⁰, për një kohë prej 20 orësh, është haptazi e paligjshme dhe në kundërshtim me të gjitha kriteret ligjore që nevojiten në këto raste. Kjo për faktin se nga njëra anë, E. Sh. për shkak të të qenit të tij fëmijë, në moshën 11 vjeç, nuk është subjekt për t’u ndaluar apo shoqëruar në polici, mbasi nuk plotëson moshën për përgjegjësi penale, 14 vjeç (neni 12 i K.P.), kurse nga ana tjetër, në drejtim të tij nuk ka

pasur asnjë të dhënë si autor i mundshëm i vjedhjes së çantës me të holla të qytetarit F. M.

2. Po kështu, gjatë kohës që ai është mbajtur në polici, ndonëse nuk është marrë me cilësinë e të pandehurit, pasi ka qënë nën moshën ligjore (14 vjeç), në realitet është trajtuar me këtë cilësi, duke i bërë pyetje mbi autorësinë e vjedhjes ndaj qytetarit F. M., si dhe kryer veprime të tjera me karakter hetimor, bile është bërë përgjim bisede me O. dhe E. Q. etj, të cilat përshkruhen në raportin e shërbimit të policisë dt.26.05.2000. Për më tepër, këto veprime janë kryer pa praninë e një kujdestari apo mbrojtësi të tij, për të siguruar objektivitetin në kryerjen e këtij veprimi dhe dhënien e shpjegimeve të lira e të vullnetshme nga personi i pyetur. Kjo, ka sjellë si pasojë që E. Sh. të marrë përsipër autorësinë e veprës penale pa qënë në fakt autor i saj, ndërkohë kur siç ka rezultuar, autor i kësaj vepre ishte një person tjetër.

3. Gjithashtu, gjatë qëndrimit të E. Sh. në polici, ndaj tij është përdorur dhunë, duke e goditur me shkop gome, me thikë në krahun e djathtë, duke i fikur cigaren në trup etj, fakte këto jo vetëm që pretendohen nga ankuesi, por që edhe konfirmohen nga edukatorët e tij të Shtëpisë së Fëmijës Sarandë, të cilët e kanë parë dhe mjekuar atë pas daljes nga komisarati i policisë. Çarja e krahut të djathtë me thikë dhe fikja e cigares në trup, u konstatuan edhe nga punonjësi ynë i dërguar për verifikimin e çështjes, ndonëse nga momenti i shkaktimit të tyre kishte kaluar gati një muaj kohë.

Nga sa më sipër doli në mënyrë të qartë dhe bindëse se oficeri i policisë Sarandë, Rrapo Xhavara ka vepruar haptazi e në mënyrë brutale në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin penal procedural, duke shkelur dhe dëmtuar rëndë lirinë dhe të drejtat e qytetarit E. Sh.. Veprimet e këtij oficeri ishin kryer me ndërgjegje të plotë. Përgjegjësi kishin edhe drejtuesit e komisarariatit të policisë Sarandë, të cilët me ardhjen në dizeni, duhet të kishin parandaluar këtë shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut nga vartësi i tyre.

Duke u nisur nga shkelja e rëndë e lirisë dhe të drejtave të njeriut, të E. Sh., të cilat përbëjnë elementet e një vepre penale, i kërkuam Prokurorisë së Rrethit Sarandë, ndjekjen penale ndërsa në bazë të nenit 63 të Kushtetutës si dhe neneve 21 e 22 të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, Ministrisë së Rendit ju rekomandua nxjerrja në lirim e oficerit Rrapo Xhavana.

Ndërsa Ministria e Rendit Publik mbajti qëndrim të drejtë, duke zbatuar këtë rekomandim, Prokuroria e Rrethit Sarandë bëri një punë pa përgjegjësi dhe e pushoi çështjen penale, bile pa na vënë fare në dijeni për vendimin e saj. Pasi u vumë në dijeni për këtë fakt, i kemi kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm që të rifillojë hetimet për këtë çështje, por akoma nuk kemi përgjigje për qëndrimin e tij. Gjithashtu edhe Gjykata e Rrethit Sarandë, në mënyrë të papërgjegjshme vendosi në rrugë civile që këtij oficeri t’i jepet paga për një vit, por mbi ankesën e Ministrisë së Rendit Publik, Gjykata e Apelit Gjirokastër e ka prishur këtë vendim dhe ka kthyer çështjen për gjykim në Gjykatën e rrethit të Sarandës.

Por paradokset në lidhje me këtë çështje vazhdojnë më tej.

Para rreth një muaji, Kryetari i degës së Shoqatës së Arumunëve të Shqipërisë për Sarandën është ankuar pranë Zyrës së OSBE-së në Tiranë se ndaj arumunëve në Sarandë ka diskriminim nga policia shqiptare.

Ndër të tjera ankohet se ish oficeri i policisë Rrapo Xhavana është liruar nga detyra, sepse është arumun.

Ndërsa dy problemet e tjera që janë ngritur në atë ankesë janë në shqyrtim, për rastin e arumunit Rrapo Xhavana, siç përshkruhet më sipër, mendojmë se nuk ka nevojë për komente të tjera, veçse përgjigjes se shkelësit e të drejtave të njeriut, aq më tepër të fëmijëve, nuk duhen marrë në mbrojtje, pavarësisht se ato bëhen nga policë puro shqiptarë apo arumunë.

b. Pranë Institucionit tonë bëri ankim shtetasi S. O. i cili pretendoi se në dt.23.08.2000 rreth orës 7³⁰, është rrahur dhe keqtrajtuar nga polici efektiv i komisariatit të policisë Kuçovë Adrian Foto.

Nga hetimi konkret rezultoi se:

Më dt.23.08.2000 rreth orës 7³⁰ pranë portës së fabrikës së detergjenteve të Kuçovës ka mbërritur mikrobuzi i grupit të gatshëm me efektiv të komisariatit të policisë Kuçovë, ku përgjegjës ishte polici M. T. Pasi janë shkëmbyer fjalë në lidhje me telefonatat e bëra pranë komisariatit një ditë më parë për problemin e pezullimit të punimeve në një objekt brënda ndërmarrjes, polici Adrian Foto zbriti nga mikrobuzi dhe goditi me grushta dhe shqelma në fytyrë shtetasin S. O., i cili kryente detyrën e rojes pranë fabrikës së detergjentëve Kuçovë. Si rezultat i këtyre goditjeve shtetasi S. O. pësoi çarje të buzës dhe thyerje në nofull.

Në lidhje sa më sipër, në mbështetje të nenit 21 gërma “b” dhe “d”, duke i konsideruar veprimet e policit Adrian Foto shkelje të rënda në dëm të të drejtave të njeriut, rekomanduam të merret masa e lirimit të tij të menjëhershëm nga radhët e policisë si dhe analizimin e çështjes me gjithë efektivin e komisariatit, me qëllim për të nxjerrë përgjegjësinë për veprimet e mosveprimet e personave të tjerë.

Mbi bazën e këtij rekomandimi Komisariati i Policisë Kuçovë vendosi të nxjerrë në lirim para kohe policin Adrian Foto me motivacionin: “Për përdorim dhune të panevojshme”. Kurse qytetari i dëmtuar nuk dëshëroi që të bënte kallëzim penal ndaj policit.

c. Pranë Institucionit tonë u ankua shtetasi M. G. nga Fieri, se referenti i inspektorëve në komisariatit të policisë Fier, kapiten Bashkim Bushi, pa asnjë shkak ligjor më datën 14.03.2000 e ka nxjerrë jashtë forcërisht nga banesa që kishte marrë me qera. Për pasojë, M. G., nga kjo datë e në vazhdim, së bashku me familjen e tij qëndron në mes të katër rrugëve.

Nga verifikimi në vënd i kësaj ankese, rezultoi se nxjerrja jashtë forcërisht, nga banesa me qera ishte haptazi e paligjshme, dhe se kapiten Bashkim Bushi kishte cënuar brutalisht të drejtat e garantuara me ligj të M. G., të

parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, “të cilat nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor”.

1. Veprimi i kryer nga oficeri i policisë, Bashkim Bushi, nuk mbështetet në asnjë dispozitë ligjore, përkundrazi ai ishte tërësisht arbitrar. Në rastin konkret ky person ka vepruar pa asnjë tagër ligjor. Ai nuk ka patur për zbatim asnjë titull ekzekutiv (vendim) për ta vënë në ekzekutim sipas ligjit.

Justifikimi i kapiten Bashkim Bushit me nenin 6 të ligjit nr.7498 dt.05.07.1991 “Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë”, nuk qëndronte për faktin se, sipas kësaj dispozite, policia vepron vetëm në rastet kur “zënia dhe përdorimi arbitrarisht i apartamenteve të banimit apo i mjediseve të tjerë shtetërore ose private, është kryer pa lidhur më parë kontratën përkatëse”. Në rastin konkret, M. G. ka qenë qiramarrës në atë banesë, me kontratë të rregullt qeraje me shtetin që nga viti 1981 e mandej me pronarin e kësaj banese E. Ç. Kalimi i pronësisë së kësaj banese nga E. Ç. në pronësi të Dh. Zh., ligjërisht nuk ka hequr të drejtën e M. G. të vazhdojë të banonte në këtë banesë me qera derisa shteti t’i sigurojë atij kredi apo një sipërfaqe tjetër banimi. Kërkesa e pronarit të kësaj banese, Dh. Zh. drejtuar komisarariatit të policisë Fier, për lirim të saj nga M. G., ka qenë e pabazuar në ligj, dhe për rrjedhojë mbi bazën e saj nuk duhej të veprimej.

2. Shtetasi M. G., duke parë që referenti i policisë Bashkim Bushi ishte i vendosur për ta nxjerrë forcërisht nga banesa, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë padi për të mos vepruar ndaj tij pa mos ju siguruar më parë një sipërfaqe banimi apo dhënie kredie nga shteti, pra për të mbrojtur të drejtën e qerasë së banesës me anë të një procesi të rregullt ligjor. Por nxjerrja jashtë nga banesa në mënyrë të paligjshme prej kapiten Bashkim Bushit, nuk i ka lënë mundësi që të ushtrojë këtë të drejtë që ia njeh neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Referenti i komisarariatit të policisë Fier, Bashkim Bushi ka vepruar edhe në kundërshtim me urdhërin e dhënë nga Kryetari i Bashkisë Fier, me shkresën nr.39 dt.07.03.2000, për

të mos e nxjerrë forcërisht nga banesa M. G., pa u zgjidhur më parë nga shteti dhënia e një kredie, si familje e pastrehë.

4. Gjithashtu, Bashkim Bushi ka patur porosi edhe nga drejtori i policisë Fier 999 për të mos vepruar, sepse nuk kishte bazë ligjore e për pasojë shkeleshin të drejtat e qytetarit, e megjithatë ai ka ekzekutuar veprimin e tij të paligjshëm.

Nga sa më sipër doli në mënyrë të qartë dhe bindëse, se oficeri i policisë Bashkim Bushi kishte vepruar haptazi në mënyrë flagrante në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke shkelur dhe dëmtuar rëndë të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasit M. G., duke e lënë atë e familjen e tij pa asnjë strehë banimi. Ne nuk mund të nxjerrim motivin që e ka nxitur këtë oficer policie për të shkelur ligjet, por nga rrethanat e ngjarjes del qartë se këto veprime janë kryer me dashje e me ndërgjegje të plotë dhe jo nga mungesa e eksperiencës në punë apo nga padijenja e ligjit. Gjithashtu, mendojmë se përgjegjësi kanë edhe drejtuesit e komisariatit të policisë Fier, të cilët kanë patur dijeni për sa ndodhi dhe kishin mundësi të parandalonin këtë shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut nga një vartës i tyre.

Këto veprime të paligjshme të oficerit të policisë Bashkim Bushi nuk pajtohen edhe me Kodin e Etikës së Policisë, bile përbëjnë vepër penale.

Rekomandimit tonë, për nxjerrjen në lirim të Bashkim Bushit, Ministria e Rendit iu përgjigj duke marrë masën e zbritjes në detyrë.

Disa raste të tjera të zgjidhjes pozitive të ankesave kundër organeve të policisë.

1. Ankesa e ardhur nga OSBE për keqtrajtimin që policët e komisariatit Pogradec u kishin bërë dy shtetasve A. D. e E. B., banorë të fshatit Sovjan të rrethit Korçë. Ankesa u vlerësua, menjëherë shkuam në vend, gjetëm e

pyetëm të dënuarit dhe persona të tjerë që kishin dijeni për problemin. Nga verifikimi rezultoi se ankesa ishte e drejtë dhe se punonjësit e policisë që kishin bërë keqtrajtimin e qytetarëve ishin Fredi Kodra e Kastriot Elmazllari.

Duke qenë se dy të dëmtuarit nuk dëshironin ndjekjen e mëtejshme të problemit ndaj policëve, ne nuk kërkuam masa ndaj tyre, por shefi i Komisarariatit të policisë Pogradec u dha masa disiplinore shkelësve të ligjit.

2. Ankesa e shtetasit E. B., administrator i shpk "Belavis", i cili ankohet ndaj veprimeve arbitrare të punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë, të cilët kishin hequr reklamat e shoqërisë së tij në mbikalimet e autostradës Tiranë-Vorë, në afërsi të Kasharit, dhe në vend të tyre kishin vënë reklamat e shoqërisë MBA-SPOT shpk. Nga verifikimi i ankesës rezultoi se veprimet e policisë, të kryera me urdhër të drejtuesve të saj z. Muhamet Dyrmishi e Eduard Çelmeta, ishin të kundërligjshme, sepse ishin në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.8553 dt.25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", dhe të ligjit nr.8378, dt.27.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë". Gjithashtu ata kishin kapërcyer kompetencat institucionale, duke bërë vlerësimin e kontratave civile, kompetencë kjo ekskluzive e Gjykatës.

Iu kërkua drejtorit të përgjithshëm të policisë dhënia e masave disiplinore ndaj drejtuesve të komisarariatit, propozimi u konsiderua i drejtë dhe të dy drejtuesit e Komisarariatit u transferuan dhe u ulën në detyrë.

Nga thellimi i verifikimit të kësaj ankese rezultoi që në të gjitha rrugët e territorit të Republikës janë vendosur reklama në kundërshtim me "Kodin Rrugor" dhe ligjin "Për urbanistikën". Kjo gjendje është sepse Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ka lidhur me MBA-SPOT shpk, një kontratë me afat 5 vjeçar të kundërligjshme me objekt vendosjen e reklamave, jo vetëm në mbikalimet e autostradës Tiranë Durrës, por në të gjitha rrugët kryesore të Shqipërisë dhe aq më keq, në kushte të disfavorshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe me çmime

shumë favorizuese. Tashmë MBA-SPOT shpk (Telebingoja Kombëtare) e ka dhënë të drejtën e saj për të vendosur reklama me qera subjekteve të tjera, duke vjelur fitime të majme.

Mbi këtë bazë iu rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Rrugëve zgjidhja e kontratës, por nuk kemi marrë përgjigje. Nëse kjo kontratë lë shteg për korrupsion, Institucioni ynë nuk është në gjendje ta vërtetojë këtë.

3. Ankesa e shtetasit G. M., ndaj ish shefit të rendit të rajonit nr.2 Tiranë z. Bedri Hasani, i cili së bashku me një grup policësh e kanë nxjerrë forcërisht nga banesa që e ka të hipotekuar, dhe në vend të tij futën një qytetar tjetër, që s'kishte një dokument të tillë. Nga verifikimi i problemit rezultoi se ankuesi është pronar i ligjshëm i banesës nga e cila është nxjerrë dhe se punonjësit e policisë ishin urdhëruar nga ish Drejtori i Rendit në Ministrinë e Rendit Publik z. Albert Dervishi. Urdhëri i tij ishte i parregullt dhe haptazi i kundraligjshëm, se nuk kishte pse të merrej personalisht me ankesën, por ta drejtonte atë në Komisaratin e Policisë nr.2, i cili pa dyshim, pasi të bënte verifikimet, nuk do ta kishte kryer shkeljen.

Për të vendosur në vend të drejtën e shkelur nga punonjësit e policisë ju rekomandua drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që t'i kthehej banesa shtetasit G. M. si dhe të jepeshin masa disiplinore ndaj z. Albert Dervishi dhe Bedri Hasani, por ky organ është përgjigjur pa të drejtë se pret përfundimin e çështjes nga Prokuroria. Për këtë arsye propozimi i është paraqitur Ministrit të Rendit Publik dhe presim reagimin e tij.

4. Dy policët e Komisariatit të Policisë Kavajë Z. T. dhe S. L. nuk ishin dakort me lirimin dhe motivacionin e lirim, "për nxjerrje sekreti". Me marrjen e ankesës u bënë verifikimet në Komisaratin e Policisë Kavajë, duke parë dosjet personale të tyre dhe gjithë materialet që kishin shërbyer si bazë për lirimin e tyre. Nga verifikimi i

problemit rezultoi se nuk krijohet bindja për shkelje të sekretit dhe konstatoam se urdhëri i lirimit ishte bërë nga shefi i komisariatit, gjë e cila binte në kundërshtim me nenin 19 pika 1 e ligjit nr.8553 dt.25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” për faktin se të drejtën për lirimin nga detyra të policëve e ka kompetencë Drejtori i Policisë së Qarkut.

Për këto arsye, i propozuam drejtorit të policisë së qarkut Tiranë shfuqizimin e urdhërave të lirimit, të nxjerra nga shefi i komisariatit Kavajë, dhe rikthimin në punë të tyre. Ky rekomandim është pranuar.

Ndër rastet e tjera të ankesave të zgjidhura në favor të ankuesve kanë qenë ato për mosdhënien e kopjeve të urdhërave të lirimit për oficerë dhe nënoficerë të liruar apo dokumenteve të tjera zyrtare etj, për të cilat organeve të policisë që kanë kryer këtë shkelje iu është bërë e njohur se kanë vepruar në kundërshtim me ligjin nr.8503 dt. 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” dhe me ligjin nr.8517 dt.22.07. 1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Megjithëse në përgjithësi ka patur kuptim shumë të drejtë të misionit të Institucionit të Avokatit të Popullit nga ana e drejtuesve kryesorë të Ministrisë së Rendit Publik, duke zbatuar në përgjithësi rekomandimet tona dhe duke u ofruar për bashkëpunim, nuk kanë munguar edhe problemet si mosdhënie e shpjegimeve brenda afatit maksimal 30 ditor, mosparaqitja e disa punonjësve të policisë për të dhënë shpjegimet e kërkuara në Tiranë dhe Lezhë, mos zbatim i Rekomandimeve nga Ministria e Rendit Publik për ekzekutimin e disa vendimeve gjyqësore të formës së prerë për pagim page apo kthim banese.

Gjithashtu konstatohet se nuk janë botuar në Fletoren Zyrtare disa Vendime të Këshillit të Ministrave të cilat kanë dalë në bazë e për zbatim të ligjit nr.8553 dt.25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Disa nga shkaqet që kanë çuar në shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e punonjësve të Policisë janë:

-
- Mosnjohja e duhur e legjislacionit, sidomos Kushtetutës dhe ligjit “Për Policinë e Shtetit”, të cilat garantojnë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
 - Mosnjohja sa duhet e konventave ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të cilat janë akte të pranuar nga shteti ynë, çka do të thotë marrjen përsipër të detyrimeve për respektimin e tyre.
 - Niveli akoma i ulët kulturor e profesional i punonjësve të policisë, sidomos i atyre të rolit bazë (policëve).
 - Mentaliteti i gabuar “i të fortit” që ekziston i trashëguar në radhët e policisë në përgjithësi, dhe në disa kuadro të veçantë drejtues të saj “se policia është shteti, se policia bën ligjin” etj.
 - Mungesa e përgjithësimeve të duhura të rasteve negative të shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me qëllim parandalimin e tyre në të ardhmen.
 - Ekzistenca e një fryme liberalizmi dhe mungesa e kërkesës së llogarisë nga kuadrot drejtuese dhe indiferenca e tyre përballë shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të kryera nga vartësit e tyre, që vjen si pasojë e mosformimit të plotë të tyre si dhe e frikës për mosdaljen e namit të keq.
 - Gjendja relativisht e rëndë e rendit që po kalojmë dhe veçanërisht vrasja e plagosja e shumë punonjësve të policisë, sidomos vitet e fundit, ndikon në humbjen e vetëkontrollit e qetësisë së tyre në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut gjatë ushtrimit të detyrave funksionale.
 - Megjithatë është shumë pozitive që në të gjitha rastet e verifikuara ose të hetuara nga ana jonë nuk del që për shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, policët të kenë vepruar në zbatim të një direktive apo udhëzimeve të drejtuesave të tyre. Shkeljet rezultojnë se kanë qenë veprime individuale të policëve të veçanta që për t’u dukur se punojnë, për t’u lavdëruar që të arrijnë më lart në karrierë, apo që të marrin edhe shpërblime të pamërituara, bëjnë me kokën e tyre shkelje të ligjeve dhe të drejtave të njeriut.
-

Pra dhuna dhe paligjshmëria në organet e Policisë së Rendit për mendimin tonë nuk janë institucionale, të njohura e të drejtuara me një strategji të caktuar nga qendra, për të realizuar dhe justifikuar dhunën.

Ky konkluzion rrjedh edhe nga fakti se drejtuesit kryesore të Policisë e të Ministrisë së Rendit kanë qenë shpesh herë të gatshme të bashkëpunojnë e t'ju përgjigjen pozitivisht Rekomandimeve tona.

Për përmirësimin e punës kemi menduar që në bashkëpunim me Ministrinë e Rendit Publik të bëjmë seminare me kuadrot drejtues të Komisariateve e të reparteve të policisë në shkallë vendi me qëllim njohje të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, të misionit të këtij Institucioni si dhe të ligjeve të tjera të fushës së policisë, për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të Njeriut, për të cilat edhe organet e Administratës së Policisë konstatojnë se janë me të vërtetë të interesuara që të respektohen e të mbrohen.

Duke patur parasysh edhe konstatimet dhe rekomandimet e Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës (CPT) duhet që policia të organizojë shërbimin mjekësor sistematik për vizitat e detyrueshme që duhet t'i bëhet te cilido i ndaluar gjatë 48 orëve të hyrjes së tij në paraburgim (përfshirë edhe në godinat e policisë që përdoren për paraburgim). Në çdo rast që mjeku vë re gjurmë dhune, duhet t'ja referojë gjendjen prokurorit përkatës. Kjo procedurë ka hyrë në fuqi në burgun 313 Tiranë.

6. Mbi kërkesat dhe njoftimet e ardhura nga burgjet (Pasqyra nr.13)

Për periudhën që po analizojmë në Institucionin e Avokatit të Popullit janë paraqitur gjithësej 30 ankesa të ardhura nga burgjet dhe dhomat e izolimit që ndodhen pranë komisariateve të policisë në rrethe.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave dhe kërkesave të ardhura nga burgjet në 6 raste ato janë paraqitur nga gratë dhe në 24 raste të tjera janë paraqitur nga burrat.

Ndonëse numri i ankesave është relativisht i vogël, ato kanë shpërndarje në të gjitha burgjet që aktualisht janë në efikasitet në Shqipëri.

Sipas përmbajtjes së tyre ankesat e paraqitura janë:

- Të burgosurit në 17 raste kanë pretenduar se vendimet e Gjykatës janë të padrejta dhe se gjendja e tyre ekonomike e dobët nuk lejon që të marrin avokat privat;
- Në 4 raste të dënuarit kanë kërkuar të ndihmohen për t'u liruar nga burgju;
- Në 2 raste të burgosurit kanë hyrë në grevë urie, duke pretenduar për zvarritje në hetim të çështjes së tyre.
- Në 1 çështje, e paraburgosura A. B. ngriti pretendimin se është shtatzënë dhe në kushtet e izolimit ka rrezik të abortojë
- Në 1 rast i burgosuri Sh. Xh. u ankua se ishte keqtrajtuar nga policia e burgut Vaqarr, po kështu një rast tjetër dhe në dy raste kanë kërkuar ndihmë të burogsurit në Greqi etj.

Sipas mënyrës së zgjidhjes së tyre ankesat e të burgosurve rezultojnë se:

- Në 17 raste Institucioni ynë ju ka siguruar atyre një avokat privat falas për të parë mundësinë për rishikimin e vendimeve të gjykatave të cilat i kanë deklaruar ata fajtorë. Në 10 raste të tjera u është dhënë ndihma juridike e kërkuar duke marrë takim me ta në burgje, kurse në tre raste kërkesat e të burgosurve janë refuzuar.

Nga çështjet e zgjidhura në favor të të burgosurve si më të rëndësishme janë:

1. Sh. Xh. që ishte duke vuajtur dënimin në burgun e Vaqarrit u ankua se ishte keqtrajtuar nga oficeri i policisë së burgut Myftar Sinani. Pasi u verifikua nga ana jonë u kërkuar fillimi i ndjekjes penale për këtë oficer në prokurorinë e rrethit të Tiranës.

2. Më dt.02.11.2000 Drejtorja e Burgut 313 Tiranë ka ngritur para institucionit tonë shqetësimin se e arrestuara A. B. e akuzuar për krimin e vjedhjes me armë është shtatzënë dhe për këtë shkak paraqet ankesa.

Për këtë nga ana jonë u muar takim me ankuesen, e cila ngriti pretendimin se si rezultat i kushteve jo të mira në burg rrezikonte që të ndërpritej shtatzënia. Për këtë u kërkua nga mjekët e spitalit të ekzaminohet e sipërpërmendura, të cilët konfirmuan se ankuesja kishte një shtatzëni 28 javëshe dhe se qëndrimi i mëtejshëm nëparaburgim vinte në rrezik jetën e fëmijës. Mbi këtë bazë më dt.12.11 2000 ju kërkua Prokurorisë të merre masa për zgjidhjen e këtij problemi duke ndryshuar masën e sigurimit.

3. Sh. D. në burgun 313 Tiranë u ankua se i kishte kaluar afati i vuajtjes së dënimit dhe mbahej padrejtësisht. U verifikua e u ndërhy në prokurorinë e rrethit, i dënuari u lirua, por me 1 ditë vonesë për faj të prokurorit I. L. Për të u bë propozimi për marrjen e masës disipolinore nga Prokurori i Përgjithshëm.

Kjo ankesë u bë shkak që Prokuroria e rrethit Tiranë të marrë masat e duhura që të bëhet në kohë evadimi i ekzekutimit të vendimeve të gjykatës, sepse edhe të dënuarit S. M. i kishte kaluar 6 ditë afati i burgimit.

4. G. D. në burgun 313 kishte hyrë në grevë urije duke pretenduar se me të nuk është marrë kontakt nga prokurori i çështjes për një kohë të gjatë.

Ju shpjegua manuali ndërkombëtar për një praktikë të mirë burgu, si dhe pasojat e rënda, ndonjëherë të pariparueshme për shëndetin. U ndërhy tek prokurori i rrethit për të dërguar vartësit e tij dhe ankuesi doli nga greva.

Nga analiza e ankesave të ardhura nga burgjet në mënyrë të përmbledhur mund të nxjerrim disa konkluzione:

1. Numri i pakët i ankesave, kërkesave e njoftimeve nga burgjet tregon qartë se qoftë nga administratat e burgut, qoftë nga të burgosurit ligji për Avokatin e Popullit nuk njihet mirë.

2. Po të analizosh një për një ankesat e ardhura nga burgjet nga përmbajtja e tyre rezulton se vetëm në 2 raste ato janë drejtuar kundër veprimeve të parregullta të

administratës së burgjeve që kanë sjellë shkeljen e të drejtave e lirive të të burgosurve. Nuk besojmë që gjendja në burgjet në Shqipëri është aq e mirë sa të mos ketë ankesë për keqtrajtime. Kjo vjen sepse **së pari**: vetë të burgosurit nuk i njohin të drejtat dhe liritë e tyre që janë përcaktuar në ligjin “Për të drejtat dhe liritë e të dënuarve me burgim”.

Së dyti: Duke qenë në kushtet e izolimit ata ngurojnë të bëjnë ankesa për veprime të parregullta të administratës apo personeli i burgjeve nga frika e pasojave që mund të vijnë prej këtyre ankimeve.

Me qëllim që të zbatohen dhe të garantohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut edhe në burgje dhe në vendet e izolimit, sepse aty edhe mundësia për t'i shkelur ato është edhe më e madhe, ne mendojmë se ka vend për të marrë disa masa organizative dhe herë përmirësime ligjore. Kështu me qëllim që të funksionojë normalisht administrata e burgjeve duhet që dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë në qytete, aktualisht në varësi të M.R.Publik, të kalojnë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë (Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve). Kjo veç të tjerash do të bëjë që për çdo të paraburgosur të sigurohet një proces i rregullt gjyqësor, do të bëjë të mundur që avokati i të akuzuarve të hyjë në kontakt me klientët e tij që në momentet e para të ndalimit apo të arrestimit. Administrata e burgjeve është e interesuar vetëm për sigurimin dhe trajtimin e të paraburgosurve, kështu që nuk do të pengojë që të sigurohet takimi me avokatin, ndërsa policia që bën arrestimin e elementit keqbërës s'është e interesuar për praninë e avokatit. Fakti që policia bën në të njëjtën kohë ndjekjen dhe kapjen e elementit keqbërës, por edhe ruajtjen e tij, hap shtigje për të abuzuar dhe për të krijuar dyshime të një procesi jo të rregullt gjyqësor.

Për mbrojtjen e të drejtave e lirive të të dënuarve një rol të veçantë do të luajë edhe plotësimi i ligjit “Për të drejtat e trajtimin e të dënuarve” me aktet nënligjore që duhet të dalin në zbatim të tij.

Si akte nënligjore për burgjet mungojnë V.K.M “Për shpërblimin e punës së të dënuarve”, rregullorja e policisë së burgjeve si dhe rregullat e çdo institucioni (burgu) në veçanti. Këto akte duhej të ishin miratuar që para dy vjetësh .

Për përmirësimin e punës sonë për burgjet mendojmë se neni 43 i ligjit “Për të drejtat dhe liritë e të dënuarve me burgim”, ka nevojë të amendohet, duke parashikuar të drejtën e Avokatit të Popullit e N/Komisionerëve për të hyrë në burgje si dhe për inspektime në burgje. Kjo sepse në rastin e fundit të takimit personal të Avokatit të Popullit me të paraburgosurin A. H., pati një tentativë nga Administrata e burgut nr.313 për ta penguar këtë, me arsyetimin se nuk është parashikuar Avokati i Popullit në nenin 43 të ligjit përkatës. Duhet patur parasysh se mungesa të këtij lloji ka edhe në ligje të tjera, por pengesat janë kapërcyer duke patur parasysh Kushtetutën dhe ligjin “Për Avokatin e Popullit”.

Megjithatë ligji “Për Avokatin e Popullit” ka nevojë të amendohet lidhur edhe me disa çështje që kanë dalë dhe do të trajtohen konkretisht më vonë.

7. Mbi ankesat dhe kërkesat e shtetasve ndaj organit të Prokurorisë

Ankesat apo kërkesat e shtetasve që lidhen me organin e Prokurorisë, për periudhën 16 qeshor deri më 31 dhjetor 2000, janë 28.

Këto ankesa i përkasin: qytetit të Tiranës 11 ose 39.1% dhe rretheve të tjera 17 ose 60.7%.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave 9 prej tyre janë zgjidhur në favor, 4 ankesa kanë qenë jashtë kompetence, 10 janë refuzuar dhe 5 ankesa janë për shqyrtim.

Për të patur një ide për natyrën e ankesave si dhe zgjidhjen e tyre, po japim disa shembuj të ankesave të zgjidhura në favor të ankuesve:

1. Nëpërmjet shtypit mësuam se 4 shtetas francezë, Luis Esposito, Roberto de Rebufapatrite, Paskale Diurzo dhe Kostandin Diurzo mbaheshin padrejtësisht në burgun e

Sarandës. Nga komunikimi që bëmë me komisariatit e policisë Sarandë dhe me prokurorinë e rrethit mësuam se ata ishin arrestuar për peshkim të paligjshëm. Nga verifikimi që i bëmë këtij problemi dhe konsultimi me dispozitat ligjore konstatuam se arrestimi i tyre ishte bërë i kundraligjshëm, për arsye se veprimi i tyre, në bazë të ligjit nr.7908 dt.05.04.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, nuk përbënte vepër penale, por kundravajtje administrative. Mbi këtë bazë i rekomanduam Prokurorisë së Rrethit Sarandë lirim të menjëhershëm dhe pushimin e procedimit penal në ngarkim të tyre. Nga ana e prokurorisë rekomandimi u vlerësua i drejtë dhe përfundimisht procedimi penal në ngarkim të tyre u pushua. Ata u liruan nga burgu pas 26 ditësh dhe u urdhërua dorëzimi i materialeve personale të bllokuara. Pas disa ditësh nëpërmjet një telegrami bërë nga avokati i tyre u njoftuam se nga ana e policisë nuk ishin dhënë akoma sendet personale të bllokuara në momentin e arrestimit. Nga ana jonë u ndërhy menjëherë te shefi i komisariatit të Policisë Sarandë dhe u bë e mundur dhënia e tyre.

- 2 Ankesa e shtetasit A. B. i paraburgosur në burgun 313 Tiranë. Pas problemeve të trajtuara në shtyp, ky person u kontaktua dhe ndërmjet të tjerave u ankua se: Në një rast është marrë në pyetje në orët e vona të natës nga prokurori ushtarak dhe pa praninë e avokatit të tij mbrojtës, ç’ka përbën shkelje të ligjit. Prokurori ushtarak pranoi shkeljen e ligjit procedural, dhe nuk pati ankesa të tilla më nga ky person më vonë.
- 3 Shtetasi S. D. ankohet ndaj prokurorisë së rrethit Elbasan për pushimin pa të drejtë të hetimit, për shkaktim dëmi nga i pandehuri Xh. Z. (akuzuar për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, parashikuar nga neni 290 /I-rë të Kodit Penal). Ai pretendoi se akt konkluzioni i ekspertëve autoteknikë ishte fallso, mbasi një prej ekspertëve nuk kishte marrë pjesë në ekspertim, e vërtetuar kjo në një deklaratë

noteriale të lëshuar prej tij. Duke gjykuar se ndodhemi para një fallsifikimi të dokumentave zyrtare, pas studimit të dosjes nga ana e jonë, u gjet se vendimi i pushimit të çështjes ishte i pabazuar, prandaj, pas kërkesës sonë Prokuroria e Përgjithshme, shfuqizoi vendimin e pushimit të çështjes, në mënyrë që të bëhen hetimet të plota.

- 4 L. I. ankohet ndaj prokurorisë së rrethit Kavajë, për faktin se prokurori, pa shkaqe ligjore apo justifikuese, nuk merr pjesë në seancën e gjyimit të djalit të saj R. I. për heqjen e masës së sigurimit, dhe për rrjedhojë ai qëndronte akoma në gjëndje arresti, ndërkohë kur sipas vendimit të Gjykatës së Lartë, ai duhet të ishte i lirë. Me ndërhyrjen dhe kërkesën tonë prokurori mori pjesë në gjykim dhe ndaj R. I. Gjykata hoqi masën e arrestit, veçse R.I. kishte bërë 20 ditë burg pa të drejtë. Po kështu ka ndodhur dhe në rastin e gjyimit të çështjes në ngarkim të pandehurit H. L. në Gjirokastrë, ku prokurori nuk merrte pjesë në mënyrë të pajustificuar në gjykim. Me ndërhyrjen tonë prokurori mori pjesë në gjykim dhe i pandehuri H. L. u gjykua. Ka konstatime se në jo pak raste prokurorët nuk paraqiten në Gjykata, kur njoftohen për kërkesa të të paraburgosurve për ndryshime të masave të sigurimit, sidomos kur nga çështja del se i paraburgosuri duhet liruuar. Gjykata këto çështje duhet t'i gjykojë brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës pranë tyre, por nga që nuk paraqiten prokurorët, shkelin këtë afat 5 ditor, shpesh herë në kurriz të njerëzve që mbahen në burg pa të drejtë. Kjo çështje është menduar të studjohet nga Institucioni ynë, me qëllim që të evitohen shkelje të tilla të rënda të të drejtave të njeriut. Në këtë fazë jemi në pritje të një udhëzimi të Prokurorit të Përgjithshëm drejtuar gjithë prokurorive të rretheve dhe Apelit, për të vlerësuar më tepër rekomandimet dhe sugjerimet e Avokatit të Popullit.

8. ÇËSH TJET ME OBJEKT ANKESAT E
SUBJEKTEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA
(Pasqyra Nr.14)

Ankesat që i përkasin fushës së mësipërme janë 45, kurse persona të interesuar për këto çështje janë 91 veta.

Nga rrethet kanë ardhur 23 ankesa, kundrejt 22 ankesave të ardhura nga Tirana.

Nga 45 ankesa, 7 kanë të bëjnë me repartet dhe 38 me Ministrinë e Mbrojtjes. Nga numri i përgjithshëm i ankesave vetëm 3 janë refuzuar pasi ankimi ishte pa baza; 16 çështje janë zgjidhur në favor të ankuesve; për 11 çështje u është shpjeguar ankuesve se çështja nuk është në kompetencë të Avokatit të Popullit, dhe 15 çështje janë në shqyrtim.

Çështje të veçanta të zgjidhura në favor të ankuesit mund të përmendim:

1. Rastin e oficerit Zh. V. e cila kish punuar rreth 18 vjet oficer aktive, kish dalë në lirim me reformë, dhe vetëm pse kish punuar 8 muaj si nënoficer humbiste të drejtën e përfitimit nga statusi i ushtarakut si oficer. Në këto rrethana në sajë të mirëkuptimit me Ministrinë e Mbrojtjes, u gjet hapësira ligjore që Zhaneta Veizi të rritullohej oficer aktive e të përfitojë statusin.

Po kështu kemi rastin e rritullimit të oficerit A.M., i cili ish nxjerrë në lirim për arsye subjektive, dhe pas verifikimit ai fitoi të drejtën e tij; ose rasti i nënoficerit A.P., të cilit nuk i jepej pagesa kalimtare për kohën që ai ish nxjerrë në lirim. Pas rekomandimit përkatës të Avokatit të Popullit u bë e mundur që ankuesit t'i rivendosej në vënd e drejta e dhënë nga ligji.

2. Mund të përmendim se 10 veteranë të L.A.N.ÇI. janë ankuar për mospërfitimin e statusit të veteranit. Në sajë të ndërhyrjes sonë në Departamentin përkatës të Ministrisë së Mbrojtjes u bë i mundur realizimi i të drejtave të tyre për përfitimin e Statusit të Veteranit të L.A.N.ÇI.

3. Janë bërë disa ankime për shkelje të të drejtave të subjekteve të ndryshme të cilat vijnë jo si rezultat i zbatimit të ligjit, por që mendojmë se është vetë ligji i cili duhet të amendohet. Kështu p.sh. mund të përmendim 19/1 të ligjit nr.8087 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve”.

Sipas kësaj dispozite nuk përfitojnë nga ky ligj **“ushtarakët e nxjerrë në lirim për braktisje detyre”** dhe ata **“që janë dënuar me burg nga Gjykata me vendim të formës së prerë për krime ushtarake”**.

Gjatë shqyrtimit të çështjeve kemi konstatuar se janë rreth 30 ushtarakë me vjetërsi pune nga 20-30 vjet punë, të cilët vitet e fundit i janë nënshtruar reformave të ndryshme në ushtri dhe rezultojnë të larguar me motivacionin “braktisje detyre”. Mjaft prej tyre kjo gjë nuk u është komunikuar dhe janë befasuar kur kanë marrë më vonë njoftimin me shkrim për motivacionin e largimit.

Për një veprim të tillë “braktisje detyre” **këta subjekte as janë kallëzuar dhe as janë ndjekur penalisht, pra fajësia e tyre nuk është gjykuar dhe nuk është provuar.** Aq më tepër që kemi parasysh se në Kodin Penal Ushtarak shprehja “braktisje detyre” nuk përdoret në asnjë dispozitë të këtij kodi.

Në qoftë se ligji nr.8087 do ta quante “dezertim” është tjetër gjë dhe për këtë duhet të kishim patjetër **një kallëzim për ndjekje penale, një procedim penal nga organi i procedimit dhe një fajsi apo pafajësi të dhënë përfundimisht nga Gjykata për subjektin përkatës.**

Ne jemi në proces shqyrtimi të rasteve me mendimin që të propozohet në organizmat përkatëse për të inicuar ndryshimet e këtij neni, duke zëvendësuar shprehjen “braktisje detyre” me shkrehjen “dezertim” duke bërë harmonizimin e ligjit me Kodin Penal Ushtarak. Nga ana tjetër për rastet e deritanishme të këtij lloji mendimi ynë është se për ato subjekte që nuk është zhvilluar proces penal pavarësisht se janë larguar me motivacionin “braktisje detyre”, ata prezumohen të pafajshëm, ndaj

duhet të përfitojnë nga ligji nr.8087, sugjerim që ja kemi bërë të ditur Ministrisë së Mbrojtjes. Gjithashtu vërejmë se ndryshime duhet të bëhen edhe në ligjin nr.7703 dt.11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në R.Sh.”, në nenin 40, pika 7, gërma “a” si edhe në nenin 3 të Dekretit nr.758 dt.01.02.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”. Kjo për arsyen se:

Neni 3 i dekretit nr.758 të sipërpërmendur parashtron përfitime për familjen e ushtarakut në qoftë se shkak të humbjes së jetës së ushtarakut janë: **“veprimet e dhunshme ndaj tij”**. Mirëpo janë 15 ushtarak xhenierë që fatkeqësisht humbën jetën gjatë ç’minimit të fushave të minuara pas trazirave të vitit 1997. Këta e humbën jetën për shkak të detyrës, në krye të saj, por **“aksidentalisht”** (siç thuhet në procedimet penale të filluara në këto raste) dhe jo **“si rrjedhojë e veprimeve të dhunshme ndaj tij”**, siç e kërkon neni 3 i dekretit nr.758 dt.01.02.1994.

Nga ana tjetër personi që përfiton në këtë rast, sipas pikës 2, gërma “a” të nenit 40 të ligjit nr.7703 dt.11.05.1993 është e veja por që, ose duhet të jetë **“mbi 50 vjeç”** ose duhet të jetë e **“pa aftë për punë”**.

Në kushtet e sotme mendojmë se do të ishte i mjaftueshëm fakti i “të qenit pa punë” të bashkëshortes së ushtarakut të rënë në krye të detyrës. Në mjaft raste siç është H.K. në Berat që ka bërë disa ankesa tek ne, edhe pse bashkëshorti i saj ra në krye të detyrës, pas rreth 30 vjet pune si oficer, ajo dhe tërë familja nuk përfitojnë asnjë të ardhur pasi H.K. është 47 vjeç dhe jo mbi 50 vjeç dhe se nuk ka raporte mjekësore si e paaftë për punë. Ajo në fakt është e pa punë, pa asnjë të ardhur, dhe ka fëmijë të mitur, por ligjet ekzistuese nuk lenë hapësira për ta ndihmuar atë dhe jetimet e saj dhe të ish oficerit të vdekur në krye të detyrës.

Shqetësim aktual i disa çështjeve që kemi në shqyrtim është fakti i çrregullimeve në mbajtjen në rregull të dokumentacionit të kuadrit oficer e nënoficer nga reformat në vazhdimësi që janë bërë në F.A.

Raste të tilla si K.K. që ka dalë oficere në vitin 1969, ka punuar rreth 29 vjet si e tillë, i është komunikuar dalja në reformë dhe është paguar në asistencë rreth dy vjet. Pas kësaj paradoksalisht ajo ka rreth dy vjet që sorollatet për të siguruar marrjen e pensionit që i takon, por nuk merr aktualisht asnjë lloj të ardhure pasi nuk ka as urdhër të daljes në rezervë as në lirim dhe figuron si oficere aktive, por çuditërisht pa vend pune e pa pagë.

9. ANKESAT NË SISTEMIN E FINANCAVE DHE PRIVATIZIMIT

Ankesat drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me shqetësimet e shtetasve dhe shoqërive private për shkeljen e të drejtave të tyre nga ana e degëve të doganave, tatim-taksave, Ministria e Financave dhe ajo e Privatizimit vetëm për periudhën Shtëtor-Dhjetor 2000, janë 23.

Nga këto 6 kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit, 6 janë refuzuar si të padrejta, 5 janë zgjidhur në favor të ankuesve, kurse 6 kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2001.

Ndër ankesat që vlen të përmendim në këtë raport janë:

1. V. J., administrator i shoqërisë “DEVI” shpk u ankua se dega e doganës Tiranë, nuk pranonte të zbatojë vendimin e Gjykatës së rrethit Tiranë të formës së prerë, ku ishte vendosur detyrimi i doganës Tiranë t’i paguajë shoqërisë “DEVI” shpk, shumën prej 53.060USD, si dëm të shkaktuar. Vendimi i Gjykatës nuk zbatohet as nga dogana dhe as nga dega e Bankës së Kursimeve Tiranë, megjithëse në llogarinë bankare të Doganës kishte gjendje para, të mjaftueshme për të shlyer këtë detyrim.

Në këto kushte, pasi u verifikua dokumentacioni dhe u ballafaqua me kërkesat e ligjit , u arrit në konkluzionin se ankuesit i ishte shkelur e drejta, që parashikohet në nenin 142 të Kushtetutës, situatë e ngjashme kjo me atë të mos

ekzekutimit të vendimeve gjyqësore që kemi folur më sipër. Kjo sepse Ministri i Financave ka lëshuar një urdhër për degët e thesarit në banka që të mos lejojnë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore pa dhënë autorizimin Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

Në këto kushte ju Rekomandua Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave që të ekzekutojë vendimin nr.4273, dt.18.08.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë me qëllim që të vihet në vend e drejta e shkelur. Ky Rekomandim u zbatua nga kjo drejtori, ç'ka përbën një shembull mirëkuptimi.

2. Z. Sh. M., administrator i Shoqërisë “Fertila” shpk, ankohet kundër degës së Tatim Taksave Tiranë në lidhje me rishikimin e TVSH-së dhe rimbursimin e saj, e cila megjithëse është e kreditueshme për shoqërinë “Fertila” nuk rimbursohet nga dega e Tatim Taksave që nga viti 1999. Nga hetimi i çështjes rezulton se: Pretendimi i shoqërisë “Fertila” shpk, mbështetet në përfundimet e akt kontrollit të degës së tatim taksave Tiranë të dt.30.03.1999, akt kontroll ku thuhej qartë se shoqëria në fjalë duhej të rimbursohet për TVSH-në. I tillë ishte edhe konkluzioni i nxjerrë në akt ekspertimin e dt.10.09.2000, të kryer nga eksperti kontabël që ne ngarkuam për këtë çështje. Duke qenë se janë shkelur kërkesat e nenit 50 të Ligjit nr.7928, dt.27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, ju Rekomandua degës së Tatim Taksave Tiranë zbatimi i ligjit për vënien në vend të së drejtës së shkelur, për të bërë rimbursimin e TVSH-së për llogari të shoqërisë “Fertila” shpk.

Jemi informuar se dega e Tatim Taksave Tiranë, ka ngarkuar një grup pune për të bërë verifikimet e duhura, por megjithëse kanë kaluar mbi 4 muaj, akoma nuk kemi marrë përgjigje. Për vonesën e konstatuar në kthimin e përgjigjes i është kërkuar në dt.05.02.2001 drejtorit të Degës së Tatim Taksave që të na kthejë sa më shpejt përgjigje në lidhje me rekomandimin tonë. Në të kundërt

ndaj tij do të kërkojmë marrje mase disiplinore për mos korrektesë në zbatimin e ligjit për Avokatin e Popullit.

3. R. L. në Tiranë është ankuar se N.K.Banesa Tiranë, nuk ka zbatuar procedurat ligjore për privatizimin e një objekti të ndodhur në truallin e tij ish-pronë private.

Në bazë të vendimeve gjyqësore të tre shkallëve dhe vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, është vendosur që ish-pronarit (ankuesit) t'i njihet e drejta e parablerjes së objektit shtetëror, dyqan në katin e parë të një pallati 5-katësh, kur ai të privatizohet.

Megjenëse veprimet e kryera nga N.K.Banesa për privatizim të atij objekti në vitin 1994 një personi tjetër janë quajtur me vendim gjykate si absolutisht të pavlefshme, Rekomandimi ynë konsiston që problemi të mos zvarritet dhe të bëhet privatizimi i objektit sipas procedurave të ligjit përkatës. Akoma nuk kemi marrë përgjigje.

Nga shqyrtimi me kujdes i ankesave në këto fusha dalin disa probleme:

- a. Ka mungesa të theksuara në njohjen e punonjësve të administratës së këtyre institucioneve, të Kushtetutës dhe Legjislacionit përkatës dhe moskujdes të tyre që të jenë transparentë në punë dhe në marrëdhënie me subjektet fizike e juridike.
4. Këtë konkluzion e mbështesin jo vetëm në ankesat e ardhura për doganat dhe tatim taksat, por edhe në njoftimet e medias. Kjo sepse megjithëse konstatohet se ankuesit kanë të drejtë, nuk veprohet në bazë dhe për zbatimin e ligjit, por jo vetëm kaq, por nuk i japin asnjë sqarim ankuesve. Me sa konstatojmë këtu ndikon mjaft edhe frika e këtyre nënpunësve, që në emër të "luftës kundër korrupsionit" marrin vendime për të qënë në rregull me drejtuesit dhe realizimin e të ashtuquajtura plane, pa u shqetësuar aspak për zbatimin e ligjit dhe të drejtave të njeriut e të taksa paguesve.

Rasti më tipik për veprime të tilla, është ai i rimbursimit të TVSH-së për shoqërinë "Fertila" shpk, sepse

ashtu siç shpjeguar më sipër, megjithëse në akt kontrollin e ushtruar nga punonjësit e degës së tatim taksave Tiranë, pranohet që kjo shoqëri duhet rimbursuar për TVSH-në e derdhur, kjo nuk ekzekutohet.

b. Tendenca për të vendosur gjoba, gjë të cilën e favorizon edhe ligji nr.8560, dt.12.12.1999 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” në të cilin, edhe pas ndryshimit me Ligjin nr.8710, dt.15.12.2000 ngelet detyrimi për tatim pagesit, për të bërë pagesë të menjëhershme në rastet e gjobave, duke lidhur të drejtën e ankimit me pagimin paraprak të gjobës së vënë. Kjo tendencë lihet me faktin se drejtuesit e këtij Institucioni raportojnë si punë të mirë dhe realizim plani edhe mbledhjen e këtyre shumave të gjobave, pa u shqetësuar më pas se ç’ndodh me to kur ankuesit e dërgojnë çështjen në gjykatë. Nga të dhënat që kemi del se pothuaj shumicës së këtyre rasteve, gjyqet i kanë fituar ankuesit, ç’ka do të thotë se ky është një problem shqetësues dhe serioz.

Fenomeni i mësipërm ndodh dhe me degët e doganave, të cilat abuzojnë me të njëjtën formë, duke u nisur nga neni 289, paragrafi i 3-të i ligjit nr.8449, dt.27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. Këto çështje kanë të bëjnë direkt me të drejtat e njeriut, e më konkretisht me të drejtën që i garantohet çdo shtetasi nga Kushtetuta e Shqipërisë dhe Konventa Europiane për të drejtat e njeriut, Kodi i Procedurës Administrative etj, për të bërë ankesë kundër akteve administrative në organin më të lartë ose në Gjykata.

Kjo e drejtë themelore, padrejtësisht i mohohet shtetasve në dy ligjet si më poshtë:

a. Në ligjin nr.8560, dt.12.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjin nr.8710, dt.15.12.2000. Më konkretisht:

5. Në nenin 43 të këtij ligji parashikohet se “tatim pagesit duhet të paguajnë të gjitha detyrimet administrative, përfshi këtu edhe interesat, ose të paraqesin garancitë

e nevojshme përpara se të paraqitin apelim”. Ndryshimet e nenit 43, në ligjin nr.8710, dt.15.12.2000, megjithë përmirësimet, përsëri detyrojnë tatim paguesit për pagesë të detyrimit tatimor, përpara se të paraqitin apelim.

- b. Në ligjin nr.8449, dt.27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” neni 289/3 përcakton se “Për të paraqitur ankesën, apeluesi duhet të paguajë shumën e përgjithshme të detyrimeve doganore që duhen paguar si rrjedhim i verifikimit të bërë, dhe të depozitojë paraprakisht në llogarinë bankare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, një shumë të barabartë me 40% të shumës së përgjithshme të gjobës së zbatuar nga autoritetet doganore, dhe që të ankohesh në gjykatë, duhet të kesh paguar 100% detyrimin doganor dhe gjobën e vënë. Pra konkluzioni është se “Ankimi i shtetasve ndaj akteve administrative në këto raste kondicionohet nga ekzekutimi i këtij akti”.

Pra e drejta për t’u ankuar ndaj akteve administrative të tatimeve dhe doganave kondicionohet me mundësinë reale që ka shtetasi për të paguar një shumë relativisht të madhe. E thënë më qartë, duhet pranuar se nëqoftë se shtetasi nuk e ka mundësinë reale për të paguar detyrimin, ai e humbet të drejtën e ankimit që në momentin e daljes së aktit. Veç kësaj, kryerja e menjëhershme e pagesës së detyruar nga një akt i tillë administrativ e çon shtetasin drejt falimentimit të veprimtarisë së tij, pavarësisht se ai mund të ketë të drejtë, të cilën mund t’ja japë gjykata pas 2-3 vjetësh, kur të përfundojnë gjyqet në 3-4 shkallët.

Analiza që i është bërë këtyre dy dispozitave që lidhen me ankime të shtetasve pranë Institucionit tonë, nxjerr në pah nevojën për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për ndryshimin e tyre, ç’ka është e domosdoshme pasi ne mendojmë se aktualisht me zbatimin e tyre shkelen hapur të drejtat e shtetasve tanë. Meqenëse koha e veprimtarisë sonë është mjaft e shkurtër

ato po studiohen me kujdes, për të bërë rekomandimet e duhura.

c. Një çështje e rëndësishme që ka dalë është fakti që V.K.M. nr.205, dt.13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nuk është botuar në Fletoren Zyrtare e për pasojë nuk mund të merret si bazë pune për zhvillimin e aktivitetit doganor, pasi ligjërisht mungon fuqia juridike për dy arsye:

1. Në nenin 117/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet në mënyrë taksative se “Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare.
2. Për vlerën e akteve që nuk botohen në Fletoren Zyrtare është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.47, dt.07.07.1999, e cila duke ju referuar nenit 117/1 të Kushtetutës përsërit qëndrimin se aktet ligjore e nënligjore hyjnë në fuqi vetëm pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe njëkohësisht thekson se një akt që nuk botohet, nuk prodhon efekte juridike, pra mund të quhet një akt inekzistent.

Pra në rast se subjekte të caktuara do të ngrejnë këtë pretendim para gjykatave, kur kundërshtojnë aktet administrative të doganave, mendojmë se me siguri “e humbur” do të jetë pala që përfaqëson administratën tonë publike. Ky problem i është ngritur Ministrit të Financave me qëllim që të marë masa të riparohet kjo e metë.

10. ANKESA NË LIDHJE ME MARRËDHËNIET E PUNËS

Numri i përgjithshëm i ankesave në lidhje me marrëdhëniet e punës është 43 dhe në këtë grup janë përfshirë ato ankesa që kanë qenë për pushime të padrejta nga puna, mospagesë të punës së kryer, mos respektim i ligjeve për të dhënë motivacionin dhe aktin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës apo për masa

disiplinore të padrejta. Kështu nga ankesat e mësipërme 28 kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencave tona, 2 janë refuzuar si të padrejta, 2 janë zgjidhur në favor, kurse 11 janë mbartur për vitin 2001. Ndër rastet që vlejné për t'u përmendur janë:

a. 30 punonjës të Inspektoriatit të Sigurimit Teknik për Pajisjet dhe Instalimet Elektrike u ankuan se drejtoria e KESH-it nuk pranonte të jepte pagën për punën që kryejné sepse kështu kishte vendosur Këshilli Mbikqyrës i KESH-it. Ndalimi i pagës kishte mbi 6 muaj dhe këta punonjës nuk po e zgjidhnin dot problemin.

Nga hetimi i problemit rezultoi se: Me urdhërin nr.330, dt.06.07.2000 të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ishte shfuqizuar vendimi i Këshillit mbikqyrës të KESH-it për heqjen e 30 punonjësve dhe për ndërprerjen e pagesës. Por edhe pas këtij urdhëri të Ministrit, Drejtori i KESH-it nuk pranonte të bënte pagesën, gjë të cilën ja njoftonte Ministrit me shkresën nr.443 dt.28.09.2000.

Meqenëse problemi ishte shqetësues se dilte qartë se dy autoritete të lartë të administratës publike nuk po merreshin vesh, dhe krijonte konflikte sociale si edhe nisur nga fakti që V.K.M. nr.148, dt.9.12.1967, ndryshuar me V.K.M. nr.108, dt.25.03.1980 "Për Inspektoriatin Shtetëror të Sigurimit Teknik, për instalimet dhe pajisjet elektrike" është në fuqi dhe shprehet se "Ky inspektoriat është atashuar pranë Ministrisë së Energjitikës dhe ndërmarrjeve të sistemit energjitik". Ju bë rekomandim Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit që bazuar në ligjin nr.7926, dt.20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri Tregëtare" të urdhëronte kryerjen e pagesës për ankuesit.

Rekomandimi ynë u pranua nga Ministri dhe u vu në vend e drejta e shkelur, duke ju dhënë paga 30 punonjësve të inspektoriatit të sigurimit teknik.

b. Rreth 80 drejtues automjetesh që punonin me mjetet e tyre për ndërtimin e autostradës Plepa Rrogozhinë u

ankuan se nuk i ishte dhënë paga e 4-muajve nga firma Greke "Sarandopoulos". Veç faktit që këta shoferë e mjaft punëtorë të tjerë punonin pa kontrata të rregullta pune (problem ky në rang kombëtar) më e keqja ishte se përfaqësuesit e firmës i gënjenin shoferët duke u thënë se nuk u jepnin pagesat, sepse sipas tyre "Qeveria Shqiptare nuk ju kishte bërë pagesat". Ndërhyrja jonë e menjëhershme dhe energjike, dhe pas një takimi direkt me drejtuesit e kësaj firme, të bashkëpunimit me Ministrin e Transporteve zotin Sokol Nako që ndërhyri menjëherë për sqarimin e së vërtetës, doli se nga shteti shqiptar firma i kishte marrë paratë në kohë. Kështu që drejtuesit e firmës kryenin krimin e mashtrimit në dëm të shtetasve shqiptarë. Prandaj për këtë çështje ju drejtuam edhe organit të Prokurorisë. Si rrjedhojë u bë e mundur që në mënyrë graduale drejtuesit e automjeteve të merrnin paratë e tyre dhe firmës së huaj ju dha një mësim i mirë që të mos gënjejnë e të tallen me autoritetet dhe punëtorët shqiptarë.

Me sa jemi të informuar nga Mediat, fenomene të tilla ka patur dhe ka mjaft në Shqipëri, por është detyrë në radhë të parë e Inspektoriateve të Punës në varësi të Ministrisë së Punës dhe Sindikatave të punëtorëve që t'i ndjekin e të ngrihen ndaj çdo rasti të diskriminimit të punëtorëve shqiptarë nga të huajt brenda Atdheut të tyre.

Nga shqyrtimi në tërësi i këtyre ankesave vërejmë se: Megjithëse mund të ketë arbitraritet dhe subjektivizëm në zgjidhjet e kontratave të punës me të punësuarit, të drejtat e këtyre të fundit dhe garancitë e një pune të sigurtë dhe afatgjatë janë të cinguara. Kështu është vënë re, gjatë verifikimit të çështjeve që edhe nëse pushimi nga puna është bërë pa shkaqe të arsyeshme, përsëri ankuesit nuk kthehen në punë pasi vetë dispozitat e Kodit të Punës nuk e parashikojnë një gjë të tillë. Jo vetëm kaq, por edhe nëse ka shkaqe të arsyeshme ose jo për zgjidhjen e kontratës së punës, është vetë punëdhënësi që e

vlerëson. Në këto kushte të punësuarit janë krejtësisht të pambrojtur nga ligji dhe të drejtat e tyre mund të shkelen në çdo moment nga veprimet dhe vlerësimet e vetë punëdhënësve që janë autoritete të Administratës publike.

Gjithashtu vërejmë se dhe kur vetë Gjykata vendos rikthimin në punë, pasi e deklaron të pavlefshme procedurën për zgjidhjen e kontratës së punës, ndërmarrjet dhe institucionet publike nuk e ekzekutojnë një vendim të tillë me argumentin se vetë Kodi i Punës nuk e përcakton një detyrim të tillë, por gjykata maksimalisht mund të shprehet vetëm për përfitimin e pagës deri në një vit.

Duke u ndodhur përballë këtyre fakteve mendojmë se mund të ketë vend për plotësime në kuadrin ligjor që trajton çështjet e punësimit dhe kryesisht të dispozitave që përcaktojnë procedurën e largimit nga puna. Mund të shihet alternativa që nëse Gjykata vlerëson se zgjidhja e kontratës së punës është e padrejtë, detyrimi financiar që cakton gjykata si dëmshpërblim me pagën deri në një vit, të rëndojë mbi vetë drejtuesin e organit apo institucionit publik që zgjidh kontratën pa shkaqe të arsyeshme ose si alternativë e dytë, të rivendoset në Kodin e Punës mundësia e rikthimit në punë, ashtu siç ka qenë e parashikuar në Kodin e mëparshëm të Punës.

Ndër të metat që vlejné të theksohet është edhe mos funksionimi i Komisionit të Shërbimit Civil pothuajse për gjithë vitin 2000 për shkak se në përbërjen e tij akoma mungojné dy përfaqësuesit e pushtetit vendor.

11. ANKESAT PËR NDËRTIMET PA LEJE APO MOSVEPRIME TË POLICISË SË NDËRTIMIT

Numri i ankesave të qytetarëve mbi ndërtime pa leje, ose ndërtime jashtë kondicioneve urbanistike është 31, për periudhën deri më 31.12.2000. Fillimi nga puna i Institucionit tonë e gjeti Tiranën, por edhe qytete të tjera në

një gjendje kaotike përsa i përket ndërtimeve pa leje, por më tepër të ndërtimeve jashtë kondicioneve urbanistike, gjë që ka sjellë edhe përplasje të shpeshta ndërmjet qytetarëve.

Shkaqet e kësaj gjendje për mendimin tonë janë dy:

- a. Papërgjegjshmëria e ndërtuesve, që për arsye përfitimi dhe mungesës së një kontrolli të rreptë shtetëror, ndërtuan me vend dhe pa vend.
- b. Papërgjegjshmëria dhe korruptimi i pushtetit lokal, sidomos në 3-4 muajt e fundit përpara zgjedhjeve lokale, duke lëshuar pa kriter me qindra leje ndërtimi jashtë kondicioneve urbanistike.

Institucioni ynë në 13 raste ka refuzuar ndjekjen e ankesave, për shkak se kanë qënë jashtë juridiksionit tonë. Në 6 raste Institucioni ynë i ka ndjekur çështjet dhe pas verifikimeve në vend ka konstatuar se ankesat nuk ishin të drejta, pasi ndërtimet ishin me leje dhe brenda kondicioneve urbanistike. Në 4 raste rekomandimet tona janë zbatuar menjëherë nga Policia Ndërtimore dhe çështjet janë zgjidhur në favor të ankuesve (pa përfshirë këtu dhe 2 raste për tërheqje dokumentash pranë Zyrës së Urbanistikës, dhënia e të cilave refuzohej prej saj).

Rastet e mbetura janë ende në shqyrtim nga ana jonë.

Për Policinë Ndërtimore dega Tiranë, vlen të përmenden dy raste shumë pozitive. Rasti i parë është i shtetasit V.D. nga Tirana në pronën e të cilit ishte ngritur një objekt i paligjshëm. Pas një takimi të drejtpërdrejtë në degën e policisë së Ndërtimit të Tiranës, objekti u prish brenda 4 ditëve.

Po kështu banorët e një pallati pranë Kinema "Partizani" u ankuan për një ndërtim të jashtëligjshëm dhe jashtë kondicioneve urbanistike. Ndërhyrja jonë bëri të mundur që brenda 2 ditëve, objekti të shembej.

Me policinë Ndërtimore dhe me Bashkinë e Tiranës jemi në kontakt të vazhdueshëm për çështjet e papërfunduara të vitit që kaloi si dhe për mjaft ankesa të mbërritura në vitin 2001.

Gjithashtu kështu vlen të përmendet rasti i degës së Policisë Ndërtimore në Elbasan, e cila sipas ankesës së banorëve të një pallati për ndërtim jashtë kondicioneve urbanistike, bëri gjobitjen e ndërtuesve dhe vazhdimin e ndërtimit të objektit sipas kushteve Urbanistike.

Ose rast tjetër është ai i shtetasit G.P. nga Shkodra që nuk i jepej leja e ndërtimit nga K.Rr.T-ja Shkodër megjithëse kërkesa e tij ishte dorëzuar prej disa muajsh. Pas Rekomandimit tonë ky shtetas u fut në listën e atyre që do të diskutoheshin në mbledhjen e parë të K.Rr.T-së Shkodër.

12. ANKESAT PËR PUSHTETIN LOKAL

Këto ankesa janë grupuar në tre nëngrupe:

- a. Kundër komisioneve të ndarjes së tokave bujqësore në fshatra që janë 33 ankesa
- b. Kundër komisioneve të kthimit dhe kompensimit të Pronave që janë 31 ankesa
- c. Të tjera si për mosregjistrimin në listat e humbjeve të shtëpive nga skemat piramidale, mosregjistrimi në regjistrat e gjendjes civile, etj që janë 60 ankesa.

a- Në lidhje me nëngrupin e parë bie në sy fakti se pas afro 9 vjetësh, pas daljes së ligjit nr.7501 dt.19.07.1991 "Për tokën" ka akoma mjaft konflikte, pothuajse në të gjitha rrethet e vendit, shkaktuar nga moszbatimi i plotë ose i pasaktë i këtij ligji nga komisionet e tokës në fshatra dhe ato në rrethe. Kështu ka fshatarë që kanë marrë tapi për tokë në përdorim dhe me mbivendosje me fqinjët e tyre, dhënie vendimesh të ndryshme për të njëjtën tokë duke i përplasur me ish pronarët etj, duke krijuar kështu dhe situata të rënda sociale.

Kështu mund të përmendim ankesën e banorëve të fshatit Otlak në Berat që arriten deri në grevë të zgjatur urie, ose në rrethin e Kurbinit e të Lezhës. Ne në mjaft raste kemi bëri verifikimin e ankesave direkt në fshatra dhe jemi munduar të zbutim konfliktet, por ato nuk zgjidhen kur

komisionet nuk veprojnë e nuk funksionojnë sipas ligjit as në fshatra, komuna apo rrethe. Aq më keq që përgjegjësinë dhe iniciativën për përgatitjen e tyre nuk e merr përsipër askush, përfshirë edhe Komisionin Qeveritar të tokës pranë Ministrisë së Bujqësisë.

Edhe atje ku këto komisione ekzistojnë, nuk ndërmerret asnjë veprim ose ndërhyrje lidhur me dhënien e tokës, plotësimin me të si dhe për lirin e saj në rastet kur ajo është e zënë nga organet e pushtetit vendor. Në këtë mënyrë ato bëhen pengesë serioze për fillimin e procesit të kompensimit.

b. Edhe në lidhje me nëngrupin e dytë, pas afro 7 vjetësh që ka dalë ligji nr.7698 dt.15.04.1993 “Për kthimin e kompensimin e pronave ish pronarëve” në disa rrethe si Vlora, Tirana, Durrësi, Saranda, Delvina, Kavaja etj. ka akoma raste që ish pronarëve nuk u janë dhënë përgjigje nëpërmjet vendimeve për kërkesat e tyre. Duke mos u dhënë përgjigje, sipas rastit, pozitive apo negative, u është mohuar këtyre shtetasve e drejta për të bërë një proces gjyqësor në gjykatën e rrethit, për të kundërshtuar sipas ligjit vendimin e K.K.Pronave dhe për të kërkuar, sipas rastit, anulimin, plotësimin apo ndryshimin e atij vendimi. Shpesh herë këto komisione i mbajnë kërkesat të depozituara pa veprim prej vitesh, me të vetmin qëllim që të zvarritin zgjidhjet e çështjeve, në dëm të kërkuësve dhe në favor të të tretëve që ju kanë dhënë më parë vendime të padrejta. Natyrisht edhe në këto raste korrupsioni nuk përjashtohet. Aq më keq që edhe Komiteti shtetëror i K.K.Pronave pranë Këshillit të Ministrave nuk kemi konstatuar të ketë ushtruar ndonjë kontroll e të ketë të paktën një evidencë për probleme të tilla të pazgjidhura.

Problem tjetër shumë i rëndësishëm është edhe mos zbatimi i ligjit për të bërë kompensimin e ish pronarëve, qoftë me para, qoftë me zëvendësimin fizik të trojeve të tyre të zëna, me troje akoma të lira, pronë shtetërore.

Për këtë problem ne kemi disa ankesa dhe i jemi drejtuar për shpjegime Komitetit Shtetëror të K.K. të Pronave pranë Këshillit të Ministrave.

c. Kurse përsa i përket nëngrupit të tretë më të shumta kanë qenë ankesat në lidhje strehimin, kur ka mjaft probleme të trashëguara si dhe me mosregjistrimin e personave që kanë humbur paratë në skemat piramidale në listat e përfitimit të kredive për banesat. Si shkas u bë ankesa e një banoreje nga Tirana, e cila pretendoi se gjatë afatit të shkurtër rreth 40 ditë që kishte caktuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.585, dt.11.12.1997 për të plotësuar dokumentacionin ajo kishte qenë në Greqi e nuk kishte mundur të merrte dijani, kështu që kërkonte ndërhyrjen tonë. Ne konstatuam se si ky rast vetëm në Tiranë kishte mbi 300 familje, por ndërhyrja jonë në favor të ankueses u bazua në faktin se V.K.M. nr.585 dt.11.12.1997 akoma edhe sot është i pabotuar në Fletoren Zyrtare. Megjithë këtë Qeveria, nëpërmjet Grupit Mbikqyrës të skemave piramidale e mori parasysh rekomandimin tonë dhe akoma edhe sot shtetasve që nuk i kanë plotësuar dokumentet në kohë ju pranohen ato, dhe futen në listat rezervë të hartuara për kredi.

Një çështje tjetër e rëndësishme që lidhet me Ministrinë e Pushtetit Lokal është ankesa e 168 familjeve nga fshati Bicaj i rrethit të Kukësit, të cilët qysh nga viti 1999 nuk kanë marrë shpërblimet për shpenzimet që kanë bërë për mbajtjen për disa muaj të familjeve kosovare gjatë luftës së Kosovës.

Ankuesit pasi kanë përfunduar ciklin e ankesave në të gjitha organet e tjera, përfshirë edhe Kryeministrinë, na janë drejtuar edhe ne që në muajin maj 2000. E kemi verifikuar problemin, ankesa e tyre është plotësisht e drejtë, kemi ndërhyrë disa herë në Ministrinë e Pushtetit Lokal, ku kanë pranuar si të drejtë ankesën, por kanë pretenduar se janë mbaruar fondet për këtë qëllim dhe do kërkojnë fonde të reja në vitin 2001. Pasi hyri viti 2001, përsëri thonë se nuk ka fonde për këtë qëllim.

Ne mendojmë se ky është një qëndrim i papërgjegjshëm i administratës së kësaj Ministrie, sepse kemi mësuar se ka edhe mjaft ankesa të tjera të këtij lloji.

Një çështje tjetër që vlen të përmendim në lidhje me pushtetin lokal janë qëndrimet e padrejta e të paligjshme të Kryetares së Bashkisë së Rroskovecit, zonjës Lindita Çoba.

Para zgjedhjeve lokale të 1 tetorit 2000, ajo pengonte shtetasin Y.K. që të rregjistrohej si banues në atë qytet, sepse Y.K. do vinte kandidaturën si i pavarur. Ne ndërhymë në favor të Y.K. duke i rekomanduar nëpunësit të gjendjes civile pranë asaj bashkie, A.Ç. që të bëjë rregjistrimin, gjë që ishte në kompetencë të tij, rekomandim të cilin ky nëpunës e pranoi. Shtetasi Y.K. kandidoi dhe doli në balotazh me Kryetaren Lindita Çoba, e cila përsëri fitoi. Por meqë nëpunësi i gjendjes civile A.Ç. zbatoi ligjin në kundërshtim me porositë e saj për të mos bërë rregjistrimin e kundërshtarit të saj, sapo u rilegjitimua pas balotazhit të 15 tetorit 2000 zonja Lindita Çoba filloi hakmarrjen. Me dt.7.11.2000 i njoftoi largimin nga puna A.Ç. gjoja në emër të një reforme që po bën me stafin e Bashkisë, duke shkelur çdo rregull të Kodit të Punës apo Statusit të Nëpunësit Civil. Ajo nuk i dhënë as urdhërin me shkrim të largimit nga puna, me qëllim që të mos ketë të drejtë të ankohet në Gjykatë. Gjithashtu nuk i ka dhënë pagesën për lejen e zakonshme dhe i ka mohuar përfitimin për punën si agjent tatimor për shitjen e pullave në zyrën e Gjendjes Civile etj.

Ne kemi marrë takim me këtë kryetare bashkie, ja kemi bërë të njohura me gojë dhe me shkrim shkeljet, kemi njoftuar Prefektin e Fierit dhe Ministrin e Pushtetit Lokal që të ndikojnë tek ajo për të zbatuar ligjin, por zonja Çoba vazhdon të mbajë qëndrim mospërfillës ndaj Institucionit dhe nuk zbaton rekomandimet tona.

Nëqoftëse ajo do të vazhdojë të shkelë ligjet, duke mbajtur të njëjtin qëndrim, ne do t'i propozojmë Kryeministrit shkarkimin e saj.

13. ANKESA NË FUSHËN E SIGURIMEVE SHOQËRORE

Numri i përgjithshëm i ankesave të shqyrtuara është 49, nga të cilat janë nga Tirana 19, kurse nga rrethet 30.

Problematika e ankesave ka qënë për çështje që lidhen me llogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë - 19 çështje; trajtim si invalid në grupin përkatës dhe pagesën specifike - 8 çështje; mosdhënie e të drejtës së përfitimit të pensionit, pas paraqitjes së dokumenteve - 4 çështje; mospërfitim kompensimesh nga sistemi i Sigurimeve Shoqërore - 3 çështje; përfitim pensioni familjar - 2 çështje, kurse problematika të tjera - 13 çështje, si shtyrje afati për dalje për dalje në pension; mos pagesa pas ditës së 14-të të raportit mjekësor; ripunësim sipas grupit të invaliditetit; trajtim me pension (në vleftë) për periudha të prapambetura etj.

Rezulton se nga çështjet e shqyrtuara, të gjitha kanë qënë të padrejta dhe nuk është arritur në rekomandim për asnjë prej tyre. Duke mos gjetur asnjë ankesë të drejtë del se nga degët e sigurimeve shoqërore në rrethe dhe në veçanti nga Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore në Tiranë, bëhet punë e mirë dhe e saktë në fushën e tyre. Kjo gjendje vlen të vihet në dukje kur dihet se mjaft pjesë të administratës sonë publike nuk shquhen për punë të lavdërueshme.

Ankesat më të shumta kanë ardhur dhe i referohen caktimit të masës së pensionit. Kjo për faktin e ndryshimit të legjislacionit dhe kuptimit të sistemit kontributiv të Sigurimeve Shoqërore.

Kalimi nga sistemi i parashikuar në Ligjin nr.4171, dt.13.09.1966 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, në sistemin e ri kontributiv sipas ligjit nr.7703, dt.11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ngre këto probleme:

1. Parimi kontributiv për sistemin aktual të Sigurimeve Shoqërore. Sipas parimit aktual, përcaktohet se sa më i

madh kontributi, aq më i madh do të jetë përfitimi. Ky parim definohet i detajuar në nenin 59 të ligjit 7703, dt.11.05.1993 ku thuhet se “Për pensionet pas vitit 1996 baza e vlerësueshme llogaritet mbi pagat për të cilat është dershur kontribut nga viti 1994 e më pas”. Sistemi i ri, është më kompleks, pasi njeh termat punëmarrës dhe punëdhënës në derdhjen e kontributit, ndërkohë që sistemi i mëparshëm dilte nga një skemë e përqendruar kontribucioni (shteti).

2. Politikat shtetërore për fushën e Sigurimeve Shoqërore. Politikat shtetërore lidhur me Sigurimet Shoqërore shihen të lidhura ngushtë me elementë të tillë si: Minimumi jetik; një shportë e caktuar çmimesh referuese; zhvillimi ekonomik i përgjithshëm.

Sipas parimit të kontribucionit, Këshilli i Ministrave, bazuar në nivelin e pensionit minimal, bën indeksimin ose siç quhet realisht, rritje të masës të pensioneve. Lind pyetja: A është e bazuar kjo rritje kur akoma nuk kemi të përcaktuar zyrtarisht nivelin e minimumit jetik?

3. Zbatimi i sistemit të ri kontributiv sipas ligjit nr.7703, dt.11.05.1993. Për pensionet pas vitit 1996, masa llogaritet sipas kontribucionit pas vitit 1994 e më pas. Për pensionet e mëparshme shihet niveli minimal. Objektivi në punën e Avokatit të Popullit në kuadrin e zbatimit të drejtave sociale të individit është se duhet të studjohen praktikat për të bërë rekomandime për ndryshim legjislacioni në përcaktimin e kriterëve bazë për llogaritjen e masës së pensioneve. Mendimi ynë dhe kërkesa e pensionistëve është që:

Baza e kriterëve duhet të jetë minimumi jetik i pranuar zyrtarisht.

14. ANKESAT NË FUSHËN E ARSIMIT DHE KULTURËS

Nga çështjet që i përkasin fushës arsim-kulturë rezultojnë gjithsej 10 ankesa, nga të cilat për dy prej tyre

janë bërë rekomandime organeve përkatëse në favor të ankuesve.

a. Nga këto rekomandimi i parë lidhet me çështjen e një grupi mjekësh specializantë në Fakultetin e Mjekësisë, të cilëve u ishte ndërprerë specializimi me argumentin se nuk kanë paguar taksën e regjistrimit pranë fakultetit përkatës. Çështja është vënë në lëvizje me ankesën e njerit nga specializantët.

Këta ankues pretendojnë se këtë taksë e kanë paguar që në fillim të rregjistrimit të specializimit dhe se ajo duhet të paguhet vetëm një herë dhe jo çdo vit, për aq vite sa vazhdon specializimi.

Pas hetimit të çështjes është arritur në konkluzionin se kjo ankesë është e drejtë dhe për këtë i është bërë një rekomandim Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, Rektoratit të Universitetit të Tiranës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Ky konkluzion del jo vetëm nga fakti se V.K.M. nr.424 dt.09.07.1998 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore” nuk është botuar në Fletoren Zyrtare, por nga ana tjetër se në shkencën nr.796/1, dt.28.02.2000 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës bëhet fjalë për tarifë regjistrimi dhe jo tarifë vjetore regjistrimi siç shprehej kancelari i Fakultetit të Mjekësisë në shkresat drejtuar departamenteve të Fakultetit. Nga shtesa e fjalës “vjetore” që i ka bërë shkencës së mësipërme të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, ka vendosur detyrimin e shumë specializantëve që të paguajnë një detyrim të paligjshëm dhe njëkohësisht ushtron presion të padrejtë mbi specializantë të tjerë nën frikën e ndërprerjes së specializimit.

Rekomandimi në fjalë kërkon për organet e mësipërme të marrin masat e nevojshme për vënien në vend të së drejtës së shkelur ndaj specializantëve pasuniversitarë, duke shfuqizuar të gjitha vendimet që janë marrë për ndërprerjen e specializimit ndaj studentëve që nuk kanë paguar tarifën vjetore të regjistrimit si dhe të kthehen shumat e marra padrejtësisht të tjerëve.

Deri në këto momente nuk ka ardhur asnjë përgjigje nga ana e organeve përkatëse në lidhje me këtë rekomandim, për më tepër që Dekani i Fakultetit të Mjekësisë ka mbajtur qëndrim arrogant dhe mospërfillës me Komisionerin e Avokatit të Popullit, kur ky i fundit ka shkuar ta takojë për t'ja bërë më të qartë pozicionin e Institucionit dhe rekomandimin e paraqitur.

Për arsye të mungesës së kohës së mjaftueshme ky problem nuk është ndjekur shkallë shkallë deri në zgjidhjen përfundimtare të tij.

b. Rekomandimi i dytë ka patur të bëjë me ankesën e shtetasit G.P. në lidhje me vendimin e Komisionit të Kualifikimit Shkencor pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të dt.21.09.2000.

Konkretisht në ankesën e tij i sipërpërmenduri sqaronte se në vitin 1984 ka mbaruar Fakultetin Ekonomik, dhe që nga viti 1989 ka punuar pranë Galerisë së Arteve. Përvoja e gjatë në punë dhe konkretisht angazhimi i tij në fushën e arteve vizuale për organizimin e një numri të madh ekspozitash brenda dhe jashtë vendit, si dhe kualifikimet e ndryshme që ka bërë në fushën e menaxhimit të ekspozitave bëri të mundur që të depozitohet pranë Akademisë së Arteve temën “Menaxhimi i ekspozitave në fushën e arteve vizuale”, për të fituar shkallën e parë të kualifikimit pasuniversitar.

Kërkesën ankuesi e ka depozituar në vitin 1995 pranë Akademisë së Arteve, Qendrës së Studimit të Artit, temë e cila është e aprovuar nga kjo qendër. Ai çmonte se kjo temë duhej të mbrohej pranë Akademisë së Arteve. Për arsye të pezullimit për një kohë të gjatë të procedurave për kualifikimin pasuniversitar, e ka përsëritur kërkesën e tij për të vazhduar studimet e thelluara pasuniversitare, por nga ana e Komisionit të Kualifikimit Shkencor, kjo kërkesë është refuzuar me argumentin se kualifikimi shkencor pasuniversitar realizohet sipas kritereve të përcaktuara në V.K.M. nr.786 dt.17.12.1998, udhëzimeve nr.17 dhe nr.18 dt.10.08.1999 të Komisionit të Kualifikimit Shkencor. Sipas

këtyre akteve, çdo personi i lind e drejta të kërkojë kualifikimin pranë institucionit ku ka kryer studimet universitare. Në këto kushte përgjigja ishte se ankuesi duhej t'i drejtohej Fakultetit Ekonomik, konform kriterëve të përcaktuara në vendimet e mësipërme.

Nga hetimi ynë doli se në bazë të akteve nënligjore të sipërpërmendura që rregullojnë kualifikimin pasuniversitar nuk ka asnjë pengesë ligjore në lidhje me faktin se kandidati për të bërë studimet e thelluara pasuniversitare duhet patjetër të drejtojë kërkesën pranë fakultetit ku ai ka kryer studimet universitare.

Konkretisht në bazë të Udhëzimit nr.18, dt.10.08.1999 pika 2.3, janë shkollat e larta universitare të cilat bëjnë propozimet për hapjen e shkollave pasuniversitare dhe ndër të tjera, në dokumentacionin që duhet të hartojnë, bën pjesë dhe rregullorja e pranimi dhe e funksionimit të Sh.P.U.-së. Megjithë këtë në këtë rregullore nuk mund të kufizohet vëllimi i të drejtave të personave në raport me atë vëllim që këtyre të fundit ju njihet nga ligji dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre. Në të njëjtën kohë ne ju referohemi parimit se asgjë që nuk ndalohet, lejohet dhe prandaj u çmua se pengesat për ankuesin janë të pabazuara.

Në këto kushte ju argumentua si më sipër kryetarit të Komisionit të Kualifikimit Shkencor, Ministrit të Arsimit, i cili bëri të mundur të rishikohej dhe një herë kërkesa dhe përfundimisht ankuesit ju pranua ajo.

Nga shqyrtimi i çështjes në fjalë rezultoi se ka vend për ndryshime të akteve nënligjore për faktin se ky problem mund të lindë dhe për subjekte të tjerë, të cilët kërkojnë të mbrojnë doktoraturën jo në fakultetet në të cilat ata kanë mbaruar studimet universitare, por pranë fakulteteve të tjera bazuar në studimet pasuniversitare që kanë bërë pas diplomimit.

Ne mendojmë se duhet që shprehimisht në aktet që rregullojnë kualifikimin pasuniversitar të parashikohet mundësia për subjekte të ndryshme që, bazuar në përvojën e tyre të punës dhe studimeve të thelluara në një fushë, t'ju jepet

mundësia që të mbrojnë doktoraturën edhe pranë fakulteteve në të cilat ata nuk kanë mbaruar studimet universitare.

Ky rekomandim është pranuar në lidhje me subjektin në fjalë, por përsa i përket rregullimit të akteve nënligjore që lidhen me çështjen akoma nuk kemi përgjigje.

15. ANKESA NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

Nga 8 ankesat që kanë qenë në këtë fushë vetëm 4 prej tyre kanë përfunduar në rekomandime. Një prej rekomandimeve më të rëndësishme ka të bëjë me shfuqizimin e pikës 4 të Udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë, nr.362 dt.18.08.2000 “Mbi zbatimin e detyrave për dhënien e lejeve higjeno-sanitare”.

Shkak për këtë rekomandim u bënë 8 persona juridike të qytetit të Korçës, të cilët u ankuan tek ne lidhur me kërkesën e Inspektoriatit Sanitar Shtetëror të këtij qyteti për rinovimin e lejes higjeno sanitare çdo vit. Kjo kërkesë e këtij inspektoriatit justifikohet me nenin 12 të ligjit nr.7463 dt.02.12.1992 “Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror”, dhe me pikën 4 të udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë nr.362 dt.18.08.2000 “Mbi zbatimin e detyrave për dhënien e lejeve higjeno-sanitare”.

Përmbajtja e rekomandimit ka të bëjë me shfuqizimin e pikës 4 të këtij udhëzimi, duke argumentuar se ky udhëzim është nxjerrë në zbatim të nenit 12 të ligjit nr.7643 dt.02.12.1992 “Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror”. Nga studimi i ligjit në tërësi dhe nenit 12 në veçanti del se përmbajtja e pikës 4 të udhëzimit është tejkalim i përmbajtjes së nenit 13 dhe të nenit 26 të ligjit. Në nenin 12 të ligjit përcaktohen shprehimisht rastet se kur Inspektoriatin Sanitar Shtetëror jep pëlqimin për dhënien e lejes higjeno-sanitare dhe nuk përcakton ndonjë afat për vlefshmërinë e saj dhe për më tepër nuk autorizohet Ministri i Shëndetësisë të caktojë ndonjë afat për rinovimin e saj. Udhëzimi përcakton afatin e vlefshmërisë së lejes higjeno-sanitare, e cila duhet të përsëritet çdo vit, në një kohë që një detyrim të tillë nuk e përmban vetë ligji. Pra

del qartë tejkalimi që akti nënligjor i bën vete ligjes materiale duke e bërë pikën 4 të udhëzimit të paligjshëm.

Gjithashtu dhe vendosja e sanksioneve nga Ministri lidhur me mosrinovimin e lejes, duke ju referuar neneve 26-31 të ligjit “Për Inspektoriatin Sanitar”, është i paligjshëm sepse neni 26 i ligjit përcakton në mënyrë taksative 17 rastet të cilat përbëjnë kundravajtje administrative. Edhe sipas nenit 3 të ligjit nr.7697 dt.07.04.1993 “Për Kundravajtjet Administrative”, shkeljet që përbëjnë kundravajtje administrative parashikohen vetëm me ligj ose me akte të Këshillave të Bashkive apo Komunave për territorin e tyre. Pra edhe sipas këtij ligji Ministri nuk ka të drejtë të caktojë kundravajtje dhe aq më tepër të vendosë dënime për to.

Po kështu, po t'i referohemi nenit 118 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku shprehimisht theksohet se “Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë” si dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 119 të Kushtetutës ku përcaktohet se “Rregulloret e Këshillit të Ministrave, të Ministrive... kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre”, del se Udhëzimi i Ministrit të Shëndetësisë nuk mund të shërbejë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera. Edhe në këtë rast del qartë se pika 4 e udhëzimit nr.362 dt.18.08.2000 ashtu siç është formular ishte në tejkalim të kushtetutës dhe të ligjit, pra ishte e paligjshme.

Duke u nisur nga faktet e sipërpërshënuara i kërkuam Ministrit të Shëndetësisë shfuqizimin e pikës 4 të udhëzimit. Por në përgjigjen e dt.26.10.2000 Ministri refuzoi zbatimin e këtij rekomandimi.

Duke patur parasysh Kushtetutën dhe legjislaionin e cituar më sipër dilte qartë se kjo rregullore e nxjerrë nuk mund të vendoste norma që përbëjnë kundravajtje administrative dhe aq më tepër të detyrueshme në lidhje me individët dhe subjektet e tyre që nuk i ka në varësi

Ministri i Shëndetësisë, prandaj ne insistuam në Rekomandimin tonë. Pas takimit që realizuam direkt me Ministrin e Shëndetësisë z. Leonard Solis, u ra dakort që rekomandimi ynë do të rishikohej.

Në përgjigje të kësaj të fundit Ministri i Shëndetësisë më datën 15.01.2001 nxorri Udhëzimin nr.20 me të cilin shfuqizoi pikën 4 të udhëzimit nr.362 dt.18.08.2000 dhe bëri edhe ndryshime të tjera, të cilat rregullojnë problemet që janë bërë pengesë në praktikë për funksionimin normal të Inspektoriatit Sanitar Shtetëror, duke mbetur brenda kompetencave që i lejon ligji dhe Kushtetuta.

Pas shfuqizimit të pikës 4 të këtij udhëzimi, zyra jonë njoftoi subjektet që u ishin shkelur të drejtat e tyre të ligjshme, duke i orientuar që meqenëse janë dënuar administrativisht nga Inspektoriatit sanitar i qytetit të Korçës me gjobat përkatëse, të kërkojnë pranë këtij organi anulimin e këtij urdhëri dhe kthimin e parave të gjobave.

16. ANKESA PËR ASISTENCA SOCIALE

Përsa i përket çështjeve të shqyrtuara deri tani me problematikë të asistencës sociale, rezulton se ndërhyrja e Avokatit të Popullit në tre prej këtyre rasteve ka qenë e domosdoshme, sepse janë konstatuar shkelje të të drejtave të qytetarëve. Më konkretisht, gjatë verifikimit dhe konstatimit të legjislacionit të nevojshëm për shqyrtimin e këtyre çështjeve, jemi gjendur përballë faktit të mungesës ose të shtrembërimit të përmbajtjes së ligjit.

Kështu, Avokati i Popullit ka ushtruar të drejtën e tij për rekomandime legjislative, sepse legjislacioni mbi asistencën sociale ka nevojë për plotësime, ndreqje e ndryshime. Këtë gjë e vërteton më së miri fakti që nga 7 praktika që janë paraqitur pranë Institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me asistencën sociale, 3 prej këtyre kanë shërbyer si shtysë për bërje rekomandimesh, sepse shqetësimi i tyre është një shqetësim i një numri jo të vogël personash ose familjesh. Mjafton t'i referohemi rastit të

S.M. ku preken interesat e 7817 familjeve. Gjithashtu shtojmë se dhe mendimet e specialistëve pranë strukturave përkatëse, të cilët janë në dijeni të ankesave për raste të tilla pohojnë nevojën e rregullimeve ligjore.

Ndërsa përsa i përket 4 ankesave të tjera i kemi refuzuar se kanë qenë jashtë kompetencës së institucionit tonë, sepse ankuesit kanë kërkuar përfitim të ndihmës ekopnomike. Në këto raste qytetarët janë orientuar se në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse janë në kompetencë të Këshillave të Bashkive e të Komunave kërkesat që ata parashtrojnë. Qytetarët janë vënë në dijeni se nëse plotësojnë gjithë kriteret e përcaktuara nga ligji nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmë ekonomike” vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit pranë bashkisë, nëqoftëse nuk do të trajtohen me ndihmë ekonomike, mund të ketë vend për ndërhyrje nga Avokati i Popullit për zvarritje procedurash.

Konkretisht 3 ankesat të cilat kanë shërbyer si shtysë për bërje rekomandimesh, ja vlen të përmenden në këtë raport vjetor:

- a. Një qytetar nga Korça, kërkoj që trajtimi që i bëhet me pension minimal të invaliditetit si i aksidentuar gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak, t'i jepet jo si invalid i thjeshtë, por si invalid ushtrie. Ai u ankua se është invalid faktik i cilësuar si i tillë me vendim përkatës të KMCAP, por nga ana tjetër dhe pse ushtria i njihej si vjetërsi në punë, ai nuk përfiton shtesë mbi pensionin e invaliditetit, sepse V.K.M. nr.381 dt.20.05.1996 “Për zbatimin e Ligjit nr.7889, dt.14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit” përcakton se shtesën mujore e përfitojnë vetëm: “Invalidët që kanë qënë të punësuar në ndërmarrje ose institucionet shtetërore dhe ish kooperativat bujqësore dhe janë me sëmundje profesionale ose të aksidentuar në punë”. Pra këtu nuk përfshihen të aksidentuarit gjatë shërbimit ushtarak. Ata nuk përfshihen në përcaktimin “të

aksidentuar në punë” megjithëse vitet e ushtrisë u njihen si vite pune.

- b. Në ankesën e tij, një qytetar nga Durrësi ankohet për një vendim të Seksionit të Mbrojtjes Shoqërore të Bashkisë, Durrës, i cili nuk i ka dhënë të drejtën e përfitimit të kujdestarisë për shkak të përkujdesjes ndaj djalit të tij që është invalid i grupit të parë. Nga informacioni i kërkuar nga seksioni i Ndihmës e Përkrahjes Shoqërore Bashkisë Durrës doli se personi ose familja e tij nuk përfitonte kujdestarinë, pasi kjo familje nuk trajtohej me ndihmë ekonomike për shkak se në urdhërin nr.2132, dt.23.09.1998 të Drejtorit të Administratës Qendrore të Ndihmës e Përkujdesjes Shoqërore, pjesa urdhëruese, pika 9, thuhet: Kujdestaria do t'i takojë vetëm familjeve që janë në skemën e ndihmës ekonomike”. Llogjika e ndjekur në trajtimin e këtij rasti, është ajo, sipas së cilës ankuesi apo çdo pjesëtar tjetër i familjes nuk përfiton kujdestari, pasi familja e tij nuk përfiton ndihma ekonomike. Kjo llogjikë është e pakuptimtë në mënyrën se si ekziston pikërisht në nenin 9 të urdhërit nr.2132, dt.23.09.1998 të sipërcituar. Përfitimi i kujdestarisë nuk duhet dhe s'ka pse të lidhet me skemën e ndihmës ekonomike. Edhe vetë ligji nr. 7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën dhe Përkujdesjen Shoqërore”, përkujdesjen për personin e paaftë e cilëson si kusht për përfitimin e ndihmës ekonomike. Për këtë arsye, është rekomanduar që pika 9 e këtij udhëri duhet të shfuqizohet.

Një moment tjetër ku kemi konstatuar mundësi për rekomandime, për plotësim të nenit 16/b të ligjit nr.7710 dt.18.05.1993 është përcaktimi i mungesës së parashikimit të organeve të ankimit administrativ kundër vendimeve të seksioneve përkatëse të bashkive e komunave. Kjo mungesë në ligj duhet plotësuar duke parashikuar në këtë ligj rrugën faktike që ndjekin për ankim familjet pretenduese për ndihmë ekonomike dhe që është: 1. Drejtoria Rajonale e Ndihmës dhe Përkrahjes Shoqërore;

2. Drejtoria e inspektimit, (Administrata Qendrore); 3. Gjykata kompetente.

c. Një qytetar nga Tirana u ankua për mostrajtim me ndihmë ekonomike për muajin nëntor 2000.

Nga verifikimet e bëra për këtë ankesë në seksionin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesjes në Bashki, rezultoi se:

E para - Janë 7817 familje që nuk janë trajtuar me ndihmë ekonomike për muajin nëntor 2000.

E dyta - Për shkak të zvarritjeve, procedurat e fondi i akorduar prej 13734000 lekë për këto familje është djegur, pasi ishte fond i vitit 2000 dhe nuk arriti të përdorej. Kështu që mundësia e marrjes së kësaj pagese si nga qytetari dhe nga 7817 familje nuk ekziston më me fondet e parashikuara të vitit 2000.

Për vetë rëndësinë që problemi paraqet i jemi drejtuar Zëvendës Kryeministres me rekomandimin për akordimin e një fondi shtesë nga Këshilli i Ministrave, si e vetmja mënyrë që qytetari dhe gjithë të tjerët të marrë pagesën e prapambetur që me të drejtë i takon me ligj ta përfitojnë dhe jo ta humbasin si rezultat i zvarritjeve që ndodhin në organet e administratës sonë publike.

17. MBI DISA PROBLEME TË MJEDISIT

Gjatë funksionimit të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë ardhur disa ankesa që kanë të bëjnë me mjedisin.

Në këtë kuadër po përmendim dy ankesa:

a. Ankesa e drejtuar nga 3 persona të një familje nga Lezha lidhur me ndërtimin e një impianti të përpunimit të mbetjeve urbane të qyteteve Lezhë dhe Shëngjin. Ai po ndërtohej pa respektuar distancat e caktuara, duke krijuar për pasojë ndotje të ajrit nga përpunimi i këtyre mbeturinave, duke dëmtuar shëndetin e familjeve dhe bën të pamundur qëndrimin në banesat e tyre.

Me të drejtë, këtyre qytetarëve nga rrethi i Lezhës ju pranua kërkesa dhe nga verifikimi i bërë doli se nuk ishin zbatuar vendimet dhe rregulloret higjeno-sanitare, pavarësisht se objekti i financuar nga Komuniteti Evropian kishte një rëndësi të veçantë për qytetin e Lezhës.

Pas rekomandimit të bërë nga Avokati i Popullit, organet që mbulonin këtë objekt pranuan shkeljet ligjore dhe trajtimi i këtij problemi po ndiqet nga ana e Prefekturës Lezhë.

b. Një ankesë tjetër drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit nga Kurbini, përfaqësonte afro 500 familje, kishte shqetësimin se këtyre familjeve u kishin shkaktuar dëmtime të konsiderueshme të mjedisit dhe materiale, si rezultat i teknologjisë së ulët të Uzinës së Bakrit Laç. Kjo ishte një ankesë disavjeçare dhe u verifikua në Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, (Drejtorinë e Përgjithshme të Minierave). Rezultoi se këtyre familjeve u është paguar si dëm një vlerë e konsiderueshme monetare në vitin 1990 si dhe në vitet e mëvonshme, por jo në shumën e plotë.

Në këto kushte, Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar që ky problem të gjejë zgjidhje përfundimtare. Drejtoria e Përgjithshme e Minierave, duke shqyrtuar në thellësi këtë problem do të krijojë një grup pune për të bërë bilancin e plotë të dëmit të shkaktuar e për të vazhduar shlyerjen e tyre.

18. ANKESA NGA FUSHA TË TJERA

Ankesa për çështje të tjera ne kemi patur 98, nga të cilat vlen të përmendim këto:

1. Ankesa e përfaqësuesve të Shoqatës “Çamëria”, të cilët kanë ngritur problemin e tyre që rrjedh nga historia dhe që është i mirënjohur për deputetet dhe gjithë opinionin publik shqiptar. Pranë nesh ato kanë pretenduar se ju është dhënë pa dëshirën e tyre shtetësia shqiptare me dekretin nr.1654 dt.19.04.1953

“Mbi dhënien e shtetësisë shqiptare çamëve që banojnë në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe kërkojnë ndërhyrjen tonë për anulimin e këtij dekreti. Gjithashtu janë ankuar pse nuk marrin përgjigje për letrat e tyre drejtuar Institucionit të Presidentit të Republikës. Nga ana jonë kanë marë përgjigje se kjo shtetësi shqiptare atyre u është dhënë duke patur parasysh faktin se ata, megjithëse në vitin 1945 kanë qënë shtetas grek, ishin dëbuar me dhunë nga trojet e tyre në Greqi dhe shteti shqiptar, mbas 8 vjetësh, kur konstatoi se për faj të palës greke, ishte e pamundur që çamët të ktheheshin në Greqi, ju dha shtetësia shqiptare. Kjo zgjidhje në atë kohë është bërë se nuk mund të qëndronin pa status në Shqipëri. Si rrjedhojë ne nuk mund të rekomandojmë zgjidhje tjetër, veç asaj që secili prej tyre, që nuk dëshiron të ketë shtetësinë shqiptare, të bëjë kërkesë zyrtare individuale për heqjen e shtetësisë, sipas ligjit në fuqi nr.8389 dt.05.08.1998. Përsa i përket ndërhyrjes pranë Presidentit të Republikës janë sqaruar se sipas pikës “a” të nenit 25 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ky Institucion është jashtë juridiksionit tonë.

Kurse përsa i përket çështjes tjetër të ankesës së Shoqatës “Çamëria” për mosgëzimin e pronave të tyre në Greqi, janë sqaruar se kjo çështje megjithëse është jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit, ne po punojmë për sensibilizimin e saj në arenën ndërkombëtare në kuadrin e shkeljes së të drejtave të njeriut nga shteti grek, por gjithësesi çdo individ çam duhet të gjejë rrugën dhe mënyrën për t’ju drejtuar individualisht me padi të rregullta gjykatave të shtetit grek, si për problemin e shtetësisë greke, ashtu edhe të gëzimit të pasurive të tyre. Pas ezaurimit të kësaj rruge gjyqësore, ato mund t’i drejtohen Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

2. Ankesa tjetër është gjithashtu e mirënjohur, sepse dihet që shtetasit shqiptarë që kanë prona në Greqi dhe disponojnë akte të rregulta pronësie, nuk lejohen t’i

gëzojnë ato me preteksin e “gjendjes së luftës” të Greqisë me Shqipërinë. Edhe në këtë rast qëndrimi ynë zyrtar dhe përgjigja është e njëjtë si për çështjen çame. Veçse është edhe detyrë e autoriteteve shqiptare që nëpërmjet rrugëve diplomatike të ndërhyjë që ankuesit e dy çështjeve të mësipërme të mos pengohen artificialisht nga shteti grek që të mbrojnë të drejtat e tyre në Gjykatën greke, sipas ligjeve të atij shteti dhe normave të njohura ndërkombëtare.

3. S.B. është ankuar se Arkivi Qëndror i shtetit nuk i jep dokumentat e kërkuara të cilat bëjnë fjalë për autobiografinë e të ndjerit H. B. dhe veprimtarinë e tij patriotike. Kjo ankesë u vlerësua e drejtë nga ne dhe e bazuar në ligjin nr.8503, dt.30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, prandaj ju bë Rekomandim Arkivit Qëndror të Shtetit që ankuesit t’i jepeshin dokumentat e kërkuara; Rekomandimi ynë u pranua nga Arkivi Qëndror i Shtetit, ankuesit ju ofruan dokumentat e kërkuara, dhe kështu që u vu në vend e drejta e shkelur.

Pikërisht për të lehtësuar marrjen e informacionit dhe të dokumentave zyrtare nga publiku ju kemi rekomanduar gjithë Ministrive, Institucioneve qëndrore dhe organeve të Pushtetit Vendor që më datën 09.11.2000 nxjerrjen e Rregullave përkatëse me arsyetimin si më poshtë:

Gjatë kryerjes së detyrës sonë Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, kemi ndeshur mjaft raste që organet e ndryshme të administratës publike nuk zbatojnë kërkesat e ligjit nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i cili rregullon këtë të drejtë që është parashikuar nga neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kështu ka raste që qytetarëve nuk u jepen informacionet ose dokumentet zyrtare që kërkojnë, nuk u krijohen lehtësi për t'i marrë apo informuar etj. Në rastet që kemi patur ankesa ne kemi ndërhyrë për realizimin e të drejtave të tyre.

Këto shkelje të Kushtetutës dhe ligjeve janë rrjedhojë jo vetëm të mendësive të vjetra, që e shikonte individin në shërbim të shtetit dhe jo ashtu siç e trajton sistemi demokratik: Administratën publike në shërbim të individit; Po kaq negativisht ndikon edhe mosnjohja si dhe sa duhet e Kushtetutës dhe ligjit “Për të drejtën e Informimit për dokumentet zyrtare”, megjithëse ky ligj ka më tepër se një vit që ka hyrë në fuqi.

Për të bërë të mundur që individët të realizojnë të drejtën e tyre kushtetuese për t'u informuar, ndër të tjera, ky ligj në nenin 6 të tij, ka vendosur *detyrimin e çdo autoriteti publik (çdo organ i administratës shtetërore dhe i enteve publike) që të nxjerrë rregullore dhe të krijojë lehtësi strukturore e praktike për marrjen nga ana e publikut, në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë të informacionit për dokumentet zyrtare. Po kështu, sipas nenit 8 të këtij ligji çdo autoritet publik është i detyruar të bëjë publike dhe të shumëfishojë vetë, në sasi të mjaftueshme dhe me formate të përshtatshme, dokumente që lehtësojnë informimin e publikut për:*

- a) *vendosjen e organeve qendrore dhe vendore, vendet, si dhe emrat e punonjësve nga të cilët publiku mund të marrë informacion, të paraqesë kërkesa apo të marrë përgjigje;*
- b) *rregullat, procedurat dhe mënyrat se si mund të merren formularët e ndryshëm, shpjegime për qëllimin dhe përmbajtjen e tyre apo të dokumentave dhe të vërtetimeve të nevojshme për plotësimin e formularëve;*
- c) *rregullat e përgjithshme ligjore, sipas të cilave vepron autoriteti publik, politikat e përgjithshme,*

që zbaton autoriteti publik, si dhe ndryshimet e bëra në to;

d) shpjegimet e detajuara për metodat dhe procedurat e punës së autoritetit publik.

Duke qenë se sipas nenit 18 të ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” Avokati i Popullit kujdeset për zbatimin e këtij ligji, kemi Rekomanduar:

A. Të nxirret Rregullorja përkatëse e Institucionit dhe të krijohen të gjitha lehtësitë strukturore dhe praktike për marrjen nga ana e publikut të informacionit për dokumentet zyrtare.

B. Kjo Rregullore t’u dërgohet për zbatim të gjitha autoriteteve publike ose njësive administrative që janë në varësinë e tyre.

Në zbatim të këtij rekomandimi vemë në dukje se na janë përgjigjur pozitivisht këto Ministri dhe Institucioni qendrore:

Ministria e Financave, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Ekonomisë dhe Privatizimit, Ministria e Transporteve, Ministria e Mbrojtjes, Banka e Shqipërisë, Agjensia Kombëtare e Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe ajo e Doganave si dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Por nga ana tjetër, vemë në dukje se nuk janë përgjigjur: Ministria e Punëve Publike, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Bashkëpunimit dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Kulturës dhe Sporteve.

19. ÇËSHTJE TË NGRITURA NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Në zbatim të kompetencave që parashikon neni 24 i ligjit “Për Avokatin e Popullit” për periudhën në shqyrtim kemi paraqitur dy kërkesa në Gjykatën Kushtetuese:

1. Objekti ka qenë interpretimi i pikës 2 të nenit 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për këto shkaqe:

Ndër subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese përfshihet edhe Avokati i Popullit, por, sipas nenit 134 pika 2 të Kushtetutës, kërkesën mund ta bëjë “vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij”. Përcaktimi nëpërmjet interpretimit, të rrethit të çështjeve që përbëjnë interesa të “Avokatit të Popullit”, në momentin kur sapo filluam punën paraqiste rëndësi për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, pasi diskutoi çështjen në tërësi, vërejtí se:

Sipas nenit 134 të Kushtetutës subjektet që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese ndahen në dy grupe; në subjekte që mund të ushtrojnë kërkesë në mënyrë të pakushtëzuar dhe në subjekte, që mund të ushtrojnë kërkesë të kushtëzuar “vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre”. Ky dallim, del nga përmbajtja e pikës 2, të nenit 134 të Kushtetutës dhe në këtë kategori subjektësh që mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë të kushtëzuar, përfshihet edhe Avokati i Popullit.

Sipas nenit 131 të Kushtetutës dhe neneve të tjera të saj, në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese përfshihen mjaft çështje për të cilat kjo vendos, por nga fryma e Kushtetutës që

gjen zbërthim në ligjin nr.8577, datë 10.02.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Avokati i Popullit ka të drejtë të parashtojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të kërkesave të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare (neni 49), për pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën (neni 52) dhe për interpretimin e

Kushtetutës (neni 71), gjithnjë kur çështja lidhet me interesat e tij.

Në bazë të paragrafit të parë, të nenit 60 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit ka për funksion të tij “të mbrojë të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike”. Në këtë kuptim, me çështje që lidhen me interesa të Avokatit të Popullit do të jenë pikërisht edhe ato çështje, që lidhen me këtë funksion kushtetues të ngarkuar Avokatit të Popullit, kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, e aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike, këto interesa janë cënuar duke shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve, shkelje këto, të konstatuara në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij.

Kushtetuta, në nenin 60, paragrafi 2 e 3, në nenin 61 dhe 62 të saj, vendos rregulla të organizimit e të funksionimit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Në kuptim të nenit 134, paragrafi 2 të Kushtetutës, me interesa të Avokatit të Popullit do të konsiderohen edhe rastet e cënimit të këtyre rregullave kushtetuese, që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, pavarësisht, nëse janë vërtetuar ose jo pasojat.

Për këto arsye, në përputhje me kompetencat e saj, Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.49 dt.31.07.2000, vendosi që Avokati i Popullit, në kuptim të nenit 134, paragrafi 2 të Kushtetutës mund t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rastet e parashikuara në nenet 49, 52 dhe 71 të ligjit nr.8577, dt.10.02.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, për çështje që lidhen me funksionin e tij në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, kur këto janë shkelur nga

veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike e të konstatuara nga Avokati i Popullit, si dhe kur janë cënuar rregullat kushtetuse për organizimin dhe funksionimin e institucionit të tij.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi nga miratimi i Kushtetutës.

Natyrisht ne jemi të kënaqur me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese sepse nuk e kufizon të drejtën tonë për të realizuar detyrën për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut dhe kemi filluar ta zbatojmë atë, siç është rasti i çështjes së mëposhtëme që ja kemi dërguar Gjykatës Kushtetuese.

Deklarimi i papajtueshmërisë me Kushtetutën i pikës 1 të gjermës “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000

Një shtetas, ish pronar trualli, me anë të letrës së tij, është ankuar se VKM nr.119 datë 18.03.2000 “*Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë*” i ka kufizuar atij dhe ish pronarëve të tjerë, në kushte të barabarta me të, një nga të drejtat themelore të njeriut, atë të ushtrimit të së drejtës së pronës së tij të ligjshme.

Nga shqyrtimi i gjithë legjislacionit përkatës, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, legjislacionit mbi Pronat në përgjithësi si dhe akteve përkatëse të Këshillit të Ministrave rezulton:

V.K.M. nr.119 datë 18.03.2000 në pikën 1 të gjermës “c” përcakton procedurat për llogaritjen e paketës së aksioneve për ish pronarët e truallit. Ndërmjet të tjerave aty thuhet se “*Ish pronarët e truallit kanë të drejtë të marrin aksione të shoqërisë që privatizohet, në bazë të sipërfaqes së trualli brenda kufizimit të shoqërisë dhe çmimit të truallit, përcaktuar sipas vendimit nr.312, datë 30.06.1994, të Këshillit të Ministrave*”.

Ne mendojmë se në gjermën “c”, pika 1 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000, që për çmimin e truallit referon zbatimin e V.K.M. nr.312 datë

30.06.1994 përbën një shkelje të pikave 1 dhe 4 të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për mbrojtjen e së drejtës së pronës private.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 312, datë 30.06.1994, ashtu siç thotë edhe titulli i tij *ka për qëllim që të caktojë çmimin e truallit që shitet për ndërtim personave fizikë e juridikë, si dhe çmimin e qerasë së truallit që u jepet në përdorim këtyre personave*. Në këtë vendim nuk përmendet se për cilat troje është fjala, por *nënkuptohe*t se *bëhet fjalë vetëm për trojet pronë shtetërore*, sepse që nga viti 1994 që ka dalë vendimi e më pas çmimi i tokës private dhe qeraja e saj janë liberalizuar.

Por ky vendim ka shërbyer (siç është përdorur deri më sot) për të përcaktuar edhe vlerën e tokës nën objektet që do t'i nënshtrohen procesit të privatizimit, edhe kur toka (trualli) nuk është pronë shtetërore.

Dihet se V.K.M. nr. 119 datë 18.03.2000 përbën një paketë të procesit të privatizimit dhe gjithçka është liberalizuar me përjashtim të caktimit të çmimit të tokës. Dhe kjo paraqet një kontradiktë.

Shteti ka të drejtë të përcaktojë vlerën e elementeve të objektit pronë shtetërore që do të privatizojë, siç janë vlera e ndërtesave, e makinerive e paisjeve, amortizimin e tyre, mjetet e xhiros, detyrimet e mbetura financiare, etj., dhe këto i përcakton në mënyrë të njëanshme, pasi është i vetmi pronar i tyre. Po kështu, shteti ka të drejtë të përcaktojë edhe vlerën e truallit ku gjendet objekti, kur toka është pronë shtetërore.

Por çështja ndryshon kur ndërmarrjet apo shoqëritë tregtare që privatizohen janë ngritur ose ndodhen në troje, pronë private, të cilat u janë njohur ose kthyer ish-pronarëve në bazë të ligjit 7698 datë 23.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve". Një gjë e tillë, natyrshëm, e lidh çështjen e çmimit të vlerësimit të truallit me të drejtën e pronës, e cila, siç dihet, është një ndër të drejtat themelore të njeriut, të parashikuara edhe në Kushtetutën tonë të vitit 1998.

Pra, nëse shteti mund dhe duhet të përcaktojë vlerën e elementeve të objektit, që ndodhen mbi truall siç u përmendën më lart, pasi është i vetmi pronar, një gjë të tillë nuk mund dhe nuk duhet ta bëjë për përcaktimin e vlerës së një trualli, pronar i të cilit nuk është më shteti, por një person tjetër fizik ose juridik, të cilit i është njohur prona me vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave, pavarësisht nëse i është kthyer ose jo fizikisht. Nëse shteti silllet njëlloj, si për pronën e tij, ashtu dhe për një pronë që nuk i përket, atëherë ndodhemi përpara cënimit të hapur të së drejtës së pronësisë që parashikohet e mbrohet nga neni 41 i Kushtetutës, i cili thotë se:

Pika (1): E drejta e pronës private është e garantuar.

Pika (4): Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrajt një shpërblimi të drejtë.

Sigurisht kur bëhet privatizimi i një objekti sipas kushteve që përcakton Vendimi Këshillit të Ministrave Nr.119 dt.18.03.2000 nuk ndodhemi përpara shpronësimit, por përpara një kufizimi esencial të pronësisë të pronarit të truallit, që i është njohur pronësia me vendim të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave, sepse pronari s'është më në gjendje të ushtrojë lirisht të gjitha tagrat e pronësisë. Në rastin e një objekti që privatizohet, ndodhemi përpara një situatë të komplikuar. Objekti mbi tokë është pronë shtetërore, ndërsa toka (trualli) është pronë private. Secili prej këtyre pronarëve, veçanërisht pronari i tokës, nuk është në gjendje të disponojë lehtësisht pronën e tij. Për të zgjidhur një konflikt të tillë, i cili është krijuar si pasojë e transformimit të ekonomisë nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu, është ndjekur, rruga e mesme që parashikon që pronarit të tokës, meqenëse i kufizohet e drejta e pronës, t'i jepet një shpërblim i drejtë në aksione. Në këtë kuptim ish pronari apo pronari i tokës duhet të marrë aq aksione sa është vlera e tokës nën objekt dhe përreth tij. Kjo rrugë deri në një farë mase përputhet me frymën e Kushtetutës, e cila i

trajton në mënyrë të barabartë kufizimin e të drejtës së pronës me shpronësimin përkundrajt një shpërblimi të drejtë.

Por nga ana tjetër, kjo do të thotë që si në rastin e kufizimit të së drejtës së pronës, ashtu dhe në atë të shpronësimit, masa e shpërblimit për pronarin që zhvishet nga pronësia, duhet të jetë jo vetëm e drejtë, por edhe e barabartë.

Këtë e garanton ligji nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.

Por nuk ndodh kështu në rastet e privatizimeve, kur për të llogaritur çmimin e trullit zbatohet vendimi Nr. 312 datë 30.06.1994. Masa e shpërblimit me aksione e përllogaritur sipas këtij vendimi, është shumë herë më e vogël se sa masa e shpërblimit që u jepet pronarëve që shpronësohen sipas ligjit 8561 datë 22.12.1999.

Nga praktika ka dalë që vlerësimet që kanë bërë grupe të ndryshëm të ekspertëve për shpronësimin e trojeve në rrethe të ndryshme të vendit janë disa herë më të mëdha sesa vlerat që parashikon vendimi 312. Shih p.sh. vendimin e Këshillit të Ministrave nr.596, datë 16.12.1999, i cili, në lidhje me shpronësimin e një sipërfaqe prej 179 metra katrore trull në Ersekë, zbatoi një çmim prej 1500 lekë për metër katrore (Gazeta Zyrtare nr.36, 1999, faqe 1417). Në fakt, për të njëjtën sipërfaqe po të zbatohej vendimi 312, masa e shpërblimit do të ishte 320 lekë për metër katrore, d.m.th. gati pesë here më pak. Ky dallim në shpërblim, mendojmë se ilustron në mënyrë konkrete pabarazinë që shkakton zbatimi i vendimit nr.312 datë 30.06.1994, krahasuar me shpërblimin që aplikohet sipas ligjit 7848, datë 25.07.1994 “Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtëshme” ose sipas ligjit të ri të shpronësimeve Nr.8561 datë 22.12.1999, që ka hyrë në fuqi me 1 mars 2000.

Është pikërisht ky ndryshim i dukshëm ose, e shprehur ndryshe, kjo pabarazi në trajtimin e pronarit, të cilit vlere e tokës i llogaritet mbi bazën e çmimeve që cakton V.K.M. nr.312 datë 30.06.1994, që përbën kufizim të së drejtës së pronës private dhe që vjen në kundërshtim me nenin 41, pika 4, të Kushtetutës, në dallim me pronarin që shpronësohet.

Për të gjitha këto arsye, në bazë të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës dhe pikës “b” të nenit 24 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, me datën 28.07.2000 i propozuam Kryeministrit Zotit Ilir Meta që të ndryshohet pika 1 në gjurmën “c” të V.K.M. nr.119, datë 18.03.2000, duke përcaktuar se “Çmimi i truallit caktohet sipas rregullave që caktojnë pikat 1 dhe 2 të nenit 17 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet...”. Në atë propozim theksuam se ndryshimi i pikës 1 të gjurmës “c” të V.K.M. nr.119, datë 18.03.2000 do të ishte edhe një kontribut i rëndësishëm i Qeverisë për të zbatuar nenet 178 dhe 181 të Kushtetutës, për të rregulluar drejtë çështjet e ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj kushtetute, duke u udhëhequr kështu nga kriteret e nenit 41 të saj.

Por më datën 25.10.2000, Qeveria na përgjigjet se “çështje të tilla, që duhet të pajtojnë të drejtën e pronës nga njëra anë, me tranzicionin dhe shpejtësinë e nevojshme të reformës nga ana tjetër, mbeten gjithnjë shumë të interpretueshme juridikisht... Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.119 datë 18.03.2000, ndryshe nga parashtrimi juaj nuk i referohet trojeve të njohura e të kthyera ish pronarëve. Pronat e kthyera nuk përfshihen në kapitalin e shoqërisë që privatizohet. Për pronën e përfshirë në Genplanin e objektit zbatohen legjislacioni i privatizimit dhe jo ai i kthim kompensimit”.

Si rrjedhojë, propozimi ynë u refuzua sepse sipas përgjigjes së mësipërme “Përfundimisht nuk mendojmë se kemi të bëjmë me ndonjë cënim direkt të neneve Kushtetuese dhe se çështja e masës së vlerësimit mund të

përmirësohet herë pas here jo thjeshte duke respektuar “tregun e trojeve”; por edhe legjislacionin dhe logjikën e privatizimit në tërësi”.

Duke studjuar ligjin nr.8334, datë 23.04.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, mbi bazën e të cilit është nxjerrë Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.119, dt.18.03.2000, dhe analizuar përgjigjen e mësipërme del se ajo është e pasaktë dhe kontradiktore në përmbajtjen e saj. Kjo del e qartë nga përmbajtja e nenit 1 të ligjit nr.8334, datë 23.04.1998 ku thuhet qartë se “Vlera e truallit, brenda kufijve të shoqërisë, është pjesë e pandarë e këtij kapitali (themeltar). Ish pronarët e truallit, si subjekte kërkuese kanë të drejtë të marrin aksione në përpjestim me vlerën e truallit të njohur, në bazë të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”.

Duke pasur parasysh se po në këtë dispozitë theksohet se “Vlera e truallit përcaktohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi...” del se përderisa nuk ka ndonjë ligj që të caktojë kriteret dhe kushtet për vlerën e truallit, nuk mund të vazhdohet të bëhet kjo gjë me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994, i cili efektivisht emërohet “Për çmimin e truallit që shitet dhe për qeranë e truallit që u jepet në përdorim për ndërtime personave fizikë dhe juridikë”.

Aq më tepër po të kemi parasysh edhe pikën 2 të nenit 181 të Kushtetutës, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994 nuk mund të zbatohet. Sipas pikës 2 të nenit 181 të Kushtetutës “Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet do të zbatohen kur nuk vijne në kundërshtim me të”.

Shqyrtimi i kësaj çështje u bë në Gjykatën Kushtetuese më datën 15.01.2001, por përfaqësuesi i Qeverisë, ministri i Ekonomisë dhe Privatizimit nuk u paraqit.

Gjatë shqyrtimit të çështjes nga ana jonë u paraqitën edhe argumentet e mëposhtëme në favor të kërkesës sonë:

Së pari: Propozimi ynë i datës 28.07.2000 për ndryshimin e V.K.M. nr.119 dt.18.03.2000 është mbështetur në Kushtetutë dhe në legjislacionin ekzistues të privatizimit dhe të kthim-kompensimit të ish pronarëve. Mbështetja juridike janë pikat 1 dhe 4 të nenit 41 dhe neni 181 i Kushtetutës. Në argumentet e Qeverisë thuhet se V.K.M. nr.119, dt.18.03.2000 nuk i referohet trojeve të njohura e të kthyer ish pronarëve, se në rastin konkret kemi të bëjmë me legjislacionin e privatizimit etj. Ky argument nuk është i vërtetë, sepse pika “c” e vendimit zë një vend të rëndësishëm dhe ka si qëllim për të përfshirë pronarët e truallit në privatizim, duke i referuar ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave. Përpjekja për të ndarë legjislacionin, duke u justifikuar me tranzicionin dhe me shpejtësinë e nevojshme të reformës, nuk është e drejtë, sepse justifikon një privatizim larg parimeve kushtetuese dhe atyre të legjislacionit të kthimit e të kompensimit të ish pronarëve.

Së dyti, në përgjigjen e Qeverisë thuhet se në privatizim bëhet kujdes që pronari të mos përjashtohet nga e drejta e pronësisë, madje edhe masa e shpërblimit me aksione, bazuar në vendimin nr.312 dt.30.06.1994 përbën një afrim me çmimet e tregut. Kjo gjë jo vetëm nuk është e vërtetë (shih shembullin e cituar për Ersekën), por në të njëjtën kohë është një pohim se nuk është sa çmimi i tregut. Lirshëm lind pyetja: Pse bëhen akte normative dhe çmimi i trojeve nuk përputhet me çmimin e tregut? Dhe kjo ndodh në një kohë që po të zbatohen parimet dhe rregullat e ligjit nr,8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet për interes publik...” nuk do të ekzistonte kjo pabarazi e madhe. Kështu po të marrim edhe rastin konkret, trualli ndodhet në kodrën e Rashbullit, në afërsi të rrugës automobilistike Sukth Durrës dhe zbatohet një çmim 480 lekë për m². Shikoni publikimin në Gazetën Shqiptare datë

19 dhjetor 2000, listën e personave që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Sukth-Durrës. Çmimi për tokën bujqësore është 1200 lekë për m². Pabarazia është e qartë edhe me këtë krahasim. Po të marrim edhe faktin që në rastin konkret truallit të kantinës së verës, që pretendon ankuesi, zona mund të konsiderohet turistike dhe çmimi mund të jetë edhe 3200 lekë për metër katror.

Së treti, edhe në qoftë se përmendim llogjikën e privatizimit, doja të theksoja se shteti në rastin tonë vepron dhe ndërhyr pa llogjikë privatizimi pasi marrëdhëniet e privatizimit që krijohen në këtë rast janë marrëdhënie ndërmjet privatësh, ndërmjet personit që e blen, privatizon objektin dhe pronarit të truallit që me anë të aksioneve bëhet bashkëpronar me atë që blen objektin. Pra pse duhet që ky pronar i ri që blen objektin të jetë në kushte favorizuese, kundrejt aksioneve të truallit jo me vlerën reale, pra ish pronari të jetë në kushte diskriminuese, sepse vlera e aksioneve të tij është më e ulët. Dhe kjo ndodh në një kohë që faktikisht shteti ka më shumë detyrime ndaj ish pronarit të truallit. Pra shkelet neni 18 i Kushtetutës për barazinë para ligjit.

Së katërti, një problem tjetër që krijohet në këtë rast është se pronari i truallit futet detyrimisht në marrëdhënie juridike bashkëpronësie dhe i hiqet e drejta e kompensimit. Kjo do të thotë se n.q.se. objekti do të vazhdonte të ishte shtetëror, pronari i truallit do të kërkonte të kompensohej për truallin e zënë. Në këtë rast kompensimi do të ishte i barazvlefshëm me truallin e tij, ndërsa në rastin e privatizimit në këto kushte shteti nuk i jep atij barazvlerën e truallit me çmimin e tregut. Në këtë rast do të kemi parasysh edhe nenin 16 të ligjit nr.7698 dt.15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve”, i cili në pikat “b” dhe “c” lejon që ish pronarët të kompensohen me sipërfaqe trojesh ose sipërfaqe trojesh në zonat turistike, ekuivalente, që do të thotë të barabarta në sasi për metër katror. Kurse pika “a” e nenit 16 përcakton si formë obligacionet shtetërore që do të përdoren sipas

vlerës ekuivalente dhe me përparësi në marrëdhënie me shtetin, ashtu siç po veprohet si në procesin e privatizimit të objekteve shtetërore.

Pra po të pranojmë se obligacionet në këtë rast do të jenë aksionet, a nuk duhet që ato të jenë ekuivalente, të paktën në vlerë, në raport me ato troje që do merrte pronari po të zbatoheshin format e kompensimit të parashikuara në pikat “b” dhe “c” të nenit 16.

Sikur të merrnim rastin e kundërt: E njëjta pronë që është shitur nga shteti, për një arsye ose një tjetër shteti kërkon ta shtetëzojë përsëri, cili do të ishte çmimi i truallit? Këto raste nuk janë më teorike, po të kemi parasysh rastin e riblerjes së ish Hotel Drinit në Tiranë nga Shteti.

Për të gjitha këto arsye, ne kemi kërkuar nga Gjykata Kushtetuese:

Deklarimin të papajtueshëm me Kushtetutën dhe shfuqizimin e pikës 1 të gërmës “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119 dt.18.03.2000 si dhe të çdo akti tjetër normativ të Qeverisë që i referohet kjo dispozitë në lidhje me caktimin e vlerës së truallit ish pronarëve që ju është kthyer prona me vendim të Komisioneve të Kthimit e Kompensimit të Pronave.

Gjykata Kushtetuese nuk e ka shpallur akoma vendimin e saj.

KREU I TRETË

VEPRIMTARI TË TJERA TË INSTITUCIONIT

1. Marrëdhëniet publike përmes medias

Duke e çmuar si një komponent të rëndësishëm këtë fushë, paralelisht me fillimin e hapjes së ankesave të para nga ana jonë, ne hartuam edhe një strategji të mbulimit mediatik, të cilën ua bëmë të njohur edhe Grupit të Miqve.

Bashkëpunimin me median e kemi parë si mjetin më efikas për të siguruar aksesin e nevojshëm në publik si dhe krijimin e individualitetit të domosdoshëm të Institucionit për ushtrimin e funksionit, sipas Kushtetutës dhe Ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Në strategjinë e mbulimit mediatik janë patur parasysh si ndërgjegjësimi i publikut, ashtu edhe efekti edukativ i informacionit, si për qytetarët, ashtu edhe për administratën. Dhe kjo është bërë me pasqyrimin e vazhdueshëm në shtyp të të gjithë atyre rasteve, kur administrata na ka mirëkuptuar, duke rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit. Veç kësaj, shtypi na ka ndihmuar edhe me rolin e tij si mjet presioni, qoftë mbi ne, qoftë edhe mbi administratën apo personat e veshur me autoritet publik, kur këta të fundit e kanë bërë veshin të shurdhër përballë rekomandimeve tona.

Larminë e problematikës, të cilën ne e kemi përdorur për t’u prononcuar në shtyp e kemi pasqyruar pa komente në tabelat përkatëse që tregojnë statistikën e mbulimit mediatik. Në një farë mënyre, duke u nisur qoftë edhe nga titujt e informacionave nga ne dhe për ne, aty shikohet dhe kuptohet edhe rruga që ne kemi përshkruar deri tani. (Shikoni pasqyrat 15-22)

Gjatë muajve shtator-tetor 2000, për shkak të fushatës së zgjedhjeve vendore, Avokati i Popullit nuk ka patur shumë hapësirë në median elektronike për të vazhduar strategjinë e promovimit të institucionit dhe pasqyrimin e ndërhyrjeve të kryera.

Mjetet që kemi përdorur kanë qenë aksesit në median elektronike, median e shkruar, intervistat, bisedat, pyetje-përgjigjet e drejtpërdrejta, njoftimet për shtypin dhe prononcimet, takimet njohëse dhe sqaruese me grupe të ndryshme të komunitetit si dhe botimi i një fletpalosjeje dhe broshure, kjo edhe në gjuhën angleze. E njëjta punë do të vijë duke u pasuruar edhe në të ardhmen. Ajo që ka mbetur pa bërë, por që do të bëhet njëkohësisht me instalimin e teknologjisë informative, është krijimi i faqes së internetit, ku të interesuarit pritet të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me zyrën tonë dhe aktivitetin që kryen ajo.

Është e kuptueshme që **mbulimi mediatic është gjithmonë në përshtatje me problematikën dhe intensitetin e punës që institucioni kryen**. Me kalimin e kësaj faze, ne e ndjejmë edhe vetë të nevojshme si **objektiv** se fillon një fazë e dytë, ku krahas konsolidimit të institucionit, do të vijë duke u forcuar edhe autoriteti i tij publik, me **synimin që rekomandimi i Institucionit të Avokatit të Popullit të realizojë edhe më shumë impaktin pozitiv të pritshëm në administratë dhe opinionin publik**. Kjo, pasi ne mendojmë se, pa neglizhuar për asnjë moment vëmendjen nga ankesat e përditshme të qytetarëve, Institucioni ynë do të dijë të orientohet për të ndikuar pozitivisht edhe në mekanizmin administrativ, të cilit i ka rënë njëkohësisht fati dhe barra të përballojë sfidat që Shqipëria domosdoshmërisht lipset të përballojë si shtet në proceset integruese, sikundër është le të themi Pakti i Stabilitetit. Në përputhje me këtë angazhim ne do të rrisim edhe më shumë intensitetin e zërit tonë në opinionin publik, gjithmonë në mbrojtje të të drejtave të ligjshme të qytetarit, pasi sikundër dihet, **e drejtë e njeriut konsiderohet edhe e drejta e një populli për t'u mirëqeverisur**.

Informacionet nga shtypi përbëjnë bazën e një drejtimi të rëndësishëm të punës tonë, sikundër është vënia në lëvizje me iniciativë. I gjithë spektri i shtypit të

përditshëm, por edhe atij periodik shqiptar filtrohet posaçërisht në zyrën tonë dhe informacionet që paraqesin interes për objektin e punës tonë, u shpërndahen seksioneve sipas problematikës. Seksionet më pas bëjnë verifikimet përkatëse dhe sipas rastit, ose nisin investigimin, ose i mbajnë në evidencë informacionet për arsye studimore.

Si rrjedhojë, kemi paraqitur pasqyrën e rasteve ku kemi ndërhyrë, fillimisht me iniciativë, duke marrë shkas nga shtypi dhe më vonë pëlqimin e të dëmtuarve. (Shikoni pasqyrën nr.23)

2. Marrëdhëniet me Jashtë të Institucionit të Avokatit të Popullit

Nën emërtime të ndryshme si ai i “Ombudsmanit” në vendet skandinave dhe të tjera, ai i “Mbrojtësit të Popullit” në Afrikën e Jugut, ai i “Mbrojtësit të Drejtësisë” në Portugali apo i “Mediatorit të Republikës” në Francë Institucionet e tipit të Avokatit të Popullit ekzistojnë në mbi 100 vende të botës dhe në Europë tashmë në mbi 30 vende.

Të gjithë këto Institucione mbajnë lidhje të rregullta në kuadrin e (1) Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI), (2) Institutit European të Ombudsmanëve (EOI) i krijuar në 1978 dhe (3) Shoqatës së Ombudsmanëve Frankofone. Ky komunitet në shkallë botërore i Ombudsmanëve nuk do të mund të siguronte përkrahjen që jep për hapjen dhe zhvillimin e Institucioneve të tilla si edhe për promovimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarit kundrejt veprimeve të parregullta të Administratës Publike, pa një bashkërendim efikas midis anëtarëve të tij.

Është sukses që duhet vënë në dukje se Institucioni shqiptar i Avokatit të Popullit është pranuar anëtar votues në të tre organizmat ndërkombëtare të Ombudsmanëve, përkatësisht në maj 2000 në EOI, në korrik 2000 në IOI dhe në shtator 2000 në Shoqatën e Ombudsmanëve Frankofonë. Duke theksuar rëndësinë e këmbimit të

përvojës dhe eksperiencës me një sërë vendesh të Europës, duhet të vemë në dukje se ne kemi ngritur një strategji të qartë për vazhdimësinë e bashkëpunimit me familjen e madhe të Ombudsmanëve, duke pasur parasysh rrethanat, veçoritë historike, interesat kombëtare dhe politike të Shqipërisë. Mendojmë se një bashkëpunim më i ngushtë dhe frytdhënës do të jetë ai në kuadrin e vendeve ballkanike. Prandaj janë parashikuar takime si në Tiranë dhe në vendet respektive me kolegët grekë, maqedonas, kroatë, rumunë dhe Ombudsmanin e Kosovës.

Është menduar të thirret një Konferencë Ballkanike gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2001, e organizuar dhe drejtuar nga Avokati i Popullit shqiptar dhe do të kërkojmë mbështetje nga Danida, përfaqësia e OSBE-së në Tiranë, përfaqësia e Këshillit të Europës në Tiranë dhe nga ABA-CEELI për të garantuar suksesin e kësaj konference.

Një takim i këtij niveli deri tani është zhvilluar me inisiativën dhe sponsorizimin e Ministrisë së Jashtme Suedeze në Stokholm, në maj 2000 me përfaqësues të Ombudsmanëve të vendeve të Ballkanit. Ky takim ndër të tjera pikësynonte një afrim më të madh në kuadrin e bashkëpunimit të vendeve tona.

Avokati i Popullit ka marrë pjesë aktive kur është ftuar në konferencat e organizuara për mbrojtjen dhe promovimin e të Drejtave të Njeriut në nivelin ndërkombëtar, duke mbështetur dhe bashkëpunuar me organizmat ndërkombëtare si Këshilli i Europës (takimet e Dublinit dhe Strasburgut, Mars 2000 dhe Budapestit, Qershor 2000 apo takimi i Messines, tetor 2000, i organizuar nga Qendra Ndërkombëtare e Kërkimeve dhe e Studimeve Sociologjike dhe Penale, me temë: "Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, 50 vjet eksperiencë, aktorët dhe protagonistët e Konventës, e shkuara dhe e ardhmja".

Në kontekstin e ngritjes së Institucionit të Ombudsmanit në vendet e tjera të Europës Lindore,

Avokati i Popullit mori pjesë në takimin e zhvilluar në Pragë (Prill 2000) së bashku me Ombudsmanët e tjerë Europeanë për të diskutuar dhe dhënë ide dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve të shumta të kandidatëve për Ombudsman në Republikën Çeke. Ky takim ishte me interes të veçantë për një ombudsman të porsazgjedhur si ai shqiptar dhe në të morën pjesë gjithashtu 2 deputetë shqiptarë.

Njëkohësisht Komisioneri Agron Çausi mori pjesë në Konferencën e organizuar në Athinë nga Këshilli i Europës, në maj 2000 me temë: “Sfidat e Ombudsmanit për realizimin e të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike”. Kurse në takimin e zhvilluar në Bruksel në nëntor 2000 me temë: “Sistemi gjyqësor dhe reformimi i tij”, i organizuar nga Këshilli i Europës dhe Bashkimi European mori pjesë dhe diskutoi Komisioneri Jorgo Dhrami. Një nga fushat e tjera të rëndësishme për kontributin tonë është edhe Pakti i Stabilitetit ku Institucioni ynë ka marrë pjesë rregullisht në diskutimet e bëra në tryezën e parë të Paktit si edhe në takimin rajonal për tryezën e parë i mbajtur në Bukuresht në tetor 2000, ku u përfaqësua nga Komisionerja Florina Nuni.

Brenda kuadrit të bashkëpunimit me OJQ-të, një seminar me temën “Vendi dhe Roli i Avokatit të Popullit në Shoqërinë Civile”, u zhvillua në 22 shtator 2000 me financimin e Fondacionit Publik Gjerman “Friedrich Ebert” me pjesëmarrje të OJQ-ve shqiptare si dhe të Institucioneve shtetërore.

Këshilli i Europës së bashku me Institucionin e Avokatit të Popullit organizoi një Seminarin me temë “Roli dhe ngritja e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri” në tetor 2000, në Tiranë, me pjesëmarrje të ekspertëve vendas dhe të huaj.

Marrëdhëniet e Jashtme të Institucionit të Avokatit të Popullit janë mbështetur dhe nxitur nga “Grupi i Miqve” të tij. Grupi ka funksionuar menjëherë mbas zgjedhjes së Avokatit të Popullit dhe ka bërë takime të rregullta mujore

ku janë këmbyer mendime për probleme të ndryshme me të cilat është ndeshur Institucioni i sapokrijuar.

Në kuadrin e mbështetjes për ngritjen, mirëfunksionimin dhe forcimin e Institucionit dëshërojmë të theksojmë se rolin kryesor e ka luajtur dhe vazhdon ta luajë DANIDA, (Asistenca Daneze për Zhvillimin Ndërkombëtar) Aspektet ku DANIDA asiston Institucionin tonë janë:

1. Rehabilitimi i Selisë dhe pajisja me mjete bashkëkohore pune për Zyrën.
2. Kualifikimi i punonjësve.
3. Organizimi i seminareve, workshop-eve dhe trajnimeve të tjera të këtij lloji në Tiranë me pjesëmarrjen e ekspertëve vendas dhe atyre ndërkombëtare si dhe jashtë shtetit në Zyrën Daneze të Ombudsmanit.

Në shtator 2000 u realizua vizita në Tiranë e Ombudsmanit danez, z. Hans Gammeltoft-Hansen dhe e Ombudsmanit sloven, z. Bizjak. Kjo vizitë shënoi një hop cilësor në inkurajimin e Institucionit për të vazhduar sipas strategjisë së përcaktuar nga Avokati i Popullit.

Deri në këtë moment mbas një diskutimi të frytshëm që u zhvillua me Ombudsmanin Danez Z. Hans Gammeltoft-Hansen (Kopenhagen, janar 2001) u përcaktua sistemi i software që do të përdoret në zyrën tonë si edhe fushat e ekspertizës daneze, në të cilat do të asistohet Institucioni ynë deri në qershor 2002.

Në kuadrin e marrjes së përvojës dhe këmbimit të eksperiencës një grup i përbërë nga Avokati i Popullit dhe 3 Komisionerët bënë vizitën studimore në Slloveni, në Prill 2000, dhe në Hungari në tetor 2000, vizita të organizuara dhe sponsorizuara nga Këshilli i Europës. Për shkak të problemeve të punës që kanë dalë papritur, kemi anuluar në momentet e fundit vizitat me ftesa zyrtare nga Ombudsmani grek, në qershor 2000 dhe Mediatori francez, në dhjetor 2000.

Aktiviteti më i rëndësishëm ndërkombëtar ishte Konferenca e VII-të Ndërkombëtare e Ombudsmanëve e zhvilluar në Durban, Afrika e Jugut në nëntor 2000.

Për herë të parë, anëtarët e IOI u takuan në Konferencë në Afrikë. Kjo konferencë ju drejtoi si mesazh të gjithë vendeve në tranzicion se ç'hapa duhet të ndërmerren për të arritur ndryshime demokratike.

Të jetosh në një shoqëri të drejtuar me mirëqeverisje u konsiderua si e drejtë themelore njerëzore nga Konferenca. Cilësia e jetës së qytetarit ndikohet materialisht si nga vendimet e marra nga Qeveria, ashtu edhe nga mënyra se si zbatohen këto vendime.

Një shoqëri civile dhe e drejtë kërkon një sistem qeverisjeje i cili ndërsa operon (vepron) brenda shtetit ligjor dhe aderon në të drejtat njerëzore, ofron një njohje më të gjerë të nevojës për besueshmëri nga ana e qytetarëve, në emër të të cilëve qeveria merr përsipër përgjegjësitë e saj.

Institucioni i Ombudsmanit vlerësohet një mekanizëm efikas besueshmërie, prandaj kjo Konferencë u përqëndrua në rolin e Ombudsmanit për sigurimin e një mekanizmi, i cili të mundësojë balancimin e kërkesës themelore: Qeveritë të jenë në gjëndje të qeverisin, por njëkohësisht të jenë subjekt i besueshmërisë së duhur.

Konferenca e Ombudsmanit në Durban inkurajoi ndihmën dypalëshe midis anëtarëve dhe i ofroi ndihmesën e tyre vendeve që kërkojnë të ngrejne Institucionin e Ombudsmanit.

Në përfundim të çdo takimi, seminari apo konference, pjesëmarrësit nga zyra jonë përgatisin raporte informuese për punonjësit e Institucionit, të cilët ftohen të analizojnë konkluzionet dhe të ndërtojnë strategjitë përkatëse për punën e secilit dhe të gjithë Institucionit.

3. Përdorimi i buxhetit pët vitin 2000

Këshilli i Europës u ka bërë të ditur shteteve anëtare se vendimi për të ngritur Institucionin e Ombudsmanit kërkon një përkushtim si politik, ashtu edhe financiar. Mbështetja politike përkrijimin e tij duhet shoqëruar me një mbështetje financiare, që mundëson Ombudsmanin të ngrihet dhe të vazhdojë të funksionojë. Lënia e Ombudsmanit pa ndihmë financiare minon qëllimin e krijimit të tij. Pikërisht duke patur parasysh sa sipër Komuniteti Ndërkombëtar nëpërmjet

projektit Danida ka planifikuar që deri në qershor 2002 të mbështesë ngritjen dhe konsolidimin e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri me një shumë rreth 1 milion USD. Pra koston financiare më tepër ka parashikuar ta përballojë Komuniteti Ndërkombëtar.

Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2000 i është akorduar buxheti në shumën 36 500 000 lekë (afërsisht 250.000 USD):

| | Plan | Fakt | Realizimi |
|---------------------|-------------------|-------------------|------------------|
| Pagat e punonjësve | 10 000 000 | 9 974 706 | 99,7% |
| Sigurimet shoqërore | 2 500 000 | 1 505 748 | 60,2% |
| Shpenzime operative | 9 824 000 | 9 338 748 | 95% |
| Kuote anëtarësie | 176 000 | 154 516 | 87,8% |
| Pajisje zyre | 1 480 000 | 1 478 560 | 99,9% |
| Rikonstruksion zyre | 4 519 000 | 4 519 531 | 100% |
| Automjete | 8 000 000 | 7 995 000 | 100% |
| Totali | 36 500 000 | 34 966 809 | 98,8% |

Duke parë realizimin e shifrave të buxhetit themi se Institucioni i Avokatit të Popullit buxhetin e akorduar nga Qeveria në prill 2000 e ka realizuar në masën 98,8%. Sidoqoftë kontrolli financiar i Institucionit do të bëhet i plotë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe raporti i Kontrollit, sipas ligjit do t'i paraqitet edhe Komisionit Parlamentar për Financat.

Shpenzimet që ka përdorur Institucioni për të realizuar detyrat kanë qenë për artikuj kancelarie, pagesa telefoni, karburant, posta, shpenzime pritje, dieta etj.

Pagesa e kuotës vjetore për pjesëmarrje në organizmat ndërkombëtare si: Instituti European në Innsbruck, dhe Shoqata e Ombudsmanëve të Frankofonisë është 1034 USD.

Për buxhetin e shtetit të vitit 2001 janë akorduar shifrat e kërkuara dhe diskutimi i këtij buxheti është përfaqësuar nga Avokati i Popullit.

Ndërkaq siç kemi spjeguar më sipër Institucioni ynë mbështetet financiarisht nga projekti Danida, i cili në vitin 2000 na dhuroi pajisje të tilla si 4 kompjutera, 4 automjete, 2 fotokopje, 10 tavolina etj., në një shumë rreth 95 mijë

USD, me të cilat ne kemi realizuar veprimtarinë tonë deri tani.

Në kuadër të këtij projekti do të përfundojë së shpejti rikonstruksioni i Selisë dhe pajisja me mjetet bashkëkohore të punës. Të gjitha tenderat janë bërë nga Ambasada Daneze, e cila kontrollon edhe të gjitha shpenzimet në kuadër të projektit Danida.

4. Vlerësime nga qytetarët në adresë të Institucionit të Avokatit të Popullit

Kemi paraqitur disa letra nga ankuesit, me anë të të cilave ata shprehen për mënyrën e sjelljes dhe zgjidhjen e kërkesave të tyre nga stafi i Institucionit të Avokatit të Popullit. Letër nga shtetësja N.S. nga Tirana më 18.10.2000

1. Letër nga i dënuari M. Gj. nga Burgu i Burrelit më 22.10.2000
2. Letër nga z. G. P. Tiranë më 20.12.2000
3. Letër nga z. Th. Q. nga fshati Xarë, Sarandë, më 14.01.2001
4. Letër nga z. G. M. nga Tirana më 24.01.2001.

Gjithashtu kemi edhe dy letra nga Korça, me anë të të cilave ankuesit kanë shprehur dyshime për qëndrime subjektive ndaj dy punonjësve të Institucionit, por ato pretendime janë verifikuar personalisht nga Avokati i Popullit dhe ankuesve u është dhënë përgjigje se pretendimet e tyre janë të pavërteta.

KREU I KATËRT

PËRFUNDIME

Pas përshkrimit të veprimtarisë vjetore të Institucionit, ky Raport do të ishte jo i plotë, i pasaktë dhe jo efikas, në qoftë se atij do t'i mungonin edhe disa konstatime të tjera për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri, si dhe përfundimet tona, të paraqitura në formën e mangësive, epërsive, objektivave dhe strategjive për të arritur pikësynimet e Institucionit për të ardhmen.

Në lidhje me gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri jemi shprehur në Raportin e plotë, kur kemi analizuar fusha të caktuara, por për problemet e mëposhtëme ne nuk mbështetemi mbi ankesat e kërkesat e ardhura pranë nesh në periudhën qershor-dhjetor 2000. Ne të kemi parasysh edhe informacionet, studimet dhe sondazhet e publikuara në Mediat shqiptare, të cilat natyrisht paraqesin një shkallë besueshmërie, që për të qenë brenda, po themi mesatare. Gjithashtu në ndonjë rast i referohemi edhe raporteve të organizmave të specializuara ndërkombëtarë.

Dihet se në Kushtetutën Shqiptare të vitit 1998 të drejtat dhe liritë themelore të njeriut zenë gjithë pjesën e dytë, nga neni 15-59, pra 44 nene. Është fakt se gjendja e **Lirive dhe të Drejtave Vetjake** si liria e shprehjes, e shtypit, medias e televizionit, liria e ndërgjegjes dhe e fesë, liria individuale, paprekshmëria e banesës, liria e fshehtësia e korrespondencës janë të garantuara me ligj. Ka dhe do të ketë ankesa apo edhe mbrojtje të tyre me anë të proceseve gjyqësore, por mendimi ynë është se këto të drejta respektohen dhe shkeljet e tyre kur janë vërtetuar, janë dënuar shkaktarët e tyre. Po kështu edhe **Liritë dhe të Drejtat Politike** si e drejta e zgjedhjeve, e organizimit dhe tubimit (nenet 45-47). Duke patur parasysh të drejtën e **Jetës** (neni 21) mund të themi se shpallja si antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese e dënimit me vdekje është një arritje. Por në fakt rezulton se janë mbi 1000 familje në zonat veriore që për shkak të **Gjakmarrjes**

nuk kanë asnjë siguri për jetën e pjesëtarëve të tyre, qofshin meshkuj apo femra, të rritur apo fëmijë. Këta njerëz që mund të kapin shifrën 5 mijë, janë të kufizuar në lirinë e lëvizjes së tyre apo nga e drejta e arsimit etj.

E drejta e Arsimit, por sidomos arsimi shkollor i detyrueshëm (neni 57) po merr goditje të rënda. Po rritet një brez i ri, analfabet ose gjysëmanalfabet, sepse sipas sondazheve, ka fshatra e krahina të tëra ku rreth 70% e fëmijëve të nxitur nga shkaqet ekonomike, braktisin shkollat. Veç kësaj po shtohen rastet kur **Fëmijët** preken nga pedofilia, pa folur për rastet kur ata përdoren si skllëvër për të lypur apo prostitucion.

Të rënda janë edhe shkeljet e të drejtave të **Grave**. Sipas mediave rreth 3000 vajza shqiptare nuk janë të lira, sepse janë të detyruara të ushtrojnë prostitucionin jashtë Shqipërisë. Gjendja e tyre rëndohet duke patur parasysh statistikën, sipas të cilave nga rreth 22 mijë martesë në vit, rreth 1/3 e tyre prishen brenda 5 vjetëve, duke bërë edhe rreth 5 mijë fëmijë, pa të dy prindërit dhe si pasojë duke rritur kontigjentin e fëmijëve pa mbështetje, dhe të të rriturve që do kenë probleme në të ardhmen.

Për të realizuar si duhet mbrojtjen e veçantë të shtetit, siç parashikon neni 53 i Kushtetutës për martesën dhe familjen, është e pajustificuar, që akoma nuk është përgatitur dhe miratuar **Kodi i ri i Familjes**. Dihet se këto marrëdhënie vazhdojnë të rregullohen akoma me **Kodin Socialist të Familjes** të vitit 1981.

Trajtimi i të degraduarve, të **Sëmurëve** mendorë në spitalet tona psikiatrike vazhdon të jetë një problem shqetësues edhe për Komitetin Europian për parandalimin e Torturës, trajtimeve çnjerëzore dhe degraduesve (CPT). Keqtrajtimet përfshijnë edhe kushtet e higjienës, ushqimit, ngrohjes, fjetjes etj, duke mos përjashtuar edhe akuzat për abuzime financiare në dëm të këtyre fatkeqëve.

Vazhdon të mbetet problem mosnxjerrja e ligjeve për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me **Shpronësimet** dhe **Konfiskimet** e kryera para

miratimit të Kushtetutës së vitit 1998, për garantimin e së drejtës së **Pronës Private**, sipas neneve 41 dhe 181 të Kushtetutës. Kanë kaluar mbi dy vjet dhe kanë mbetur rreth 9 muaj për të realizuar këtë detyrim Kushtetues.

Një detyrim Kushtetues është edhe rregullimi i **Statusit të Organizatave Jo Qeveritare**, por duhet patur parasysh që të mos bëhen ligje për t'i vënë ato nën kontrollin e qeverisë. E paplotësuar është edhe detyra kushtetuese për të rregulluar **Marrëdhëniet ndërmjet Shtetit dhe Bashkësive Fetare** mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave (neni 10). Liria e fesë dhe ndërgjegjes janë të garantuara, por rezulton se në zbatimin e kësaj të drejte ka probleme. Tipik është rasti i 4 nxënësve të shkollës së mesme të gjuhëve të huaja në Tiranë që janë ndaluar të futen në mësim, sepse mbulojnë kokën me shami.

Vështirësitë e Institucionit dhe shkaqet e tyre

Të metat dhe shkaqet e tyre në veprimtarinë e Institucionit tonë nuk janë evidentuar me subjektivizëm, por përshkohen nga objektiviteti dhe realizmi i thellë i analizës konkrete, në kushtet e një vendi në tranzicion dhe pa traditë të institucioneve demokratike. Ne mendojmë se ato janë:

1. Mosnjohja sa dhe si duhet e publikut shqiptar me normat për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe rolit të Avokatit të Popullit në mbrojtje të tyre.

Kjo mangësi është më e gjerë dhe më e thellë, sidomos në fushën e lirive dhe të drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në raport me të drejtat dhe liritë Themelore, ato Vetjake dhe Politike.

2. Mungesa e traditës, meqenëse punojmë në një fushë dhe në një lloj veprimtarie pothuajse të panjohur më parë, sepse me përjashtim të vendeve Skandinave, edhe në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës Perëndimore, ky institucion është relativisht i ri.

3. Mungesa e kushteve dhe e mjeteve të përshtatshme për veprimtari normale dhe për shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të stafit të Institucionit.

4. Mungesa e mjeteve të përshtatshme që bëjnë të lehtë komunikimin e shpejtë të Institucionit me publikun, sidomos me zonat rurale, apo në vendet ku kufizohet liria e lëvizjes si burgje, spitale, azile etj, të lidhura këto me gjithë rrjetin e dobët të infrastrukturës në vendin tonë.

Gjendja reale që ekziston në spitale, burgje, dhoma paraburgimi, krijon vështirësi në vendosjen e standarteve të drejtave të qytetarëve, siç i kanë shumë vende të botës.

5. Vështirësitë për të bashkëpunuar me nëpunësit, pjestarë të një administrate publike, ku të punësuarit paguhen nën kërkesat për një nivel të kënaqshëm jetese, që nuk nxit thithjen në shërbimin civil dhe në administratën publike të specialistëve të aftë e të përkushtuar për zbatimin e ligjeve.

6. Mungesa e familjarizimit të Institucioneve Shtetërore tradicionale ekzistuese me praninë dhe veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, si organ kontrolli të jashtëm, në rastet e shkeljes së të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në Shqipëri.

7. Nuk është insistuar sa duhet për probleme shumë të rëndësishme, si ato të rregullimit ligjor të pronës dhe kompesimit të saj, të cilat prekin një numër të madh të qytetarëve.

8. Mosthëllimi sa duhet në nxjerrjen e shkaqeve dhe evidentimin e rrugëve dhe mjeteve për të parandaluar shkeljet e të drejtave të njeriut, sidomos të fëmijëve dhe grave.

Epërsitë

1. Duke qenë se Institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri është ideuar dhe rekomanduar të përfshihet në

Kushtetutën e Shqipërisë nga Faktori Ndërkombëtar, mbështetja ndërkombëtare që është bërë dhe vazhdon të bëhet për këtë institucion, është një avantazh me peshë të madhe.

2. Stafi është i përkushtuar dhe i kualifikuar nga pikëpamja ligjore, megjithëse ka nevojë për trajnim në metodën e punës, për specifikat që kanë të drejtat dhe liritë e njeriut.

3. Pavarësia e garantuar nga Kushtetuta dhe parimet ndërkombëtare të punës së Ombudsmanit dhe paanësia në ushtrimin e funksioneve të Avokatit të Popullit kanë krijuar parakushtet që të rritet besueshmëria si para publikut, ashtu edhe tek autoritetet e Administratës Publike.

4. Mbështetja e deritanishme nga ana e të gjitha Institucioneve Qeveritare Shqiptare për nevojat dhe veprimtarinë e Institucionit tonë, sepse dihet se një nga kushtet e Kartës së Kopenhagenit për anëtarësim ose pezullim nga Bashkimi Evropian është “respektimi dhe stabiliteti i institucioneve garantuese të demokracisë, të sundimit të ligjit, të të drejtave të njeriut dhe të mbrojtjes së pakicave”. Dhe Avokati i Popullit është një institucion që garanton demokracinë, pasi ai ndihmon për forcimin e konceptit të një shteti kushtetues, të shtetit ku sundon ligji.

Objektivat

Ndër objektivat strategjike të Institucionit do të veçojmë:

1. Parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve të mundshme midis Administratës Publike dhe Individit.

2. Të ndikojmë për respektimin dhe stabilitetin e institucioneve shqiptare, që sigurojnë demokracinë dhe prosperitetin;

3. Të ndihmojmë në përmirësimin e legjislacionit shqiptar, në përputhje me standartet ndërkombëtare që kërkojnë Konventat e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut;

4. Të krijohet besimi i publikut shqiptar te Institucioni i Avokatit të Popullit, si një ndërmjetës i paanshëm, serioz midis atij dhe Administratës Publike Shqiptare.

5. Të ndikojmë për edukimin e Administratës dhe të publikut me parimet e mirëqeverisjes dhe me kërkimin e përgjegjësisë nga nëpunësit.

Disa nga drejtimet e punës që ne kemi zbatuar dhe do zbatojmë për të realizuar këtë pike janë: dhënia e ndihmës ligjore nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillave në rastet e konflikteve midis administratës dhe publikut, zbulimi i defekteve të administratës, denoncimi i sjelljeve të këqia të nëpunësve kundrejt qytetarëve, presioni për ndryshimin e procedurave të rënduara dhe të paqarta të Administratës Publike; krijimi i kushteve që qytetarët të gëzojnë liritë e tyre në marrjen e informacioneve të nevojshme nga Administrata Publike, si dhe nxitja e transparencës së kësaj të fundit në veprimtarinë e saj.

6. Rëndësi të veçantë për pjestarët e një shoqërie kanë të drejtat ekonomike dhe social-kulturore dhe nuk ka arsye objektive që të mendosh se këtyre duhet t'u kushtosh më pak vëmendje se të drejtave të tjera. Në shumë vende këto janë konsideruar më tepër si diçka ambicioze se sa si të drejta reale, megjithëse janë përfshirë në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948, së bashku me të drejtat civile dhe politike. Me të drejtat ekonomike e sociale ndeshemi në çdo hap të jetës së përditshme, prandaj ka shumë rëndësi monitorimi i tyre.

7. Çdo e drejtë për një individ, parashikon një detyrim për një Qeveri. Asnjë diskriminim nuk duhet të bëhet midis njerëzve.

Qeveritë kanë rolin kryesor në këtë detyrë, së bashku me organizmat ndërkombëtare, por OJQ-të japin ndihmesë kryesore për vënien në jetë të të drejtave të njeriut. Prandaj, bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me organizatat joqeveritare do t'i kushtohet një rëndësi e veçantë.

8. Njohjen dhe ndërgjegjësimin çdo ditë e më tepër të publikut shqiptar për nocionet dhe praktikat e lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe nivelin e zbatimit dhe mbrojtjes në praktikë të tyre, brenda vendit, si dhe krijimit të kushteve për të mundësuar mbrojtjen e tyre në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Në këtë kuadër do të punohet për të gjetur hapësirat e duhura për respektimin dhe mbrojtjen edhe të të drejtave të shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë Shqipërisë, duke kërkuar për të vënë më tepër në lëvizje edhe administratën shqiptare të shërbimit diplomatik e konsullor jashtë vendit.

STRATEGJITË

Për të realizuar objektivat e mësipërme, nga ana jonë janë përcaktuar edhe Strategjitë e nevojshme.

Është e qartë se publiku pret një shërbim të një cilësie të lartë nga Zyra e Avokatit të Popullit, shërbim i cili duhet të karakterizohet nga nxjerrja me besnikëri e së vërtetës, pa frikë dhe pa anësi; përgjigjja në kohën e duhur, me cilësi e me një gjuhë të kthjelltë dhe të kuptueshme, zbatimi i barazisë dhe krijimi i lehtësisë në marrjen e informacionit; thjeshtësia e procedurave dhe trajtimi i publikut dhe i autoriteteve publike me mirësjellje dhe respekt; mungesa e paragjykimeve dhe interesave private; shpërndarja e detyrave dhe përgjegjëseve sipas ligjit, promovimi i ndershmërisë në Administratën Publike; si dhe i praktikave administrative pozitive dhe të parimeve të etikës; përdorimi efikas dhe efektiv i burimeve materiale dhe njerëzore.

Avokati i Popullit do të jetë një mjet për të mënjeluar rrugët jodemokratike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, për një zgjidhje sa më demokratike të kërkesave dhe ankesave të njerëzve që u janë shkelur të drejtat. Roli i tij i ndërmjetësit midis individit dhe administratës publike, si dhe i kujdestarit të individit në rastet e neglizhimit prej

nëpunësit ose shpërdorimit të ligjit në dëm të individëve, qofshin këta edhe të privuar nga liria ose të ndëshkuar nga një ligj i caktuar, do të forcohet.

Në këtë kuadër, në zbatim të ligjit, do të shohim mundësinë që brenda vitit 2001, të hapim edhe një ose dy zyra rajonale të përfaqësuesve tanë pranë pushtetit vendor, për një kohë të caktuar, aty ku do ketë më tepër nevojë.

Rëndësi të veçantë i kemi kushtuar bashkëpunimit me institucionet dhe OJQ-të shqiptare, si dhe trajnimit të Administratës Publike nëpërmjet projekteve të përbashkëta e të koordinuara; bashkëveprimit me Ministrinë e Drejtësisë për implementimin e Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut në ligjet e reja që do të bëhen si dhe në ato që do të rishikohen sipas Kushtetutës.

Ne kemi shpallur dhe e kemi zbatuar me besnikëri parimin e Transparencës dhe bashkëpunimin me Median elektronike dhe të shkruar. Këtë e kemi realizuar duke zbatuar një program sensibilizimi si dhe ngritjen e një sistemi informimi ditor të medias dhe të shtypit për t'i njohur me veprimtarinë tonë.

Në fazën e dytë të konsolidimit të Institucionit, ku ne hyjmë së shpejti, në bazë të një plani afatmesëm, do të punojmë për forcimin e mëtejshëm të Institucionit, duke organizuar veprimtari që synojnë si përhapjen e informacionit, ashtu edhe rritjen e reputacionit të Institucionit brenda vendit. Për të rritur besimin e njerëzve ndaj tij, ne do të shtojmë bashkëpunimin me Mediat, për të shpjeguar rolin dhe qëllimet tona, duke forcuar lidhjet me administratën publike dhe OJQ-të, duke zbatuar gjithashtu Rregulloren e Brendshme dhe Kodin Etik të zyrës tonë.

Ne kemi konsoliduar mendimin se është i nevojshëm edhe amendimi (plotësimi) i ligjit "Për Avokatin e Popullit", për të zgjidhur disa probleme që kanë dalë gjatë zbatimit në praktikë të tij, si p.sh. përcaktimi i kohës që duhet të jenë kryer shkeljet që të pranohet ankesa, sepse tani na janë bërë ankesa edhe për çështje që nga viti 1945 etj.

Këto probleme do të konsultohen me përfaqësuesit e institucioneve që kanë iniciativë ligjvënëse

Në një faze të tretë kemi përcaktuar disa detyra sipas një plani afatgjatë, në bazë të të cilit synojmë të japim ndihmesën tone në forcimin e shtetit ligjor dhe të zbatimit të parimit të barazisë së të gjithë qytetarëve përpara ligjit, në forcimin e shoqërisë civile dhe të pluralizmit, nëpërmjet bashkëpunimit me mekanizmat e përgjegjësive, kontrollit dhe balances së fuqisë së shtetit, gjithmonë në kuadrin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Gjithashtu ne do të punojmë dhe bashkëpunojmë ngushtë me Miqtë tanë dhe institucionet e huaja homologe për trainimin e stafit në fushat e veçanta si për çështje që kanë të bëjnë me administratën qendrore dhe vendore, me administratën gjyqësore, me administratën e organeve shtrënguese, çështje që lidhen me të Drejtat e Fëmijëve dhe të Grave, të bashkëpunimit me OJQ-të, etj, do kërkojmë mbështetje financiare për projekte, të cilat do t'i paraqesë Avokati i Popullit në bashkëpunim me administratën qendrore dhe lokale, si dhe OJQ-të.

Si përfundim, dua të shpreh mendimin se puna e deritanishme për ngritjen dhe veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri po ecën në udhë të mbarë. Mbase mund të konsiderohen hapa të vegjël, por janë të sigurtë. Këtë opinion e kanë shprehur apo mbështetur edhe kolegët tanë europianë që na kanë monitoruar. Suksesi i mëtejshëm i punës së Avokatit të Popullit do të varet si nga qëndrimi i Administratës, ashtu edhe nga ai i qytetarëve ndaj këtij institucioni.

Natyrisht, jemi të vetëdijshëm se kemi edhe mjaft të meta e mangësi, se punojmë në një fushë të re, pa përvojë, prandaj do të përpiqemi të përmirësojmë metodën e veprimtarisë, të zbatojmë me kujdes vërejtjet e sugjerimet që do na bëhen, për të zgjidhur sa më drejt ankesat dhe kërkesat e njerëzve, duke mbrojtur kështu të drejtat dhe liritë e tyre themelore.

*

*

*

Në prani të Presidentit të Republikës, përfaqësuesve të Kuvendit dhe të Qeverisë dhe të të ftuarve të tjerë si Ombudsmani i Danimarkës dhe ai i Kosovës, më 20 mars 2001 do të zhvillojmë ceremoninë zyrtare të përvetit të Selisë ku zhvillon veprimtarinë Institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri. Njëkohësisht kjo datë do të shënojë fundin e fazës së ngritjes dhe njëkohësisht fillimin e fazës së konsolidimit të këtij Institucioni.

XARRE 14.1.2001

Z. ERMIR DOBIANI, AVUKAT I POPULLIT

TIRANE

PARRË SE TE SHKRUAD KETE COPE ZËFËK, JU KERRMI
NDJESE PER KTHIMIN E PERGJIGJES TE KURKESAVE
PER DOKUMENTAT PLOTESUESE QE DUKESHIN PER SHUTJE,
TIMË. KDO NDODHI JO PER PARRIN TIM, POR PER
KUSHTET AKTUALE TE DRETTESISE JABRISHIE JHRITANAKE
QE TE DRIDHET ZEMRA PER TE TRAKTUR NE STRAT
ETJRE PO SPATE XHEPIA PLOT.

Z. ERMIR, TANI KTHEHEM NE INSTUACIONIN QE JU
DREJTOINI SI AVUKAT I POPULLIT.

JU PERBEZOJ DHE JU PERSHENDOS HGA ZEMRA PER
KURKTESINE DHE SINGREKJETIM TUAJ DHE TE STAFIT
TUAJ NE PERADITHESI.

ME STAFIN QE JU DREJTOINI. MUND TE ZGJIDHINI

PLOTESISHT HALLET DHE PADRETESITE ERKETS PO-
POPULLIT ICILI VLENE PER TE RESPEKTOHUR.

KENDE STAFI TE AFTE, TE SINGERT DHE TE PA KORU-
PTUAR.

DHE PIKERISHT PER Z. PCENIT AZEMAS DHE SHOKI
TOJETER QE HUK EMBAJ MEND EMRIN, KONTRAKTUARI
BASHEKE NE NJE MEXYRE TE TYLLE, QE RALLE MUND
TE GJESH DHE TE TAKOSH DJEMTE TE TYLL TE THUSHA,
TE AFTE PROFESIONALISHT DHE TE PREBISPOLUJN PER
TE ZGJIDHUR HALLET I POPULLIT.

JANE NGJEREZ TE PAKURTUAR, JU TE PANGOPUR DHE
RILAXHI.

NEGJO Z. ERMIR DOBIANI. JU VETEM QE SPRANUAN
VEË SE NJE KAFË DHE ATE ME TE LUTUR, POR NE VEND
QE TI REBASIM NE DR. QENASIA PTA. RRE. DR. NADHES
TE TYLLE MUND TE HARRISH KUTE DURS.

%

2

HERA E PARE NE JCTEN TIME, SI NE KUHEN EMOJIZMIT
DHE NE KUHEN E « DEMOKRACISE » KAM BEGJUAR NGA
GOJA E PUNONJESVET TE ADMINISTRATES TE THONE:
« NA PAGUAM SHITETI, MARRIM RROGE TE MJAFTUESHEM
KEMI SYRIA DHE KUJATE TE MIRA, » ETJ. » KURSE
AVUKATET EMIO DHE QYTATARE RE GJYKUAN PROBLE
MIN TIM TE DREJTE 100% GAZI DHE BRCKET MI HORIM
ME FAL PER KETE SHREHJE.

PER PROBLEMIN TIM TE DREJTE 100% LUBIJI E DRETE VISE
ME REMIETEN PARDRETEVISHAT NISI I MILON LERE, DHE ME
NE FUND ME LANC NE UOHE KRYE JE SKISHA ME SEJISE
UNE DETUD ME NJE PENSION DARDINER SI GJITHI TE TERE


E DHE NJE HENE JU PERCEZOD PER KETA PUNONJES TE
TU, BEGJAR HITIN ERI 2001, SUKSESE, SHENOET DHE
LUMTURI NE FAMILJE TUA.

SA PER PROBLEMIN TIME KAM BESIM TE DATUM DUK
DHE ELE NE DURT TUAJA

JAM NJERI FUKARA, INDERUAR DHE NJE EDUKATOR
DHE ATDHETAR IMIRE DHE NUR DUA TE XTACHEN NE
KRIMINEL DHE VET GJYKUES

JU PERJHENDES NGA ZEMRIA TE GJITHI

(Abdullah Qajaku)



Avokatit të Popullit

z. Ermir DOBJANI

Unë i nënshkruari Gëzim Panariti, administrator i Galerisë Kombëtare të Arteve-Tiranë, kam kërkuar ndihmesën e institucionit Tuaj për rishikimin e kërkesës sime pranë Komisionit të Kualifikimit Shkencor të datës 31 gusht 2000, i cili hodhi poshtë këtë kërkesë për mbrojtjen e disertacionit me temë:


'Menaxhimi i ekspozitave në fushën e Arteve Vizuale'.

Kam kënaqësinë t'ju informoj se pas kërkesës Suaj, Komisioni i Kualifikimit Shkencor të datës 27 nëntor 2000, rishikoi kërkesën dhe e aprovoi për mbrojtje pranë Akademisë së Arteve, më datë 15 janar 2000.

Duke ju falemnderuar përzemërsisht për ndihmesën Tuaj të çmuar.

Me respekt


Gëzim Panariti



Administrator
Galeria Kombëtare e Arteve

Tiranë, më 20. 12. 2000

Z. ERMIR DOBJANI



AVOKATI I POPULLIT

TIRANE

Se pari me lejoni t'ju urojme per detyren e rendesishme humane e qytetare .

Ne pergjigjen e Institucionit qe ju drejtoni me Nr 8/6, date 18.01.2001, pame nivelin e stafit tuaj dhe korrektesine shtetore qe deshirojme te gjithe si qytetare te ketij vendi ,ku per d r e j t e s i enderrojme te gjithe.

Edhe njehere mironjohje dhe pune te frutshme per gjithe jeten si Institucion dhe JUVË personalisht.

Me respekt

GENCI MULLETI

TIRANE

A handwritten signature in black ink, which appears to read "Genci Mulleti". The signature is written over a horizontal line.

Tirane me 24.01.2001

T'ndërruar dhe i rrespektuar z. Fanostkamt Rano.

6:03, që bëra me t'ju gjyë shkëmborë e unë
si me shëndet si me punë, si nga ana shpirtërore
qijthashtu edhe me problemet e tjera që dalin
nga jetë.

Pë gjithëkrah edhe familjes tuaj i unë shëndet të mirë,
shëndet dhe lumturie në jetë e punë.

T'fjalë: Zet qoftë efi që t'ju udhëhojë dhe t'ju
bëjë, në të gjitha ditë, ditët e jetës tuaj familjare.

T'i dërgova këto urime sepse jemi krijesat e të, të gjithë
Zet dhe unë këtu që e dërgojmë për qdo njëri në botë.
Unë për një njëri edhe kështu i njëjtë edhe kështu me një
dëshira ime është që çdo njëri të jetë i lumtur në këtë jetë.
Pavarësisht se autoriteti i njeriut mbledhjen nga njëri të të
tjetër për frymë e qdo njëriut është e barabartë për
të gjithë, sepse në "sytë" e Zotit janë të gjithë njëri.

Z. Fanostkamt: T'i dërgojmë këto pë arsyet të vërtetë
- mësuesin që për të vërtetë dërgon në "zëritë" për unë
për për unë se, gjatë ditëve që pata me ju e
kam edhe veten të lumturë tamam si në jetën e list
dhe jo si i Bujarëve për si një njëri mishi një shqiptar
të shëndoshë dhe të njeriut.

Të bëhetem si jam edhe i lumtur në ato pak orë që
qëndrova bashkë.

Njeriu njerëzorë edhe për udhëkës në një vënd që të
përkrahëshëm e ndihmë unë të lumtur për kështu që
udhëkës kështu me një personi arsyetshëm një frymë e
udhëkës dhe shpirtërore në ditët.


Si njëri jam unë kështu frymë e njeriut dhe shpirtërore
sëhtë juve që në arsyetshëm në ato ditët.

Kështu unë u udhëkës i lumtur sepse komunikova me ju me
një frymë të njeriut dhe shpirtërore në të vërtetë me komunikoj
me njëriut në të vërtetë të gjithë kështu.

Të jam mirënjohës. Jam për listën me krijesat e mia.

Struktura e Institucionit të Avokatit të Popullit pasqyrohet në formën e një skeme

Pasqyra Nr.1



Pasqyra Nr.2

ORGANIKA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

| Nr. | EMËRTIMI | NËPUNËS |
|-------------|---|--|
| I | AVOKATI I POPULLIT | (1) |
| II. | KABINETI Shefi i Kabinetit Këshilltari i Avokatit të Popullit Këshilltar, Zëdhënës i Avokatit të Popullit Sekretare e Avokatit të Popullit | (4) 1 1 1 1 |
| III | SEKSIONI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS QENDRORE DHE VENDORE Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + Rregjistruese | (7) 1 5 1 |
| IV | SEKSIONI I SHËRBIMEVE TË VEÇANTA Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese | (7) 1 5 1 |
| V | SEKSIONI I PËRGJITHSHËM Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese | (7) 1 5 1 |
| VI | SEKRETARI I PËRGJITHSHËM | (1) |
| VII | DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË Drejtor Inspektor + (përkthyes, bibliotekar) | (2) 1 1 |
| VIII | DREJTORIA E PERSONELIT Drejtor | (1) 1 |
| IX | SEKTORI I ADMINISTRATËS Shef Sektori (Inspektor) Specialist, ekonomist Llogaritar i parë, Arkëtar Specialist kompjuteri, inxhinier Arkivist + rregjistruese Protokollist Nëpunës informacioni Magazinier Shofer Pastrues | (17) 1 1 1 1 1 1 1 1 1 7 2 |

Punonjës gjithësej të Institucionit të Avokatit të Popullit do të jenë 47 veta.

Pasqyra Nr.3

VOLUMI VJETOR I PUNËS


| | | |
|-------------------------|------------|-----|
| Ankesa të ardhura gjatë | vitit 2000 | 810 |
| Ankesa të përfunduara | | 601 |
| Ankesa në shqyrtim | | 209 |

| | | |
|----------------------------|-----------|-----|
| Ankesa të ardhura deri | 12.2.2001 | 257 |
| Gjithësej në shqyrtim deri | 12.2.2001 | 466 |


Pasqyra Nr.6

Ndarja e ankesave sipas fushave


| | |
|---|-----|
| Ankesa kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave | 132 |
| Ankesa për Pushtetin Lokal | 124 |
| Ankesa për policinë | 76 |
| Ankesa për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore | 67 |
| Ankesa për çështje në gjykim nëpër gjykata | 43 |
| Ankesa për Organet e Ministrisë së Mbrojtjes | 45 |
| Ankesa për Sigurimet Shoqërore | 49 |
| Ankesa për largime nga puna | 42 |
| Ankesa nga të burgosurit | 34 |
| Ndërtime pa leje, mosveprime të policisë ndërtimore | 31 |
| Ankesa për sistemin e Ministrisë së Financave | 23 |
| Ankesa për organin e Prokurorisë | 28 |
| Ankesa për Arsimin e Kulturën | 10 |
| Ankesa për Kujdesin Shëndetësor | 8 |
| Të tjera | 98 |
| TOTALI | 810 |



ANKESA




NDARJA E ANKESAVE SIPAS FUSHAVE




- Ankesa kunder vendimeve te formes e prere te gjykatave
- Ankesa per Pushtetin Lokal
- Ankesa per Policine
- Ankesa per mosekzekutimin e vendimeve gjyqesore
- Ankesa per Ceshtje ne gjykim neper gjykata
- Ankesa per Organet e Ministrise se Mbrojtjes
- Ankesa per Sigurimet Shoqerore
- Ankesa per largime nga puna
- Ankesa nga te burgosurit
- Ndertimet pa leje, mosveprime te policise ndertimore
- Ankesa per sistemin e Ministrise se Financave
- Ankesa per organin e Prokurorise
- Ankesa per Arsimin e Kulturen
- Ankesa per Kujdesin Shendetesor
- Te tjera


NDARJA E ANKESAVE SIPAS FUSHAVE




ANKESA PER MOSEKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQESORE



ANKESA PER POLICINE




Ankesa nga te burgosurit



- Ankesa te drejtuar nga te burgosurit ne burgje
- Ankesa te drejtuar nga te burgosurit ne dhomat e izolimit
- Ankesa te drejtuar nga te burgosur jashte shtetit

ANKESA PER FORCAT E ARMATOSURA



MBULIMI MEDIATIK I VEPRIMARISE SE INSTITUCIONIT TE AVOKATIT TE POPULLIT

DERI ME 13.02.2001

Media e shkruar

| Nr. | ORGANI | DATA | TITULLI | RUBRIKA | PASQYRIMI |
|-----|----------------------|------------|--|-------------|-----------|
| 1 | Koha Jone | 08.02.2000 | Kandidatet u paraqiten dje para deputeteve. | Politike | Njoftim |
| 2 | Koha Jone | 12.02.2000 | Shen Valentini me Avokatin e Popullit. | Politike | Njoftim |
| 3 | Koha Jone | 16.02.2000 | P.D. Abstenon seancen per A. P. | Politike | Njoftim |
| 4 | Koha Jone | 16.02.2000 | PD merr vendim per bojkotimin e seances per zgjedhjen e A.P. | Politike | Njoftim |
| 5 | Koha Jone | 16.02.2000 | Shumica le Parlamentin minuten e fundit, kartonat percahen. | Politike | Njoftim |
| 6 | Rilindja Demokratike | 17.02.2001 | Maxhoranca zgjedh avokatin e P.S. | Politike | Njoftim |
| 7 | Albania | 17.02.2000 | Avokati i Popullit, 1.5 milione dollare. | Politike | Njoftim |
| 8 | Albania | 17.02.2000 | Socialistet zgjidhin dilemen e Avokatit te Popullit. | Politike | Njoftim |
| 9 | Koha Jone | 17.02.2000 | Parlamenti i siguron 3/5 juristit Ermir Dobjani. | Politike | Njoftim |
| 10 | Koha Jone | 17.02.2000 | Kuvendi zgjedh njeriun qe do te perfaqesoje institucionin e pavarur. | Politike | Njoftim |
| 11 | Gazeta Shqiptare | 17.02.2000 | Kush eshte Ermir Dobjani. | Informacion | Prononcim |
| 12 | Gazeta Shqiptare | 17.02.2000 | Supermbrojttesi pa telefon. | Politike | Prononcim |
| 13 | Gazeta Shqiptare | 17.02.2000 | Zgjidhet "engjelli mbrojttes". | Politike | Njoftim |

| | | | | | |
|-----|---------------------|------------|---|----------------------------|------------|
| 14 | Gazeta Shqiptare | 18.02.2000 | Une "Avokati" nuk kam zyre. | Interviste Dr.E.Dobjani | Interviste |
| 15 | Gazeta Shqiptare | 18.02.2000 | "Avokati..." Trokisni tek une. | Politike | Prononcim. |
| 16 | ATSH | 28.02.2000 | A.P. ne mbrojtje te individeve nga administrata | Interviste Dr.E.Dobjani | Interviste |
| 17 | Koha Jone | 02.03.2000 | Avokati i Popullit behet me Avokate. | Politike | Njoftim |
| 18 | Koha Jone | 25.02.2000 | Duhet nje vend i dukshem qe ta gjejne hallexhinjte. | Politike | Prononcim |
| 19 | Koha Jone | 26.02.2000 | Avokati i popullit siguron miq me shume se Qeveria. | Politike | Njoftim |
| 20 | Koha Jone | 21.03.2000 | Dobjani shpalos idene: "Te ngreme pallatin e te Drejtave te Njeriut". | Politike | Prononcim |
| 21 | Koha Jone | | Parlamenti voton tre ndihmesat e A. P.. Tani mungojne vetem zyrat. | Interviste Dr.E.Dobjani | Interviste |
| 22 | Intervista | 09.04.2000 | Cili eshte Avokati i Popullit Ermir Dobjani. | Interviste Dr.E.Dobjani | Interviste |
| 23 | Koha Jone | 10.06.2000 | Kush nuk deshiron qe Avokati i Popullit te filloje detyren per te cilen eshte zgjedhur? | Politike | Njoftim |
| 24. | Albanian Daily News | 16.06.2000 | "Ombudsmani hapi ankesen e pare". | Informacion | Njoftim |
| 25 | Gazeta Shqiptare | 23.06.2000 | Dobjani mer dosjen e pare. | Aktualiteti | Prononcim |
| 26 | Zeri i Popullit. | 26.06.2000 | 50 ceshtjet e para per 300 vetet qe humben shtepite. | Aktualitet | Prononcim |
| 27. | ATSH | 26.06.2000 | A.P. nis ceshtjet e para ne ndihme te qytetareve. | Interviste Dr.E.Dobjani | Interviste |
| 28. | Zeri i Popullit | 27.06.2000 | Avokati i Popullit: Keshtu do te zgjidhim hallet e qytetareve. | Aktualiteti | Prononcim |
| 29 | Albania | 2.07.2000 | "Avokati i Popullit " pa shtepi. | Interviste | Prononcim |

| | | | | | |
|----|----------------------|------------|---|---|-------------------|
| 30 | Koha Jone | 15.07.2000 | Avokati i Popullit, Policia, Sherbimi Sekret, Ushtria dhe Gjygesori. | Dr.E.Dobjani Artikull Dr.J.Dhrami | Prononcim |
| 31 | Koha Jone | 3.08.2000 | Dobjani-Metes "Po beni privatizim te paligjshem". | Ekonomi | Prononcim |
| 32 | Koha Jone | 3.08.2000 | A.P. "vendimi i Marsit 2000 per procedurat e privatizimit eshte i paligjshem". | Sociale | Prononcim |
| 33 | Rilindja Demokratike | 4.08.2000 | Dobjani i ankohet Metes: Privatizimet jane te paligjshme. | Drejttesi | Prononcim |
| 34 | Koha Jone | 11.08.2000 | Pas ankesave te qytetareve, Dobjani i drejtohet Angjelit. | Aktualiteti | Prononcim |
| 35 | Koha Jone | 02.09.2000 | Ankesa e A.P. heq spaletat e komandantit. | Aktualiteti | Prononcim |
| 36 | Koha Jone | 02.09.2000 | Aventura e lejes se banimit per kandidatit e pavarur A.P.nderhyn pas leximit te K.J. | Aktualiteti | Prononcim |
| 37 | Koha Jone | 07.09.2000 | A.P. pranon ankesen e 300 familjeve te pastreha. | Aktualiteti | Prononcim |
| 38 | ATSH | 09.09.2000 | AP merr ne analize punen tremujore. | Interviste | Njoftim |
| 39 | Gazeta Shqiptare | 10.09.2000 | Ne zyren e A.P. mberrijne cdo dite ankesa nga qytetaret. | Aktualiteti | Konference Shtypi |
| 40 | Albanian Daily News | 12.09.2000 | Ombudsmani gjen perkrahje nga koleget e tij sllovene dhe daneze. | Kryeartikull | Prononcim |
| 41 | Republika | 19.09.2000 | A.P. trajton ankesat per pronat. | Ekonomi | Prononcim |
| 42 | Republika | 19.09.2000 | Dobjani :Per ceshtjen Çame do te dalim ne Europe. | Politike | Prononcim |
| 43 | Koha Jone | 20.09.2000 | Camet AP-se: Na ktheni pronat! | Aktualiteti | Prononcim |
| 44 | Gazeta Shqiptare | 22.09.2000 | Fitojme gjyqet me shtetin , por ende s`kemi marre leket. Avokati angazhohet fuqishem. | Aktualiteti | Prononcim |
| 45 | Gazeta Shqiptare | 26.09.2000 | A.P. ndermjeteson per 1.6 miliarde leket e 80 shofereve shqiptare te "Sarandopulos". | Aktualiteti | Prononcim |
| 46 | Gazeta | 30.09.2000 | Avokati i Popullit bashkeorganizon semi-nar me Keshillin e | Informacion | Njoftim |

| | Shqiptare | | Europes dhe OSBE-ne. | | |
|----|------------------|------------|--|-------------------------------------|------------|
| 47 | Albania | 6.10.2000 | A.P. ne seminarin e trete brenda nje muaji. | Aktualitet | Njoftim |
| 48 | Koha Jone | 25.10.2000 | Ministria e Rendit nxjerr urdherin pas kerkeses se Avokatit te Popullit. | Aktualitet | Prononcim |
| 49 | Koha Jone | 26.10.2000 | A.P. kerkon para per ata qe kane fituar gjyqet per largimin nga puna. | Aktualiteti | Prononcim |
| 50 | Gazeta Shqiptare | 27.10.2000 | Shendetesia grabit qytetaret me taksa te padrejta, A.P. nderhyn. | Informacion | Prononcim |
| 51 | Koha Jone | 16.11.2000 | A.P.kerkon ndryshimin e mases se sigurise per vrasesen shtatzene. | Aktualiteti | Prononcim |
| 52 | Gazeta Shqiptare | 24.11.2000 | A.P. nis rekomandimin: "Te informohen qytetaret". | Aktualiteti | Prononcim |
| 53 | Gazeta Shqip | 24.11.2000 | Ceshtja "Erieta " perfundon tek A.P. | Aktualiteti | Njoftim |
| 54 | "55" | 13.12.2000 | A.P. diskuton me Komisionin e Ligjeve. | Politike | Njoftim |
| 55 | Koha Jone | 14.12.2000 | Avokati: Per ceshtjen Çame duhet padi individuale. | Aktualiteti | Prononcim |
| 56 | Koha Jone | 14.12.2000 | Fituesit e Gjyqeve me shtetin Avokati u siguron 500 mije dollare. | Aktualiteti | Prononcim |
| 57 | Republika | 29.12.2000 | Policet heqin reklamat. Avokati denon Komi. | Ligjshmeria | Prononcim |
| 58 | Albania | 10.01.2001 | Qeveria 1.6 milion borxh 450 qytetareve | Interviste me A.P. | Interviste |
| 59 | Republika | 11.01.2001 | 900 dosje per Avokatin e Popullit. | Aktualiteti | Prononcim |
| 60 | Ushtria | 31.01.2000 | Avokati i Popullit dhe te drejtat e Ushtarakut. | Insterviste e N/Komisionit Y. Hasan | Interviste |
| 61 | Republika | 01.02.2001 | Haklaj, Ankese tek avokati i Popullit. | Drejtesi | Njoftim |
| 62 | Republika | 01.02.2001 | Perfundon tek A.P. ceshtja e shkolles "Asim Vokshi". | Sociale | Prononcim |

| | | | | | |
|----|-----------------------|------------------|--|-------------------------|------------|
| 63 | Albania | 02.02.2001 | A. P. "Nuk po hetojme, presim kerkese per kreun e P.D.-se Tropoje. | Politike | Prononcim |
| 64 | Koha Jone | 05.02.2001 | A.P. shprehet per nismat kunder korrupsionit. | Artikull Dr. E.Dobjani | Prononcim |
| 65 | Albania | 06.02.2001 | Prokuroria injoron kerkesen e A.P. | Politike | Prononcim |
| 66 | Koha Jone | 06.02.2001 | A.P. ze ne fragrance Prokurorin. | Aktualiteti | Prononcim |
| 67 | Rilindja Demokratike. | 08.02.2001 | Ermir Dobjani takohet ne burg me kryetarin e PD-se se Tropjes. | Aktualiteti | Prononcim |
| 68 | Gazeta Shqiptare | 09.02.2001 | Dobjani:"Ceshtja Ferexhe " deri ne Gjykatën Kushtetuese. | Aktualiteti | Prononcim |
| 69 | Republika | 11.02.2001 | Avokati i Popullit drejt sugjerimit per zgjidhjen e ceshtjes se "Vajzave myslimane". | Sociale | Prononcim |
| 70 | Koha Jone | 13.02.2001 | A.P. "Te drejtat europiane jane te njejta edhe per shqiptaret, edhe per greket". | Aktualiteti | Njoftim |
| 71 | Republika | 13.02.2001 | 13 perfaqesuesit e Bashkimit European" diskutojne me "Avokatin e Popullit". | Aktualiteti | Prononcim |
| 72 | Spekter | 08.04.2000 | Une, Kontrollori i Qeverise. | Interviste Dr.E.Dobjani | Interviste |
| 73 | Kanun | Gusht 2000 | Arriti Avokati i Popullit. | Drejtesi | Njoftim |
| 74 | Klan | Dhjetor 2000 | Une, Njeriu qe i ve noten qeverise. | Interviste Dr.E.Dobjani | Interviste |
| 75 | Te drejtat e njeriut | Dhjetor 2000 | A.P.- Institucion i Rendesishem per mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut. | Artikull Dr.E.Dobjani | Prononcim |
| 76 | Tribune Juridike | Nr.26. viti 2000 | Rreth pavaresise se Prokurorit gjyqesor. | Artikull Dr. J.Dhrami | Prononcim |
| 77 | Tribune Juridike | Nr.27. viti | A.P. vendi dhe roli i tij. | Artikull | Prononcim |

| | | | | | |
|----|--------------------------|---------------------|--|------------------------------|------------|
| | | 2000 | | Dr. J.Dhrami | |
| 78 | Tribune Juridike | Nr.27. viti 2000 | Te drejtat e te miturve ne burgjet shqiptare. | Artikull H.Bano Nd/k | Prononcim |
| 79 | Tribune Juridike | Nr.28. viti 2000 | Reklama,Ligji dhe zbatimi i tij. | Artikull S. Nushi Nd/k | Prononcim |
| 80 | Magyar Hirlap Hungari | 20.10.2000 | Brenda 3-muajve, Ombudsmani shqiptar ka marre 500 ankesa. | Interviste Dr.E.Dobjani | Interviste |

Media Elektronike

| Nr. | ORGANI | DATA | RUBRIKA | PASQYRIMI |
|------------|-------------------------|-----------------|---|---|
| 1 | Zeri i Amerikes | 17.02.2000 | Interviste me gazetarin E.Biberaj | A.P. Interviste |
| 2 | Radio BBC | 5.03.2000 | Interviste ne Studio | A.P. Interviste |
| 3 | Radio-Tirana | Prill 2000 | Interviste per shqiptaret jashte atdheut | A.P. Interviste |
| 4 | TVSH | Qershor 2000 | Interviste | Komisioneri A.Çausi Emision |
| 5 | TVSH | 12.07.2000 | Bisede ne Studio | A.P.+3 Komisionere Emision |
| 6 | TV. Vlore | 19.07.2000 | Ftese ne studio | E.Dobjani , A Caushi Emision |
| 7 | TV.Rozafa | 25.07.2000 | Bisede ne studio | E.Dobjani, A.Causi Emision |
| 8 | TNSH | 19.Qershor 2000 | Interviste | E. Dobjani Emision |
| 9 | BBF | Gusht 2000 | Interviste | Komisioneri J.Dhrami Prononcim |
| 10 | BBF | Shtator 2000 | Interviste | Komisionerja F.Nuni Prononcim |
| 11 | TVSH+TNSH+TVA +Teuta | 09.09.2000 | Konference shtypi e Avokatit te Popullit me homologet Danez dhe Sloven | Konference shtypi |
| 12 | TVSH+TNSH+TVA +Teuta | 15.10.2000 | Seminar i bashkeorganizuar nga A.P.+KE OSBE | A.P.Perfaqesuesit e Organizmave Nderkombetare dhe shtetit shqiptar. Prononcim |
| 13 | TVSH+TNSH+BBF | Tetor 2000 | Seminar i A.P.me Fondacionin "F-Ebert" | A.P. Perfaqesues te administrates Shqiptare Prononcim |
| 14 | TV-Shijak | Dhjetor 2000 | Interviste | A.P. E. Dobjani Prononcim |
| 15 | BBC | 16.12.2000 | Interviste me gazetarin A. Manaj | A.P. Interviste |
| 16 | Radio Tirana | Nentor 2000 | Interviste per shqiptaret jashte shtetit | A.P. Interviste |
| 17 | Radio Tirana | Dhjetor 2000 | Interviste ne fund te vitit | A.P. Interviste |
| 18 | TVSH | 28 Dhjetor 2000 | Tryeze e rrumbullaket A.P.+ OJQ-te | A.P.+ Perfaqesues te OJQ-ve Prononcim |

| | | | | | |
|----|---------------|------------|--|---|------------|
| 19 | TNSH | 09.01.2001 | Cikli mbi A.P. | E. Dobjani | Emision |
| 20 | Vizion + | 12.01.2001 | Interviste Speciale | E. Dobjani | Interviste |
| 21 | TNSH | 16.01.2000 | Cikli mbi A.P. | Dy nd/komisionere | Emision |
| 22 | TNSH | 23.01.2001 | Bisede me Seksionin e Administrates Cikli | Komisioneri + stafi | Emision |
| 23 | TVSH+TNSH+TVA | 29.01.2001 | Seminari i USAID-it me teme "Lufta kunder korrupsionit" | A.P. Organizatoret dhe pjesemarresit e tjere | Prononcim |
| 24 | TNSH | 30.01.2001 | Bisede me Seksionin e Vecante, Cikli | Komisioneri +Stafi | Emision |
| 25 | TNSH | 06.02.2001 | Bisede me Seksionin e Pergjithshem, Cikli. | Komisioneri +Stafi | Emision |
| 26 | TV. Koha | 07.02.2001 | Interviste per dhunen ne polici | E. Dobjani | Interviste |
| 27 | TNSH | 08.02.2001 | Ceshtja e shamijave. | E. Dobjani | Interviste |
| 28 | TV. Teuta | 09.02.2001 | Bisede ne studio. | E. Dobjani | Emision |
| 29 | TNSH | 13.02.2001 | Bisede ne Studio, Cikli. | Pese Nd/komisionere | Emision |

STATISTIKE PERMBLEDHESE E MBULIMIT MEDIATIK

MEDIA E SHKRUAR

a)

| Prononcime | Njoftime | Intervista | Konferenca shtypi | Gjithsej |
|-------------------|-----------------|-------------------|--------------------------|-----------------|
| 46 | 23 | 10 | 1 | 80 |

MEDIA ELEKTRONIKE

b)

| Prononcime | Intervista | Emisione | Konferenca shtypi | Gjithsej |
|-------------------|-------------------|-----------------|--------------------------|-----------------|
| 7 | 9 | 12 | 1 | 29 |

SHENIM

Problematika e nderhyrjeve te Avokatit te Popullit duket edhe nga titujt e paraqitur ne Statistike. Sidoqofte veprimtaria e Avokatit te Popullit eshte edhe me shumeperfshirese, pasi ka mjaft ceshtje te zgjidhura qe Avokati i Popullit e ka gjykuar te mos u jape publicitet. Per kete shihni statistikat sipas seksioneve.

ANKESA TË TRAJTUARA ME INICIATIVË TË INSTITUCIONIT

| Nr | Ankuesi | Përmbajtja e ankesës | Rrethi | Mënyra e zgjidhjes | | | |
|----|---------------------------------|---|---------|--------------------|-----------|----------|-------------|
| | | | | Në favor | Kopetencë | Refuzuar | Në shqyrtim |
| 1. | “Koha Jonë” për E.Hado | Bëhet fjalë për mbajtjen padrejtësisht në gjendje arresti të tij nga Gjykata rrethit Tiranë | Tiranë | | | + | |
| 2. | “Koha Jonë” Xhevdet Çelik | Nuk i sigurohet përkthyes | Tiranë | | | + | |
| 3. | “Koha Jonë” Arjan Bishqemi | Të arrestuarit A.B. nuk i jepet ndihmë mjekësore nga Prokuroria | Tiranë | + | | | |
| 4. | “Rilindja D” Besnik Papa etj | Keqtrajtime nga policia | | | | | + |
| 5. | “Koha Jonë” Dilaver Qerimi | Policia shtron në psiqiatri forcërisht | Elbasan | | | + | |
| 6. | G. “Shqiptare” Agustin Ashta | Gjykata Rr.Shkodër nuk bën çdëmtimin e dëmit të shkaktuar nga diegia e banesës së tij | Shkodër | | | + | |
| 7. | “G.Shqiptare” Adriatik Zotka | Prokuroria e mban pa të drejtë në gjendje arresti | Skrapar | | | + | |
| 8. | “Koha Jonë” Ergest Shele | Arrestohet dhe keqtrajtohet nga policia | Sarandë | + | | | |
| 9. | “Koha Jonë” | Qytetarë të ndryshëm merren në pyetje nga policia greke në komisariatit e Policisë Korçë | Korçë | | + | | |

| | | | | | | | |
|----|----------------------------|---|--------------|----------|----------|----------|----------|
| 10 | “Koha Jonë” + “Albania” | Keqtrajtim fëmijësh nga policia | Tiranë | | | | + |
| 11 | “Koha Jonë” Y.Kola | Mohim i lejes së banimit për kandidatin e pavarur Roskovec | Roskov ec | + | | | |
| | SHUMA | | | 3 | 1 | 5 | 2 |